LIGJ
Nr. 39/2020

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT DHE KOMISIONIT EUROPIAN PËR PROGRAMIN E VEPRIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA II, MAQEDONI E VERIUT-SHQIPËRI 2014-2020, ALOKIMET PËR VITIN 2018

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Komisionit Europian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar ipa ii, maqedoni e veriut-shqipëri 2014-2020, alokimet për vitin 2018, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 16.4.2020

Shpallur me dekretin nr. 11466, datë 23.4.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE FINANCIMI
KUSHTET E VEÇANTA

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si "Komisioni" ose "pala" e cila vepron në emër të Bashkimit Evropian, në vijim i referuar si "Bashkimi",

nga njëra anë dhe

Republika e Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Sekretariati për Çështjet Evropiane dhe Republika e Shqipërisë e përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, në vijim të referuar bashkërisht si "Përfituesit e IPA II" ose individualisht si "përfituesja e IPA II" ose "pala",

nga ana tjetër,

dhe bashkërisht të referuara si "Palët"

Ku,

Çdo referencë e përfshirë në këtë marrëveshje dhe në anekset e tij me "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" duhet të lexohet "Republika e Maqedonisë së Veriut"

KANË RËNË DAKORD SI MË POSHTË:

Neni 1

Programi i Veprimit

1. Bashkimi bie dakord të financojë dhe përfituesit e IPA II bien dakord të pranojnë financimin e lëvrimit për vitin 2018 të Programit të Veprimit në vijim, siç përshkruhet në Shtojcën I:

"Programi i Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë për vitet 2018-2020"

Numri global i zotimit (CRIS) /2018/041-370

Ky Program Veprimi financohet nga Buxheti i Bashkimit në bazë të aktit themelor në vijim: Instrumenti për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA II)1.

2. Kostoja e përgjithshme e vlerësuar e lëvrimit për vitin 2018 të këtij Program Veprimi është 2,000,000 Euro dhe kontributi maksimal i Bashkimit për këtë Program Veprimi është caktuar në 1,700,000 Euro.

Nuk kërkohet kontribut financiar nga përfituesit e IPA II.

Neni 2

Periudha e ekzekutimit dhe periudha e zbatimit operacional

1. Siç përcaktohet në nenin 1 (1) të Shtojcës II, periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financimi është caktuar 12 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Siç përcaktohet në nenin 1 (2) të Shtojcës II, periudha e zbatimit operacional të kësaj Marrëveshjeje Financimi është caktuar 6 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

Neni 3

Adresat dhe Komunikimi

I gjithë komunikimi në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje financimi duhet të jenë në formë të shkruar dhe do ti referohet shprehimisht Programit të Veprimit siç identifikohet në nenin 1 (1), dhe do të dërgohet në adresat e mëposhtme:

a) për Komisionin
Znj. Genoveva Ruiz Calavera
Drejtoria D, Ballkani Perëndimor
Drejtoria e Përgjithshme për Negociatat e Zgjerimit dhe Fqinjësinë, Komisioni Europian
15, Rue de la Loi, B – 1049 Bruksel, Belgjikë E-mail: NEAR-D1@ec.europa.eu

b) për përfituesit e IPA II
Për Republikën e Maqedonisë së Veriut:
Sekretariati për Çështjet Evropiane,
Quai Dimitar Vlahov No.4,
1000 Shkup, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë,
Tel: +389 (0)2 3200 105, Faks: +389(0)2 3114 569,

[1] Rregullorja Nr. 231/2014 (BE) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014 që krijon një Instrument për Ndihmën e Para-Anëtarësimit (IPA II), OJ L 77, 15.03.2014, fq. 11.

e-mail: cabinet@sep.gov.mk

Për Republikën e Shqipërisë:
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Drejtoria e Fondeve të BE-së
Bulevardi "Gjergj Fishta" No. 6
Tiranë, Republika e Shqipërisë
e-mail: info@mfa.gov.al

Neni 4
Pikat e kontaktit të Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF)

Pika e kontaktit të përfituesit të IPA II që ka kompetencat e duhura për të bashkëpunuar drejtpërdrejt me Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF), në mënyrë që të lehtësojë aktivitetet operative të OLAF-it, do të jenë:

Z. Fatmir Ademi, Shefi i Departamentit për Inspektimin Financiar të Sektorit Publik dhe Koordinimin për Luftimin e Mashtrimit kundër Fondeve të BE-së, Quai Dimitar Vlahov Nr.4, kati 4, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, e-mail: fatmir.ademi@finance.gov.mk

Dhe,

Z. Bejko Late, Drejtor i Sektorit të Inspektimit Financiar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Shqipërisë, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë, Shqipëri, email: Bejko.late@financa.gov.al

Neni 5
Marrëveshjet Kuadër

Programi i Veprimit do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë mbi marrëveshjet për zbatimin e ndihmës financiare të Bashkimit për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë nën Instrumentin e Ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA II), e cila ka hyrë në fuqi më 24 qershor 2015 dhe në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi marrëveshjet për zbatimin e ndihmës financiare të Bashkimit në Shqipëri nën Instrumentin e ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA II) që ka hyrë në fuqi më 16 prill 2015, (referuar në vijim si "Marrëveshja/jet Kuadër").

Kjo Marrëveshje Financimi plotëson dispozitat e Marrëveshjeve Kuadër të lartpërmendura. Në rast konflikti, nga njëra anë, e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje financimi dhe, nga ana tjetër, dispozitave të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, kjo e fundit do të ketë përparësi.

Neni 6
Shtojcat

1. Kjo Marrëveshje Financimi përbëhet nga:

a) këto Kushte të Veçanta;

b) Shtojca I: "Programi i Veprimit të BNK-së, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë për vitet 2018-2020";

c) Shtojca IA: IPA II CBC 2014-2020 Programi ndërmjet ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë;

d) Shtojca II: Kushtet e Përgjithshme;

e) Shtojca III: Raporti Vjetor Model CBC për zbatimin e ndihmës IPA II në përputhje me nenin 80 të Marrëveshjes Kuadër;

f) Shtojca IIIA: Raporti Vjetor Tip për zbatimin e ndihmës IPA II në përputhje me nenin 58 të Marrëveshjes Kuadër;

2. Në rast të një konflikti, nga njëra anë, të dispozitave të Shtojcave dhe nga ana tjetër, të dispozitave të këtyre Kushteve të Veçanta, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast të një konflikti, nga njëra anë, të dispozitave të Shtojcës I dhe Shtojcës IA dhe dispozitave të Shtojcës II nga ana tjetër, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të Shtojcës I, nga njëra anë dhe dispozitave të Shtojcës IA nga ana tjetër, këto të fundit do të kenë përparësi.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Financimi do të hyjë në fuqi ditën që do të nënshkruhet nga pala e fundit, jo më vonë se 31 Dhjetor 2019.

Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën angleze në tri kopje, një kopje i dorëzohet Komisionit dhe një kopje secilit prej përfituesve të IPA II.

Për përfituesit e IPA II: Për Republikën e Maqedonisë së Veriut: Bujar Osmani, Zëvendës Kryeministër për Çështjet Evropiane dhe Koordinatori Kombëtar i IPA-s Shkup Datë: Për Shqipërinë:: Z. Sokol Dedja Zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme Koordinatori Kombëtar i IPA-s Tiranë Datë:	Për Komisionin: Genoveva Ruiz Calavera Drejtor pranë Drejtorisë së Përgjithshme, Drejtoria D, Bruksel Datë:

Ref. Ares(2019)6430052 - 17/10/2019

ANNEX I

CROSS-BORDER COOPERATION ACTION PROGRAMME THE FORMER YUGOSLAV REPUBLIC OF MACEDONIA – REPUBLIC OF ALBANIA FOR THE YEARS 2018-2020

1 IDENTIFICATION

Beneficiaries	The former Yugoslav Republic of Macedonia Republic of Albania
CRIS/ABAC Commitment references **Union Contribution** **Budget line**	2018/041-370 EUR 1,700,000 22.020401 2019/041-371 EUR 1,700,000 22.020401 2020/041-372 EUR 1,530,000 22.020401
Management mode **Responsible Structures**	Direct management by the European Commission In the former Yugoslav Republic of Macedonia: the Ministry of Local Self Government In the Republic of Albania: the Ministry for Europe and Foreign Affairs
Final date for concluding <u>Financing Agreement(s)</u> with the IPA II beneficiary countries (tripartite)	For the budgetary commitment of year 2018 at the latest by 31 December 2019 For the budgetary commitment of year 2019 at the latest by 31 December 2020 For the budgetary commitment of year 2020 at the latest by 31 December 2021
Final date for concluding <u>procurement and grant contracts</u>	3 years following the date of conclusion of the Financing Agreement (signature of the last party) with the exception of the cases listed under Article 114(2) Financial Regulation
Final date for operational implementation	6 years following the date of conclusion of the Financing Agreement (signature of the last party).
Final date for implementing the Financing Agreement (date by which this programme should be de-committed and closed) after the acceptance of the accounts	12 years following the conclusion of the Financing Agreement (signature of the last party)
Programming Unit	DG NEAR, Unit D3 - the former Yugoslav Republic of Macedonia, Kosovo
Implementing Unit/ EU Delegation	Delegation of the European Union to the former Yugoslav Republic of Macedonia

INSTRUMENTI I NDIHMËS SË PARA- ANËTARËSIMIT
2014-2020


PROGRAMI IPA CBC
ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË –
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MIRATUAR MË 11/12/2014
Tabela e Përmbajtjes

INSTRUMENTI I NDIHMËS SË PARA- ANËTARËSIMIT1
2014-2020
AKRONIME
PËRMBLEDHJE
SEKSIONI 1
PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT
1.1 Përmbledhje e Programit
1.2 Përgatitja e programit dhe përfshirja e partnerëve
SEKSIONI 2
ZONA E PROGRAMIT
2.1 Analiza e Situatës – Përmbledhje
2.2 Gjetjet kryesore
SEKSIONI 3
STRATEGJIA E PROGRAMIT
3.1 Arsyetimi - Arsyetimi për strategjinë e zgjedhur të ndërhyrjes
3.2 Përshkrimi i Prioriteteve Tematike të Programit
3.3 Çështjet horizontale dhe të ndërthurura
SEKSIONI 4
PLANI FINANCIAR
SEKSIONI 5
DISPOZITAT ZBATUESE
LISTA E SHTOJCAVE
SHTOJCA 1
Analiza e Situatës dhe Analiza SWOT
Analiza e Situatës së Zonës së Programit
Analiza SWOT

Akronime

CBC	Bashkëpunimi Ndër-Kufitar
CfP	Thirrje për Propozime
CSO	Organizatë në Mbështetje të Komunitetit
DG	Drejtoria e Përgjithshme
ERE	Autoriteti Kombëtar Rregullator i Energjisë Elektrike (Republika e Shqipërisë)
EC	Komisioni Evropian
EU	Bashkimi Evropian
GBER	Rregullorja e Përgjithshme e Bllokimit dhe Përjashtimeve (BE)
GDP	Prodhimi i Brendshëm Bruto
GfA	Udhëzimet për Aplikantët

GVA	Vlera e Shtuar Bruto
HR	Burimet Njerëzore
ICT	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
INSTAT	Instituti Statistikor i Republikës së Shqipërisë
IPA	Instrumenti i Ndihmës së Para-Anëtarësimit
JTF	Task Forca e Përbashkët
JTS	Sekretariati i Përbashkët Teknik
KPI	Treguesit Kryesorë të Performancës
LFS	Anketim mbi Fuqinë Punëtore
LP	Partneri Udhëheqës (Parimi i Partnerit Udhëheqës)
LSMS	Studimi për Matjen e Standardeve të Jetesës (Banka Botërore)
MIS	Sistemi i Menaxhimit te Informacionit
MoU	Memorandum Mirëkuptimi
NACE	Klasifikimi Statistikor i Aktiviteteve Ekonomike në Komunitetin Evropian
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
NGO	Organizatë Jo-Qeveritare
NIPAC	Koordinatori Kombëtar i IPA-s
NSDI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (Republika e Shqipërisë)
NUTS	Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat
OS	Struktura Operative
PRAG	Udhëzime Praktike të Procedurave të Kontraktimit për Veprimet e Jashtme të KE
RDI	Kërkimi shkencor, Zhvillimi dhe Inovacioni
SBA	Akti për Biznesin e Vogël (EU)
SME	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme, duke përfshirë Firmat e Vogla
OMC	Metoda e Hapur e Koordinimit për Mbrojtjen Sociale dhe Përfshirjen Sociale (BE)
SWOT	Analiza e Pikave të Forta, Pikave të Dobëta, Mundësive dhe Kërcënimeve
TP	Prioritet Tematik



PËRMBLEDHJE

Titulli i programit	**Programi BNK: ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Republika e Shqipërisë**
Zona e programit	**ish Republika Jugosllave e Maqedonisë: Pellagoni, Pollog, Jug-perëndimi** **Republika e Shqipërisë: Dibër, Elbasan, Korçë**
Objektivi i përgjithshëm i programit	**Të stimulojë një zhvillim më të ekuilibruar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm në aspektin social-ekonomik, në zonën kufitare**
Prioritetet tematike të programit	**1. Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore (TP4)** **2. Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve (TP7)** **3. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut (TP2)** **4. Asistenca teknike**
Objektivat Specifike të Programit	**TP 1: Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore** **OS 1: Potenciali i turizmit është zhvilluar nga promovimi i trashëgimisë dhe vlerave kulturore** **TP 2: Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve** **OS 2: Kapaciteti produktiv i NVM-ve dhe aksesi i tyre në tregje janë forcuar** **TP 3: Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut** **OS 3: Ndërgjegjësimi për një ekonomi të gjelbër, mjedis të pastër dhe ndryshimet klimatike është rritur** **Asistenca teknike** **Zbatimi efektiv, efikas, transparent dhe në kohë i programit, dhe rritja e ndërgjegjësimit**
Alokimi financiar 2014-2020	**11 900 000.00 EURO**
Metoda e Zbatimit	**Menaxhim i drejtpërdrejtë**
Autoriteti Kontraktues	**Delegacioni i Bashkimit Evropian në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë**
Autoritetet përkatëse nga pjesëmarrësit, përfitues të IPA II	**Ministria e Vetë-Qeverisjes Lokale (ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë)** **Ministria e Integrimit Evropian (Republika e Shqipërisë)**
JTS/Antena	**JTS në Strugë, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë** **Antena në Elbasan, Republika e Shqipërisë**

Seksioni 1
Përmbledhje e Programit

Programi për bashkëpunim ndërkufitar ndërmjet Malit të Zi (MZ) dhe Shqipërisë (AL) do të zbatohet në kuadrin e Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA II). IPA II mbështet bashkëpunimin ndërkufitar me qëllim promovimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore, nxitjen e integrimit në Bashkimin Evropian dhe promovimin e zhvillimit social ekonomik. Dispozitat ligjore për zbatimin e tij janë të përcaktuara në pjesët e mëposhtme të legjislacionit:

-Rregullorja (BE) Nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014, për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA II);

-Rregullorja (BE) Nr. 236/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014, që përcakton rregullat dhe procedurat e përbashkëta për zbatimin e instrumenteve te Bashkimit Evropian për financimin e veprimit të jashtëm;

-Rregullorja Zbatuese e Komisionit të BE-së Nr. 447/2014 e datës 2 maj 2014, mbi rregullat specifike për zbatimin e rregullores IPA II.

1.1 Përmbledhje e Programit

Ky Program Bashkëpunimi Ndërkufitar mbulon periudhën 2014-2020 dhe lidhet me Perspektivën e Re Financiare të Komunitetit Evropian. Ai është hartuar mbi bazën e një analize të hollësishme të situatës në zonën e programit

Zona kufitare e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë - Republikës së Shqipërisë përbën një nga zonat më të varfra dhe me më pak mundësi dhe kushte të favorshme për zhvillim social-ekonomik në të gjithë kontinentin evropian, për shkak të karakterit rural, malor dhe të largët të Zonës BNK. Përveç kësaj, situata aktuale e zhvillimit të Zonës së Programit është rrjedhojë e një sërë faktorësh historikë, demografikë, politikë, gjeografikë dhe ekonomikë, të cilët nuk mund të kapërcehen në një periudhë kohore të shkurtër.

Ndërhyrja dhe aktivitetet e propozuara rrjedhin nga 'grupi i problemeve' e kombinuar me analizën strategjike të bilancit dhe burimet e kufizuara të Programit. Ajo synon të trajtojë nyjat problematike më të rëndësishme dhe mundësitë strategjike të identifikuara nëpërmjet analizës social-ekonomike dhe SWOT, përkatësisht:

1. nivelet e ulëta të aktivitetit ekonomik së bashku me mospërputhjen e kërkesës dhe ofertës në tregun e punës,
2. infrastrukturën e pazhvilluar dhe të vjetërsuar, dhe
3. potencialet në zhvillimin e turizmit dhe shkëmbimin kulturor.

Realisht nuk pritet që **Zona e Programit** të rritet shpejt, edhe pse **po shkon drejt një zhvillimi social-ekonomik më të balancuar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm** përmes testimit të instrumenteve dhe zgjidhjeve reja, duke mësuar nga rajone të tjera dhe duke mobilizuar dhe shfrytëzuar potencialin e brendshëm. Kjo mund të çojë në standarde më të larta të jetesës, vetë-besim dhe siguri sociale.

Programi përqendrohet në tri prioritete tematike të Rregullores IPA II që rrjedhin nga analiza e nevojave-mundësive. Përkatësisht, këto janë:

1. Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore (i nxitur nga mundësitë);
2. Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve (i nxitur nga nevojat dhe mundësitë);
3. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut (i nxitur nga nevojat).

Programi BNK përfshin e një prioritet mbi Asistencën Teknike.

1.2 Përgatitja e programit dhe përfshirja e partnerëve

Procesi i programimit të këtij Programi IPA II BNK për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë filloi në korrik të vitit 2013. E gjithë rrjedha e programimit u bazua në përvojën e përbashkët të procesit që ishte zhvilluar në periudhën 2007-2013.

Zhvillimi i këtij dokumenti të Programit u drejtua nga Task Forca e përbashkët e përbërë nga përfaqësues të dy Strukturave Operative, delegatët e zyrës së NIPAC në të dy vendet, përfaqësues të rajoneve të Zonës së Programit NUTS-3 dhe disa njësi vetë-qeverisëse. Puna e JTF u lehtësua dhe mbështet nëpërmjet Projektit të Asistencës Teknike CBIB+, financuar nga BE, i cili solli praktikën më të mirë ndërkombëtare në këtë proces.

Sesionet e punës së SO dhe JTF u realizuan në të gjithë fazën e programimit, në mënyrë që të siguronin komunikim efektiv për të identifikuar prioritetet tematike për tu trajtuar në strategjinë e

zhvillimit të Zonës së Programit dhe për ngritjen e strukturave të përshtatshme të zbatimit dhe monitorimit. Përveç konsultimeve midis dy OS-ve, në kuadër të lehtësimit të të mësuarit dhe rrjetëzimit nën Projektin CBIB+, u zhvilluan:

Data/Vendi	Aktiviteti
18/07/2013, Strugë	Takim i Strukturave Operative: identifikimi i sfidave dhe çështjeve kryesore; shkurtimi fillestar i listës së Prioriteteve Tematike dhe marrëveshja për analizën SWOT.
23/09/2013, Shkup	Takimi i parë me Ministrinë e Vetë-qeverisjes Lokale, Delegacionin e Bashkimit Evropian, ekipin e programimit dhe pikën e kontaktit kombëtare në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë.
27/09/2013, Tiranë	Trajnim mbi zhvillimin dhe formulimin e strategjisë: 14 pjesëmarrës (OSs, JTF, JTS, CBIB+): shpjegimi i procesit të programimit të IPA II CBC, diskutimi i mësimeve të nxjerra nga programi/et aktual/e, planifikimi hap pas hapi (analiza e situatës, gjetjet kryesore (SWOT, nevojat), bërja e zgjedhjeve strategjike – zgjedhja e prioriteteve, përcaktimi i prioriteteve, treguesit dhe objektivat), kontrolli i logjikës së ndërhyrjes, çështjet horizontale dhe ndërsektoriale.
30/09/2013, Shkup	Trajnim mbi zhvillimin dhe formulimin e strategjisë: 21 pjesëmarrës (OSs, JTF, JTS, CBIB+): shpjegimi i procesit të programimit të IPA II CBC, diskutimi i mësimeve të nxjerra nga programi/et aktual/e, planifikimi hap pas hapi (analiza e situatës, gjetjet kryesore (SWOT, nevojat), bërja e zgjedhjeve strategjike – zgjedhja e prioriteteve, përcaktimi i prioriteteve, treguesit dhe objektivat), kontrolli i logjikës së ndërhyrjes, çështjet horizontale dhe ndërsektoriale.
04/10/2013, Shkup	Takim i Task Forcës së përbashkët: reagime nga analiza SWOT fillestare, takimi me ekipin e Asistencës Teknike, diskutim mbi prioritetet tematike dhe logjikën e ndërhyrjes, hapat për të përfunduar dokumentin e Programit (14 pjesëmarrës).
24/10/2013, Strugë	Takim i Task Forcës së përbashkët: situata përfshirëse dhe analiza SWOT, konfirmimi i prioriteteve tematike dhe përzgjedhja fillestare e aktiviteteve dhe aksioneve; diskutimi mbi treguesit; alokimet financiare.
07/11/2013, Tiranë	Takim i Task Forcës së përbashkët: Diskutimi mbi Strategjinë e Ndërhyrjes së Programit dhe Aktivitetet.
21-22/11/2013, Beograd	Forumi Rajonal Konsultativ CBC
06/12/2013, Elbasan	Konsultim publik: U prezantua Dokumenti i Programit, si dhe procesi i zhvillimit të tij, zgjedhja e prioriteteve tematike dhe hapat e ardhshme. Zgjedhja e prioriteteve tematike u konfirmua nga palët e interesuara (14 pjesëmarrës).
11/12/2013, Tiranë	Takimi i Komitetit Monitorues të përbashkët: një temë e veçantë e rendit të ditës ishte prezantimi i procesit të programimit 2014-2020 midis ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë-Republikës së Shqipërisë para përfaqësuesve të JMC nga ministritë e linjës së të dy vendeve, përfaqësuesve të pushtetit vendor, EUD dhe OS-ve (36 përfaqësues).
12/12/2013, Tiranë	Takim teknik me OS-në, DG ENLARG, EUD dhe CBIB +: u zhvillua diskutim mbi Strategjinë e Programit dhe programe të tjera CBC në zhvillim e sipër.
12/12/2013, Pogradec	Seminar i konsultimit publik paraprak: U prezantua Dokumenti i Programit tek palët e interesuara, si dhe procesi i zhvillimit të tij, zgjedhja e prioriteteve tematike dhe hapat e ardhshme. Zgjedhja e prioriteteve tematike u konfirmua nga palët e interesuara (11 pjesëmarrës).
13/12/2013, Korçë	Seminar i konsultimit publik paraprak: U prezantua Dokumenti i Programit tek palët e interesuara, si dhe procesi i zhvillimit të tij, zgjedhja e prioriteteve tematike dhe hapat e ardhshme. Zgjedhja e prioriteteve tematike u konfirmua nga palët e interesuara (13 pjesëmarrës).
16/12/2013, Dibër	Seminar i konsultimit publik paraprak: U prezantua Dokumenti i Programit tek palët e interesuara, si dhe procesi i zhvillimit të tij, zgjedhja e prioriteteve tematike dhe hapat e ardhshme. Zgjedhja e prioriteteve tematike u konfirmua nga palët e interesuara (15 pjesëmarrës).
14/03/2014, Strugë	Konferenca e konsultimit publik me pjesëmarrjen e palëve të interesuara nga të dy vendet: Komenti mbi përmbajtjen teknike të ndërhyrjes së Programit dhe propozimi për ri-formulimin e aktiviteteve të Programit (54 pjesëmarrës).
31/03/2014, Strugë	Takimi i Sekretariatit të Përbashkët Teknik: Diskutim mbi përmbajtjen e Programit

	(drafti i dytë), konsensus për ndërhyrjen, aksionet dhe aktivitetet që kanë vijuar nga aktivitetet e konsultimit publik, të mbajtura deri në këtë moment (20 pjesëmarrës).
Maj 2014	Dorëzimi i draftit final të programit tek Komisioni Evropian.

Gjithashtu, partnerë të tjerë të rëndësishëm socialë dhe ekonomikë u ftuan të marrin pjesë aktivisht në procesin e programimit për Programin IPA CBC II për periudhën 2014-2020 midis ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë. Qëllimi i kësaj ishte i trefishtë:

1. Të informojë publikun e gjerë mbi gjendjen e përgatitjes së programit për bashkëpunimin ndërkufitar, duke përfshirë fushat orientuese të aktiviteteve të pranueshme për tu mbështetur në kuadrin e këtij programi;
2. Të kontribuojë për analizën SWOT dhe identifikimin e nevojave dhe mundësive prioritare për ndërhyrjet CBC; dhe
3. Ti ofrojë publikut të gjerë një mundësi për të shprehur mendimet e tyre dhe për të dhënë kontribut të vlefshëm në procesin e programimit. Konsultimi publik është organizuar para finalizimit të dokumentit të Programit.

Krahas atyre, parimi i partneritetit është zbatuar nëpërmjet konsultimeve individuale të koordinuara me mbi 80 organizata të shoqërisë civile, kryesisht për analizën SWOT dhe caktimin e prioriteteve tematike, si edhe nëpërmjet pjesëmarrjes së palëve kryesore të interesuara rajonale dhe lokale në seminaret konsultative.

Seksioni 2
Zona e Programit

Mbulimi gjeografik dhe madhësia e zonës përfituese të Programit rrjedh nga asistenca e mëparshme IPA CBC për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë, dhe mbulon tre rajone NUTS-3 në secilin nga vendet. Këto rajone janë të shënuara më poshtë.

Rajonet e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë	Madhësia e Zonës së Programit (km^2)	Zona e Programit si % e madhësisë së shtetit
Pellagonia	4,717	18.3
Jug-Perëndimi	3,340	13.0
Pollogu	2,416	9.4
TOTAL	**10,473**	**40.7**

Rajonet e Republikës së Shqipërisë	Madhësia e Zonës së Programit (km^2)	Zona e Programit si % e madhësisë së shtetit
Korça	3,711	12.9
Dibra	2,586	9.0
Elbasani	3,199	11.1
TOTAL	**9,496**	**33.0**

Burimi: Zyra e Statistikave, INSTAT

Madhësia e përgjithshme e Zonës Ndërkufitare në të dy vendet është 19,969 km^2. Rajonet e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë përbëjnë 52,5% dhe rajonet e Republikës së Shqipërisë përbëjnë 47.5% të madhësisë së zonës së bashkëpunimit ndërkufitar.

Gjatësia e kufirit midis të dy vendeve që përfaqësojnë zonën e Programit është 191 km. Vija kufitare është e shumëllojshme: 151 km është kufi tokësor, 12 km është kufi në lumin Drin dhe 28 km i kufirit përshkon liqenin e Ohrit dhe Prespës.

Ka 4 pika të vendkalimeve kufitare ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë:

1. Nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, përmes Qafë Thanës, duke çuar në Pogradec, Librazhd dhe Elbasan;

2. Nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, përmes Tushemishtit, në skajin juglindor të liqenit të Ohrit, duke çuar në Pogradec;

3. Nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, përmes Bllatës, duke çuar në Peshkopi, Bulqizë dhe Burrel;

4. Nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, përmes Goricës, duke çuar në brigjet veriore të Liqenit të Prespës.

Gjashtë rajonet që përbëjnë zonën e Programit kanë një popullsi prej 1,427,675 banorë, nga të cilët ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë përmban 54% të këtij numri, dhe Republika e Shqipërisë përmban 46% të tyre.[2]

Rajonet e pranueshme në territorin e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë përfshijnë 27 komuna, ndërsa në territorin e Republikës së Shqipërisë janë 12 rrethe (me 17 komuna) që hyjnë në zonën e Programit. Këto janë të shënuara më poshtë.

Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë:

Rajoni i Pellagonisë përfshin 9 komuna: Manastir, Demir Hisar, Dollnen, Krivogashtan, Krushevë, Mogilla, Novac, Prilep, dhe Resnjë;

Rajoni i Pollogut përfshin 9 komuna: Bogovinjë, Bërvenicë, Gostivar, Jegunovcë, Mavrovë dhe Rostushë, Tearcë, Tetovë, Vrapçisht dhe Zhelinë;


Rajoni Jugperëndimor mbulon 9 komuna: Qendër Zhupë, Dibër, Debarcë, Kërçovë, Brod, Ohër, Plasnicë, Strugë dhe Vevçan.

Në Republikën e Shqipërisë:

Qarku i Dibrës përfshin rrethet: Bulqizë, Burrel dhe Dibër;

Qarku Elbasan përfshin rrethet Cërrik, Elbasan, Gramsh, Librazhd dhe Peqin;

Qarku Korçë përfshin rrethet Devoll, Korçë, Kolonjë dhe Pogradec.



[2]Deri në fund të vitit 2012; burimi: INSTAT dhe Zyra Shtetërore e Statistikave

2.1 Analiza e Situatës – Përmbledhje

Zona e Programit karakterizohet nga burime të pasura natyrore, diversitet etnik dhe kulturë e ngjashme, por me gjuhë të ndryshme të folura. Megjithatë, më e rëndësishmja është se zonat kufitare në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë shfaqin trashëgimi të ndryshme ekonomike, që përcakton arsyetimin dhe potencialin për bashkëpunim ndërmjet njerëzve dhe institucioneve përtej kufirit për integrim dhe kohezion social dhe ekonomik më të mirë të rajonit.

Kjo përmbledhje bën dallimin ndërmjet aspekteve të përgjithshme dhe demografike, ekonomike dhe sociale të kohezionit, që frymëzojnë Strategjinë për ndërhyrjen e bashkëpunimit ndërkufitar 2014-2020, ndërsa një situatë më e hollësishme dhe analiza SWOT janë bashkëlidhur si shtojca në dokumentin e Programit.

Aspektet e Përgjithshme dhe Demografike

1. Natyra dhe mjedisi janë të pasura me male, fusha kodrinore të kryqëzuara me lumenj, lugina dhe liqene. Kjo zonë përmban tre rezervuare të mëdha të ujit në rajon: Liqenin e Ohrit, Prespës dhe Dibrës, të rrethuar nga një Park Kombëtar duke krijuar kështu kushte të favorshme për zhvillimin e energjisë hidrike, në të cilën të dy vendet kanë investuar tashmë. Zonat ekologjikisht të ndjeshme janë të pajisura me mundësitë e zhvillimit të turizmit dhe rajoni përmban gati gjysmën e pyjeve të të dy vendeve.

2. Zona e Programit përmban dy korridore të transportit Pan-Evropian: Korridori VIII dhe Dega D e Korridorit X, të cilat hapin mundësi ekonomike përgjatë dy rrugëve të transportit, por gjithashtu krijojnë sfida në aspektin e mirëmbajtjes së mjedisit dhe infrastrukturës.

3. Të dy vendet shfaqin një nivel pothuajse të barabartë të zhvillimit ekonomik dhe gëzojnë përmirësimin e vazhdueshëm në marrëdhëniet dypalëshe, si dhe rritje në shkëmbimin e mallrave dhe shërbimeve. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka marrë statusin e vendit kandidat në BE, ndërsa aplikimi i Republikës së Shqipërisë varet nga progresi i mëtejshëm i reformës së administratës publike dhe rishikimi i rregullave dhe procedurave parlamentare.

4. Të dy vendet gëzojnë norma pozitive të rritjes natyrore, por numri i popullsisë po rritet më shpejt në Republikën e Shqipërisë se sa në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Megjithatë, me përjashtim të rajonit të Pollogut dhe atij Jugperëndimor, zona e programit po përjeton tendenca negative. Të dy vendet vuajnë nga migrimet e jashtme, të cilët mund të kontribuojnë në shpopullim. Indeksi mesatar i dendësisë së popullsisë është i ngjashëm në të dyja anët e kufirit, por shifra shumë të ulëta të dendësisë së popullsisë janë regjistruar në rrethet (prefekturat) e Dibrës dhe Korçës, të cilat tregojnë karakterin e tyre rural dhe periferik.

5. Popullsia në zonën e programit është relativisht e re (36 vjeç), por Pellagonia me një moshë mesatare të popullsie prej 40 vjeç, përbën dallim nga pjesa tjetër e rajonit.

Kohezioni Ekonomik

6. Pabarazitë rajonale në të dy vendet në aspektin e GDP-së për frymë, në përgjithësi konsiderohen të moderuara, por zona e programit përmban rajone që në mënyrë të qartë mbeten prapa; këto janë: Pollogu në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Dibra në Republikën e Shqipërisë (përkatësisht 47% dhe 62% e shifrave kombëtare).

7. Struktura e ekonomisë e përcaktuar nga GVA është e ndryshme në të dyja anët e kufirit. Ndërsa rajonet e Republikës së Shqipërisë mbështeten në bujqësi, pylltari, peshkim dhe tregjet me shumicë dhe pakicë, rajonet në territorin e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë mbështeten në industri, e cila është më e zhvilluar se në Shqipëri, ndërtim dhe tregjet e shërbimeve. Megjithatë, këto nuk përkthehen në GDP shumë më të lartë për shifrat kapitale, dhe tregojnë nivele të ulëta të konkurrencës së këtyre sektorëve dhe industrive.

8. Konkurrenca e ulët është reflektuar në nivelet e ulëta të ndërkombëtarizimit të ekonomisë së zonës së Programit. Vetëm Pellagonia në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe

Elbasani në Republikën e Shqipërisë, dëshmojnë një pozicion të shquar në tregun e jashtëm, kryesisht për shkak të industrisë minerare, ndërsa rajonet e tjera luajnë rol të parëndësishëm.

9. Sipërmarrja e dëshmuar nga dendësia e SME-ve në raport me dendësinë e popullsisë është në nivele shumë të ulëta, e cila është një çështje e shqetësimit të lartë. Rregullat administrative të komplikuar dhe afatgjatë për tregtinë e jashtme konsiderohen si burokraci, duke penguar mundësitë e tregtisë.

10. Shkalla e punësimit është e ulët në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në mënyrë të konsiderueshme më e lartë në Republikën e Shqipërisë, por për këtë të fundit shkalla e punësimit të lartë rezulton nga niveli minimal i jetesës dhe nga prodhimi bujqësor në shkallë të ulët, i cili siguron një formë të sigurimeve shoqërore për pjesën më të madhe të popullsisë rurale, dhe shërben si amortizator kundër normave të larta të papunësisë së regjistruar.

11. Zona e programit ka potencial të lartë turistik, por këto mundësi janë përqendruar kryesisht në anën e kufirit të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë.

12. Ekonomia rurale është e fragmentuar, por në një shkallë më të lartë në zonën e programit në Republikën e Shqipërisë dhe pronarët e vegjël bujqësorë kanë vështirësi për të hyrë në treg. Prodhimi është mesatarisht i larmishëm dhe gama e prodhimeve kryesore bujqësore në të dyja anët e kufirit është më shumë plotësuese sesa konkurruese.

13. Infrastruktura e transportit është e pazhvilluar dhe kjo lidhet si me rrugët lokale, edhe me rrugët kryesore të Korridorit VIII.

Kohezioni Social

14. Zona e programit përmban pakica etnike të konsiderueshme: shqiptarë, romë, turq dhe të tjerë.

15. Nivelet e papunësisë janë shumë të larta për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe relativisht të ulëta në Republikën e Shqipërisë. Për këtë të fundit, kjo dukuri është shkaktuar nga punësimi i lartë (kryesisht informal) në pronat bujqësore.

16. Pagat neto të punonjësve janë në nivele të ngjashme.

17. Zona e Programit në Republikën e Shqipërisë përjeton përjashtim dixhital. Përdorimi i kompjuterëve dhe i Internetit është në nivele të ulëta të papranueshme.

18. Aksesi në arsimin fillor është i balancuar, por ka një sforcim të dëshmuar në arsimin e mesëm në rajonin e Dibrës. Kjo prefekturë gjithashtu pëson shkallën më të lartë të largimit të popullsisë me arsim të lartë në të gjithë zonën e Programit.

19. Nuk ka të dhëna specifike mbi RDI, por praktikisht mungon bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të arsimit në të dy vendet dhe fusha e hulumtimit, zhvillimit dhe inovacionit nuk është eksploruar.

20. Niveli i ulët i menaxhimit të mbetjeve, i çiftëzuar me intensitetin e lartë të minierave, janë një shqetësim i madh mjedisor. Kjo lidhet me përdorimin e mbetjeve të ngurta dhe mungesën e trajtimit të ujërave të zeza në pjesën më të madhe të zonës së programit.

2l. Organizatat e shoqërisë civile janë të pranishme në zonën e programit, megjithatë pozita e tyre financiare është e dobët. Përveç kësaj, OJQ-të në Republikën e Shqipërisë hasin vështirësi me procedurën e regjistrimit, dhe si pasojë legjitimiteti i tyre është penguar.

22. Infrastruktura e kujdesit shëndetësor është e pazhvilluar dhe veçanërisht në zonën e programit të Republikës së Shqipërisë, është e vështirë për të përfituar nga ky shërbim.

2.2 Gjetjet kryesore

Analiza social-ekonomike e kombinuar me vlerësimin e analizës SWOT identifikoi nyjat kyçe problematike për zonën e programit. Këto janë:


-Nivele të ulëta të aktivitetit ekonomik (performancës dhe produktivitetit);

-Lidhur me këtë ka mospërputhje të kërkesës dhe ofertës në tregun e punës;

-Qasje e pa strukturuar në investimet publike dhe aktivitetet e përbashkëta për mbrojtjen e mjedisit dhe planifikimin.

Tre nyjat kryesore problematike janë ndarë më tej në nën-nyja për të reflektuar rrjedhën e marrëdhënies shkak-pasojë që ofron një kontekst strategjik dhe arsyetimin për zonat e ndërhyrjes CBC. Grupi logjik i problemit (ose vendimit) është përshkruar më poshtë.

Përveç këtyre nyjave strategjike, kapaciteti i ulët institucional i njësive të vetë-qeverisjes lokale dhe organizatave të shoqërisë civile paraqitet si një problem thelbësor ndërsektorial dhe çështje shumë problematike, e cila manifestohet në planifikimin e mangët dhe alokimin e burimeve të kufizuara.



Shkaqet (ose problemet rrënjësore) në tabelën e mësipërme janë identifikuar përmes analizës së situatës dhe analizës SWOT. Ato njihen si pikat që kanë karakter ndër-sektorial apo ndër-tematik, dhe kështu lidhen me tre prioritetet tematike për ndihmë për bashkëpunimin territorial siç janë identifikuar në Aneksin III të Rregullores së IPA II:

1. Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve;[3]

2. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut;

Përveç problemeve, turizmi dhe trashëgimia kulturore janë identifikuar si një mundësi e rëndësishme ekonomike dhe një mjet për të rritur më tej kontaktet dhe shkëmbimin njerëz-për-njerëz. Kjo lidhet me një tjetër prioritet tematik për asistencën për bashkëpunim territorial në Shtojcën III të Rregullores së IPA II, që është inkurajimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

[3]Të lidhura me punësimin (TP1) i cili do të konsiderohet si një çështje ndërsektoriale.

Të gjitha prioritetet tematike janë renditur në mënyrë individuale nga palët e interesuara në procesin e programimit CBC (bashkitë, OJQ-të, ministritë e linjës, shoqëritë e shërbimeve publike dhe subjektet e tjera publike, etj.) sipas rëndësisë së perceptuar të tematikave dhe çështjeve.[4] Renditja paraqet një reagim të rëndësishëm të programimit që pasqyrohet në qasjen nga poshtë-lart dhe është ndërtuar mbi parimin e **partneritetit**. Megjithatë, kjo nuk i merr në konsideratë kufijtë e politikave dhe burimeve, të cilët janë aplikuar vetëm nëpërmjet mekanizmit dhe parimit të **koordinimit** (pjesa 3).

Seksioni 3
Strategjia e Programit

Strategjia njeh prioritetet e komunikuar nga palët e interesuara të programit (seksioni 2.2) të cilat më pas janë përpunuar dhe paraqitur nga Strukturat Operative CBC dhe Task Forca e Përbashkët në krye të përpjekjeve të programimit duke aplikuar parimin e **koordinimit**. Zgjedhjet strategjike janë bërë duke marrë parasysh parimet e mëposhtme mbizotëruese:

Koherenca - Prioritetet tematike nuk u ndryshuan dhe janë të njëjtët që janë komunikuar në Shtojcën III të Rregullores IPA II, dhe përkatësisht në Dokumentin e Strategjisë Shumë-kombëshe;

Partneriteti - Prioritetet e përshtatshme janë zgjedhur bazuar në reagimet e marra nga organizatat që përfaqësojnë autoritetet rajonale, lokale, urbane dhe autoritetet e tjera publike, partnerët shoqërorë dhe ekonomikë, si dhe shoqërinë civile, partnerët mjedisorë, organizatat jo-qeveritare dhe organizatat përgjegjëse për promovimin e barazisë;

Përqendrimi - Strategjia ofron një fokus të rëndësishëm dhe efikas të **burimeve të kufizuara** dhe të ndërhyrjes bazuar në specifikat sociale dhe ekonomike të zonës së programit që fokusohet në temat e përzgjedhura, dhe mbi objektivat dhe masat me një rëndësi të veçantë nga kohezioni social-ekonomik dhe perspektiva e dëshiruar e zhvillimit.

Plotësueshmëria me Programin Kombëtar – programi plotëson dhe përforcon strategjitë kombëtare, ashtu siç janë përcaktuar në Dokumentet e Strategjisë së Vendit, duke mbështetur bashkëpunimin rajonal dhe territorial.

3.1 Arsyetim - Arsyetimi për strategjinë e zgjedhur të ndërhyrjes

Përmbajtja e Strategjisë së propozuar rrjedh nga:

1. Analiza e situatës dhe analiza SWOT;
2. Nyjat problematike të identifikuara dhe mundësitë strategjike; dhe
3. Renditja e prioriteteve tematike sipas rëndësisë së tyre për zonën e programit: Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore, Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve, dhe Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut.

Një zhvillim social-ekonomik më i balancuar, gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm në zonën kufitare stimulohet. Ky është titulli dhe objektivi i përgjithshëm i programit, duke pasur parasysh perspektivën afatmesme në ndërhyrjen e propozuar.

Programi synon të ketë sinergji me **objektivat specifike të IPA II** dhe **Dokumentet e Strategjisë së Vendit** në lidhje me: përkrahjen për zhvillimin e shoqërisë civile dhe dialogut social, nxitjen e punësimit dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor, përfshirjen sociale dhe ekonomike, dhe bashkëpunimin territorial.

Tabela 1: Pasqyrë sintetike e justifikimit për përzgjedhjen e prioriteteve tematike

Prioritetet tematike të zgjedhur	**Justifikimi për zgjedhjen**
Nxitja e turizmit, kulturës dhe	Bazohet në mundësitë strategjike të

[4]Renditja u krye nëpërmjet pyetësorit individual SWOT që u plotësua nga aktorët kryesorë.

trashëgimisë natyrore (TP4, Rregullorja IPA II)	identifikuara që lidhen me rëndësinë në rritje të turizmit si një mundësi ekonomike, ndërsa nxitja e shkëmbimit kulturor dhe promovimi i trashëgimisë natyrore do të mbështesë nismat njerëzit për njerëz dhe dialogun ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve.
Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve (TP7, Rregullorja IPA II)	Synon të trajtojë nivelet e ulëta të punësimit në zonën e programit. Kjo do të trajtohet nëpërmjet përmirësimit të aksesit në tregje, rritjes së përdorimit të instrumenteve të TIK, duke përfshirë tregtinë elektronike dhe shfrytëzimin më efikas të mundësive të zinxhirit të vlerave në zonën kufitare.
Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut (TP2, Rregullorja IPA II)	Synon ti përgjigjet nevojave specifike të një prej sektorëve më të neglizhuar të politikave. Në kontekstin CBC ky prioritet do të trajtojë çështjet e promovimit të ekonomisë së pastër dhe të gjelbër, përdorimit më të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbështetjen e infrastrukturës së elasticitetit klimatik në shkallë të vogël (kundër përmbytjeve dhe zjarreve) dhe erozionin e tokës në zonën kufitare malore.

Asistenca Teknike do të sigurojë një menaxhim efikas të programit gjatë gjithë ciklit të jetës dhe zhvillimin e kapaciteteve të palëve të interesuara të programit. Alokimi financiar ndaj këtij prioriteti është 10% e buxhetit të programit.

Alokimi i buxhetit indikativ nëpër prioritetet tematike është një konsensus ndërmjet parimit të përqendrimit kombinuar me shpërndarjen e balancuar të fondeve. Rëndësi e veçantë i është dhënë edhe intensitetit të kapitalit të projekteve të mundshme dhe renditjes aktuale të prioriteteve tematike, ku turizmi, trashëgimia kulturore dhe natyrore janë temat më të preferuara për mbështetje.

Prioriteti Tematik	Shpërndarja e buxhetit të fondeve të BE (%)
1. Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore (TP4)	31.5
2. Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve (TP7)	31.5
3. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut (TP2)	27.0
4. Asistenca Teknike	10.0
TOTAL	100

Parimi i **rritjes së mençur, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse është i njohur si një çështje ndërsektoriale** dhe është aplikuar në të gjitha prioritetet tematike të programit dhe në objektivat e tyre.

Gjithashtu, strategjia e propozuar **bazohet në gjetjet kryesore dhe rekomandimet e raportit të vlerësimit të draftit CBC ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë – Republika e Shqipërisë** për vitet 2007-2013. Prandaj, çështjet e mëposhtme merren në konsideratë:

-Mbështetja për projekte të vogla infrastrukturore të përbashkëta që nuk kërkojnë studime dhe projektime të sofistikuara dhe komplekse;

-Asistenca ndaj projekteve që kanë për qëllim zhvillimin e studimeve dhe projektimeve për financim nga burime të brendshme dhe donatorë të tjerë;

-Fokus strategjik për veprime më të fuqishme, të cilët synojnë të sjellin ndikim më të prekshëm;

-Përmirësimi dhe orientimi më strategjik i JTS nën Asistencën Teknike, veçanërisht në lidhje me ndërtimin e kapaciteteve dhe rritjen e ndërgjegjësimit midis përfituesve të mundshëm të ndodhur në zonën e programit dhe jo jashtë saj, për të siguruar gatishmërinë e tyre për të aplikuar nën parimin e Partnerit Kryesor;

-Forcimi i rolit të koordinimit strategjik të SO-ve;

-Orientimi i JTS-ve drejt rrjeteve dhe ndarjes së përvojës së projektit ndërmjet organizatave nga zona e programit;

-Nxitja e një roli më aktiv të JTS-ve në monitorimin e programit dhe zhvillimin e mjeteve dhe manualeve të brendshme dhe për përdoruesit e jashtëm;

-Përmirësimi i planifikimit dhe zbatimit të operacioneve nga SPT.

Rekomandimet dhe mësimet e nxjerra nga dy vlerësimet e ndërmjetme mbi programet CBC të fokusuara në strukturat qeverisëse dhe në ecurinë e ndihmës, janë marrë në konsideratë[5]:

Dokumenti i programimit duhet të jetë subjekt i:

1. konsultimeve publike dhe të pasqyrojë në mënyrë të qartë procesin e konsultimeve, duke përfshirë një pasqyrë të personave që morën pjesë dhe rezultatet e procesit të konsultimit;
2. të përfshijë çështjet e ndërlidhura në të gjitha dokumentet e programimit dhe
3. të kryejë një vlerësim të bazuar në parashikime (që do të përfshihet në dokument).

-Në lidhje me çështjet organizative, strukturat e programimit duhet të:


1. kryejnë një auditim të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe vlerësimin e nevojave për trajnim;
2. transferojnë detyrat tek JTS-të, duke përfshirë edhe përgatitjen për grantet e asistencës teknike;
3. mbështesin zbatimin e sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit.

3.2 Përshkrimi i Prioriteteve Tematike të Programit

Përshkrimi i secilit prioritet tematik (TP) është organizuar në formën e Fletës me të dhëna për Prioritet me përmbajtje dhe strukturë të njëjtë për secilin prioritet, ndërsa prioriteti i Asistencës Teknike ka një përbërje të veçantë.

Numërimi i prioritetit tematik të programit është radhitur sipas radhës së rëndësisë së TP, e llogaritur gjatë ushtrimeve të programimit duke iu referuar regjistrimit të caktuar të TP të identifikuar në Rregulloren e IPA II.

Figura e mëposhtme përshkruan logjikën e ndërhyrjes së programit dhe kryqëzimin e prioriteteve individuale me çështjet e ndërthurura dhe horizontale.



[5] Vlerë[illegible]m[illegible]k[illegible]andidatë të mundshëm (kufijtë e Ballkanit Intra-perëndimor) nën Komponentin e Bashkë[illegible]k[illegible], Raporti II - Performanca e ndihmës.

Prioriteti 3:
Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut

Asistenca Teknike

Meqë perspektiva e programimit për vitet 2014-2020 është më e orientuar drejt rezultateve se sa kuadri i IPA 2007-2013, të gjithë treguesit e rezultateve të paraqitur në fletët e të dhënave më poshtë synojnë që të informojnë mbi përzgjedhjen e operacioneve dhe projekteve që do të mbështeten. Këto do të kontribuojnë drejtpërdrejt në përcaktimin e treguesve për Programin.

Përmbajtja e ndërhyrjes e përshkruar më poshtë ka marrë në konsideratë vërejtjet dhe komentet konstruktive të prodhuara gjatë aktiviteteve të konsultimeve publike të zhvilluara në zonën e programit në periudhën dhjetor 2013 - mars 2014.

Prioriteti Tematik 1: Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore (TP4)

Përmbledhje e Prioritetit Tematik dhe Referenca Strategjike

Evropa është destinacioni nr. 1 i turizmit në botë, me turizmin kulturor dhe një numër të madh të vendeve turistike, si dhe me një rrjedhë të fortë të vizitorëve ndërkombëtarë dhe vendas. Politikat e turizmit duhet të përshtaten me këto tendenca dhe të zhvillojnë një ofertë cilësore, duke promovuar kulturat dhe traditat lokale dhe duke i kushtuar vëmendje aspekteve të qëndrueshëm: ruajtja e trashëgimisë, e peizazhit dhe e kulturës lokale. Zona e programit synon të shfrytëzojë mundësitë strategjike që dalin nga potenciali më i gjerë i të gjithë kontinentit, i cili është në përputhje me konceptin e turizmit të qëndrueshëm dhe kulturor të promovuar nga DG Sipërmarrje dhe Industri.

Turizmi ka qenë i njohur si një nga mundësitë ekonomike prioritare që janë me interes për popullsinë në zonën CBC. Edhe pse industria e mikpritjes është e shpërndarë në mënyrë të pabarabartë në zonën e programit, në të dyja vendet industria po rritet. Aktualisht, aktivitetet e lidhura me turizmin janë burimi kryesor i të ardhurave për popullsinë në rajonet e Ohrit dhe Prespës në muajt e verës, por ka shumë potencial të pashfrytëzuar për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm kulturor dhe zbavitës në të gjithë rajonin CBC.

Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe organizatave të ndryshme në rajonin CBC është në rritje, por ende ekziston një mungesë praktike e iniciativave të qëndrueshme të përbashkëta në një shkallë më të gjerë. Aktivitetet e përfshira në këtë prioritet tematik do të mbështesin bashkëpunimin midis institucioneve, bazuar në vlerësimin e ofertës heterogjene dhe potencialin e kulturave dhe traditave të ndryshme të pranishme në zonë, si dhe aksionet njerëzit-për-njerëzit. Këto duhet të kontribuojnë për trajtimin e sfidave të tilla si ruajtja e burimeve natyrore dhe kulturore, nxitja e mirëqenies së komuniteteve lokale, përmirësimi i cilësisë së vendeve të punës në fushën e turizmit, kufizimi i ndikimit mjedisor të transportit që lidhet me turizmin, etj.

Objektivi Specifik

Objektivi Specifik i këtij Prioriteti Tematik synon **të zhvillojë potencialin e turizmit duke promovuar trashëgiminë dhe vlerat kulturore** (SO 1.1).

Prioriteti Tematik do të inkurajojë shumëllojshmërinë e ofrimit të shërbimeve dhe produkteve turistike. Duke mbështetur projekte që promovojnë produkte tematike turistike të qëndrueshme, programi do të forcojë bashkëpunimin trans-nacional në lidhje me turizmin e qëndrueshëm, do të inkurajojë një përfshirje më të madhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të autoriteteve lokale, dhe do të stimulojë konkurrencën e industrisë së turizmit me anë të një fokusimi të

përmirësuar mbi shumëllojshmërinë e produkteve tematike të qëndrueshme dhe të turizmit kulturor. Gjithashtu, prioriteti tematik synon të rrisë aftësitë e stafit të angazhuar në industrinë e mikpritjes, duke përfshirë trajnimin profesional për të eliminuar mangësitë në aftësitë për të prezantuar një ofertë të larmishme turistike, p.sh. për guidat turistike dhe trajnerët e specializuar në sportet e dimrit, sportet malore, turizmin rural dhe aventurën, personelet e shërbimit të hoteleve, etj.

Rezultatet e Pritshme

Ky prioritet tematik synon të arrijë rezultatet e mëposhtme:

1.1.1 Mundësitë e biznesit për ofruesit lokalë të shërbimeve dhe operatorët në fushën e turizmit janë rritur;

1.1.2 Bashkëpunimi i ndërsjellë, mirëkuptimi dhe respekti për trashëgiminë dhe vlerat kulturore janë zhvilluar më tej.

Aktivitetet e parashikuara dhe grupet e synuara

Aktivitetet e parashikuara dhe grupet e synuara janë organizuar në tabelën e mëposhtme.

Aktivitetet e parashikuara	Grupet e synuara të përfituesve
1.1.1.1 Projektimi, zhvillimi dhe promovimi i produkteve dhe shërbimeve të përbashkëta turistike dhe i investimeve në shkallë të vogël në infrastrukturën publike të turizmit	Njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale Ofruesit e shërbimeve turistike OJQ-të, OSHC-të Parqet kombëtare Dhomat e tregtisë Rrjetet / grupet e NVM-ve
1.1.1.2 Trajnim për rritjen e aftësive në industrinë e mikpritjes	Institucionet arsimore e AAP Institucionet e arsimit të lartë Institucione të tjera formale dhe jo-formale arsimore dhe trajnuese OJQ-të, OSHC-të Rrjetet / grupet e NVM-ve
1.1.2.1 Restaurimi / rezervimi, ruajtja, pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore dhe historike, dhe e mjedisit të lidhur me këto objekte	Njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale Ofruesit e shërbimeve turistike OJQ-të Institucionet kulturore (muzetë, bibliotekat, orkestrat, etj.) Operatorët në industrinë e mikpritjes (NVM)
1.1.2.2 Mbështetje për aktivitete të përbashkëta kulturore	Njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale OJQ-të Institucionet e arsimit (në të gjitha nivelet) Institucionet kulturore (muzetë, bibliotekat, orkestrat, etj.) Banorët dhe organizatat e tyre

Treguesit e Performancës së Zbatimi të Prioritetit Tematik

Rezultati 1.1.1 i Objektivit Specifik: Mundësitë e biznesit për ofruesit lokalë të shërbimeve dhe operatorët në fushën e turizmit janë rritur

Treguesi i Kontributitit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Nr. i shërbimeve/ produkteve të reja/përmirësuara	Shërbimet/ produktet e reja të përmirësuara	0	4	10	Sistemi i monitorimit	Çdo vit, nga data e zbatimit
Nr. i personave të trajnuar	Trajnimi i njerëzve në industrinë e	0	50	500	Sistemi i monitorimit	Çdo vit, nga data e zbatimit

	mikpritjes					

Treguesi i Rezultatit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Nr. i turistëve që përdorin shërbimet e reja/ përmirësuar	Turistët përdorin shërbimet e reja/ përmirësuara	0	2,000	5,000	Sistemi i monitorimit	Çdo vit, nga data e zbatimit

Treguesi i Ndikimit	Përshkrimi	Vlera bazë*	Vlera e synuar (2020)**	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit të turistëve (me fjetje)	Numri mesatar i qëndrimeve me fjetje për turistët e regjistruar	2,8 netë qëndrim me fjetje (të dhënat e 2013, duke përfshirë edhe statistikat nga të dy vendet në zonat përfituese)	I rritur me 1 natë	Zyra Statistikore Shtetërore dhe INSTAT	Çdo vit, nga data e zbatimit

* Burimi: Zyra Statistikore Shtetërore, http://www.stat.gov.mk/prikaziPublikacija_1.aspx?rbr=483. Të dhënat janë marrë nga Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve në Shqipëri, 2013

** Grumbullues

Rezultati 1.1.2 i Objektivit Specifik: Bashkëpunimi i ndërsjellë, mirëkuptimi dhe respekti për trashëgiminë dhe vlerat kulturore janë zhvilluar më tej

Treguesi i Kontributitit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)*	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Nr. i vendeve të trashëgimisë kulturore të përmirësuar	Përmirësimi i vendeve të trashëgimisë kulturore	0	2	4	Sistemi i monitorimit	Çdo vit, nga data e zbatimit
Nr. i aktiviteteve të organizuara	Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta kulturore	0	10	20	Sistemi i monitorimit	Çdo vit, nga data e zbatimit
Financimet e reja për libraritë e dixhitalizuara	Financime të reja për koleksione / librari kulturore të krijuar	0	2	5	Sistemi i monitorimit	Çdo vit, nga data e zbatimit

* Grumbullues

Treguesi i Rezultatit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Nr. i vizitorëve në vendet e trashëgimisë kulturore	Njerëzit vizitojnë vendet e trashëgimisë kulturore	PËR TU VENDOSUR *	I rritur me 7% për vendet dhe subjektet e ndërhyrjes së programit	I rritur me 15% për vendet dhe subjektet e ndërhyrjes së programit	Sistemi i monitorimit Zyra Statistikore Shtetërore dhe	Çdo vit, nga data e zbatimit

					INSTAT	

* Vlera bazë lidhet me performancën e përfituesve/grupeve të synuara para ndërhyrjes; Shifrat përkatëse për të matur vlerën bazë, duhet të sigurohen nga aplikanti në formularin e aplikimit për grante.

Treguesi i Ndikimit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
% e palëve të treta të përfshira në aktivitete	Raporti i palëve të interesuara që u angazhuan në aktivitetet kulturore në kuadër të programit	1465*	E rritur me 10% në krahasim me 2007-2013	Sistemi i monitorimit	Çdo vit, nga data e zbatimit

* Raporti Vjetor i Zbatimit (AIR) 2013

Modalitetet e zbatimit[6]

Aktivitetet e parashikuara nën këtë prioritet tematik do të zbatohen nëpërmjet modaliteteve të skemës së granteve në bazë të metodologjisë së thirrjeve për projekt propozime brenda regjimit të PRAG.

Aktiviteti që synon përmirësimin e aftësive të personelit të industrisë së mikpritjes duhet të përfshijë përfaqësuesit e industrisë si aktorët kryesorë në secilin projekt propozim.

Në kuadër të këtij prioriteti tematik është parashikuar një gamë e gjerë e përfituesve të mundshëm. Vetëm për Aktivitetin 1.1.2.2 pritet një numër i konsiderueshëm i projekteve të vogla që do të nxisin bashkëpunimin njerëz-për-njerëz dhe institucion-për-institucion.

Aktivitetet 1.1.1.1 dhe 1.1.2.1 do të zbatojnë projekte me ndikim më të rëndësishëm afatgjatë, të tilla si infrastruktura e turizmit në shkallë të vogël dhe renovimi i monumenteve historike dhe kulturore.

Qëllimi i ndërhyrjes në këtë prioritet tematik mund të kryqëzohet pjesërisht me mbështetjen e dhënë nëpërmjet prioritetit tematik 2, veçanërisht në lidhje me sipërmarrjet private, të cilat do të jenë aplikues dhe përfitues të pranueshëm. Në këtë aspekt, është hartuar linja ndarëse në vijim: palët e interesuara të prioritetit tematik (partnerët ose bashkëpunëtorët sipas modaliteteve PRAG) që bien në kategorinë e SME-ve duhet të përfshihen nën seksionin 1 të NACE: Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit.

Dy skenarë janë parashikuar për të siguruar mbështetje granteve:

1. Aktivitetet 1.1.1.1, 1.1.2.1 do të mbështeten në perspektivën afatmesme pasi kërkojnë një mbështetje më të gjerë për lehtësimin, mobilizimin dhe zhvillimin e projektit se sa aktivitetet e tjera. Kështu, ato do të përfshihen vetëm në raundin e dytë dhe të tretë të thirrjeve për projekt propozime, ndërsa Aktivitetet 1.1.1.2 dhe 1.1.2.2 do të mbështeten nëpërmjet raundit të parë dhe të tretë të thirrjeve për projekt propozime.

2. I gjithë prioriteti tematik do të zbatohet nëpërmjet një thirrje për projekt propozime (përjashtim mund të bëhet për aktivitetin 1.1.2.2 i cili mund të përsëritet në çdo thirrje për projekt propozime, kur është rasti për të reduktuar barrierat e hyrjes për aplikuesit me kapacitet më të ulët financiar).

Një thirrje e vetme për propozime mund të mbulojë më shumë se një prioritet tematik. Kur është e nevojshme dhe e mundur, thirrja për projekt propozime do të përfshijë ndarjet e buxhetit nga alokimet e ndryshme financiare vjetore, në mënyrë që të promovojë projekte në një shkallë më të madhe.

---

[6] Këto janë të natyrës parashikuese, bazuar në supozimin që deri në tre CFP do të organizohen gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit. Modaliteti mund të ndryshojë gjatë zbatimit të programit.

Prioriteti Tematik 2: Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve (TP7)

Përmbledhje e Prioritetit Tematik dhe Referenca Strategjike

Papunësia e lartë, nivelet e ulëta të punësimit dhe vlerës së shtuar në ekonominë e zonës së programit është një çështje e shqetësimit të lartë. Kështu, nxitja, mbështetja dhe krijimi i vendeve të punës dhe burime alternative të të ardhurave paraqitet si një nga objektivat kryesore të politikës së zhvillimit social-ekonomik të rajonit CBC në këto rrethana.

Prioriteti tematik do të synojë të mbështesë aksesin në tregjet të operatorëve ekonomikë në të gjithë sektorët kryesorë të ekonomisë në zonën e programit, rritjen e përdorimit të instrumenteve të TIK dhe teknologjisë, dhe shfrytëzimin e mundësive të pashfrytëzuara të zinxhirit të vlerave, duke përfshirë ato në ekonominë rurale. Pritet që këto të kontribuojnë në rritjen e konkurrencës, zhvillimin e tregtisë dhe investimet e reja në zonën e programit.

Aktivitetet e këtij prioriteti tematik kanë si qëllim të trajtojnë një numër të kufizuar të mundësive strategjike që lidhen me konkurrencën, e cila mbetet një nga shtyllat kryesore të Strategjisë së Evropës 2020. Qëllimi i ndërhyrjes së propozuar është plotësisht në përputhje me qasjen e sektorit IPA II: Zona A e Politikës - procesi i tranzicionit dhe ndërtimi i institucioneve, sektori: Zhvillimi i Sektorit Privat, dhe Objektivi tematik 3 i ndërhyrjes së Fondeve Strukturore: Konkurrueshmëria e SME-ve.

Objektivi Specifik

Ky prioritet tematik përqendrohet në **forcimin e kapaciteteve prodhuese të SME-ve dhe aksesit të tyre në tregje** (SO 2.1).

Ndërhyrja do të përqendrohet në përmirësimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi mundësitë që rrjedhin nga hapjet e zinxhirit të vlerave ekonomike ekzistuese, mbështetjen në drejtim të produktit dhe procesit të certifikimit të cilësisë të kërkuar në tregjet ndërkombëtare, dhe në përdorimin e gjerë të teknikave të shitjes moderne, duke përfshirë tregtinë elektronike. Në mënyrë që të rritet ekonomia rurale dhe mundësitë e saj strategjike, do të sigurohet një fushatë për të hapur / zhvilluar tregjet e organizuar të prodhimeve të freskëta.

Rezultatet e pritshme

Rezultati i pritshëm i lidhur me objektivin specifik të prioritetit tematik është:

2.1.1 Ndërgjegjësimi dhe kapaciteti i SME-ve dhe bizneseve të reja për të hyrë në tregjet e reja dhe zinxhirët e vlerave janë rritur.

Aktivitetet e parashikuara dhe Grupet e Synuara

Aktivitetet e parashikuara dhe Grupet e Synuara janë grupuar në tabelën e mëposhtme.

Aktivitetet e parashikuara	Grupet e Synuara të Përfituesve
2.1.1.1 Asistencë për SME-të dhe bizneset e reja për ndërkombëtarizim dhe gjetjen e partnerëve të biznesit	Njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale Organizatat anëtare të biznesit (p.sh. dhomat e tregtisë / artizanatit) Shoqatat e SME-ve, grupimet dhe rrjetet e tyre Organizatat RDI dhe institucionet e arsimit të lartë
2.1.1.2 Investime në tregun e vogël ndërkufitar dhe në objekte tregtare	Njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale Qendrat për zhvillim të rajoneve planifikuese Ndërmarrjet publike (në pronësi mbi 50% nga organet publike) - në rast të zhvillimit të tregjeve ndërkufitare dhe objekteve tregtare (përfshirë tregjet e prodhimeve të freskëta) Shoqatat e SME-ve, grupimet e tyre dhe organizatat anëtare të biznesit (p.sh. dhomat e tregtisë / artizanatit) Shoqatat e fermerëve

Treguesit e Performancës së Zbatimit të Prioritetit Tematik

Treguesi i Kontributitit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)*	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Nr. i aktiviteteve të tregtisë së jashtme	Aktivitete që synojnë tregun e jashtëm	0	5	10	Sistemi i monitorimit	Vjetor
Nr. i bizneseve që marrin pjesë në aktivitete të reja të tregtisë së jashtme	Nr. i bizneseve që përfitojnë nga aktivitetet e reja të tregtisë së jashtme	0	30	50	Sistemi i monitorimit	Vjetor
Nr. i SME-ve me certifikata të reja të konformitetit të fituara (ISO, HACCP, etj.)	SME-të që kanë çertifikata të reja të konformitetit	0	8	20	Sistemi i monitorimit	Vjetor
Nr. i tregjeve të reja dhe objekteve tregtare të zhvilluara nëpërmjet marrëveshjeve	Nr. i marrëveshjeve me tregje të reja dhe objekte tregtisë	0	1	3	Sistemi i monitorimit	Vjetor

* Grumbullues

Treguesi i rezultatit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Ndarja e vlerës së eksportit të mallrave dhe shërbimeve (%)	Raporti i eksporteve të mallrave dhe shërbimeve në lidhje me tregtinë e përgjithshme	PËR TU VENDOSUR*	Rritje me 2%	Rritje me 5%	Sistemi i monitorimit, Zyra Shtetërore e Statistikave, dhe INSTAT	Vjetor
Qarkullimi i bizneseve	Rritja e shitjeve totale të një shoqërie për një periudhë të caktuar	PËR TU VENDOSUR*	Rritje me 3%	Rritje me 8%	Sistemi i monitorimit, Zyra Shtetërore e Statistikave, dhe INSTAT	Vjetor

* Vlera bazë lidhet me performancën e përfituesve/grupeve të synuara para ndërhyrjes; Shifrat përkatëse për të matur vlerën bazë, duhet të sigurohen nga aplikanti në formularin e aplikimit për grante.

Treguesi i Ndikimit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2020)*	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Vlera bruto e shtuar nga sektori	Përqindje e rritur e vlerës së të mirave dhe shërbimeve të prodhuara në sektorin ekonomik brenda zonës gjeografike	PËR TU VENDOSUR*	Rritje me 2% në krahasim me vitin 2013	Zyra Shtetërore e Statistikave, dhe INSTAT	Vjetor

* Të dhënat do të llogariten pasi zyrat e statistikave të sigurojnë informacionin e nevojshëm.

Modalitetet e Zbatimit[7]

[7] Këto janë të natyrës parashikuese, bazuar në supozimin që deri në tre CFP do të organizohen gjatë gjithë

Të gjitha aktivitetet e prioritetit tematik 2 do të zbatohen nëpërmjet modaliteteve të skemës së granteve.

Ndihma e dhënë për bizneset individuale duhet të jetë në përputhje me ligjet e BE-së: i) ndihma shtetërore e dhënë nën GBER ose ii) tavani i ndihmës minimale dhe maksimale të jetë deri në 85%, për të siguruar bashkë-financimin minimal të kërkuar për IPA.

Vija ndarëse e kufirit midis aktiviteteve të realizuara në bazë të këtij prioriteti tematik dhe prioritetit tematik 1 është përcaktuar në bazë të pranueshmërisë së aplikantëve: SME-të dhe rrjetet e tyre që përfitojnë nga ndërhyrjet e prioritetit tematik 2 nuk duhet të bien nën seksionin I të NACE: Aktivitetet e akomodimit dhe shërbimeve ushqimore.

Janë parashikuar dy opsione për të ofruar ndërhyrjen në bazë të këtij prioriteti tematik, në varësi të karakteristikave përfundimtare të ofertës financiare:

1. Aktiviteti 2.1.1.1 mund të mbështetet në raundin e parë dhe të tretë të thirrjeve për projekt propozime, ndërsa Aktiviteti 2.1.1.2 gjatë raundit të dytë ose të tretë të thirrjeve për projekt propozime (për të shmangur përplasje në një thirrje për projekte me Aktivitetin 1.1.2.1 që pritet gjithashtu të konsumojnë pjesë të mëdha të financimit - këto projekte pritet të jenë të konsiderueshme në madhësi dhe me kohëzgjatje më të madhe se çdo iniciativë tjetër).
2. I gjithë prioriteti tematik mund të zbatohet nëpërmjet një thirrje për projekt propozime.

Prioriteti Tematik 3: Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut (TP2)

Përmbledhje e Prioritetit Tematik dhe Referenca Strategjike

Zona e programit karakterizohet nga një mjedis dhe natyrë e pasur dhe e larmishme, dhe në përgjithësi njihet si një territor i pastër dhe i gjelbër. Megjithatë, në rajon mungon infrastruktura për mbrojtjen e mjedisit, si dhe strategjitë dhe praktikat për njohjen në kohë, parandalimin dhe menaxhimin e rrezikut. Zona kufitare është e prirur drejt motit të pafavorshëm dhe dukurive klimatike, veçanërisht stuhive të rënda dhe reshjeve që rezultojnë në përmbytje lokale dhe rrëshqitje të tokës, duke dëmtuar rrugët, pronat private dhe tokën bujqësore. Në stinët e thata, zjarret rrezikojnë dhe dëmtojnë ekonominë rurale dhe prodhimin e të korrave. Kështu, rimëkëmbja prej katastrofave klimatike është një nga çështjet që duhet të trajtohen nëpërmjet këtij prioriteti tematik.

Përveç kësaj, përmirësimi i mbledhjes së mbetjeve të ngurta, menaxhimit të mbetjeve dhe praktikat e parandalimit të erozionit të tokës, konsiderohen si fusha prioritare të ndërhyrjes në rajonin CBC.

"Të jetosh mirë, brenda kufijve të planetit tonë" është titulli kryesor i Programit të ri të Veprimit për Mjedisin deri në vitin 2020, i propozuar nga Komisioni Evropian. Ky prioritet tematik i programit CBC bazohet në këtë nismë, dhe është në përputhje me politikat e Zonës B të IPA II: Zhvillimi Rajonal, sektori: Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike, dhe objektivat tematike 5 dhe 6 të ndërhyrjes së Fondeve Strukturore: Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, parandalim dhe menaxhimi i rrezikut & Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i efikasitetit të burimeve.

Aktivitetet e këtij prioriteti tematik përfshijnë të dy llojet e projekteve: "projektet e butë" me qëllim përmirësimin e ndërgjegjësimit dhe promovimin e përdorimit më të qëndrueshëm të burimeve, ekonomisë të gjelbër; si dhe mbështetjen e investimeve të vogla në infrastrukturën për mbrojtjen e mjedisit, e cila konsiderohet të ketë një ndikim të rëndësishëm në rajonin ndërkufitar dhe në prodhimin e efektit të demonstrimit. Gjithashtu, ndërhyrja synon të trajtojë kapacitetet e ulëta financiare dhe institucionale të shoqërive të shërbimeve publike, si dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme bujqësore dhe metodave të prodhimit bujqësor.

Objektivi Specifik

---

kohëzgjatjes së programit. Modaliteti mund të ndryshojë gjatë zbatimit të programit.

Kryetitulli i objektivit specifik të këtij prioriteti tematik (SO 3.1) mbetet **rritja e ndërgjegjësimit për një ekonomi më të gjelbër, mjedis më të pastër dhe ndryshimet klimatike.**

Qartësisht, prioriteti tematik ka një dimension hapësinor që kërkon një qasje të bazuar në vend, pasi territore të caktuara kufitare janë të veçantë nga të tjerët. Ky prioritet tematik do të përqendrohet në ndërtimin e ndërgjegjësimit dhe njohurive, integrimin e komuniteteve dhe grupeve të synuara, dhe në zbatimin e masave reale për të trajtuar çështjet e parashikuara në seksionin e mësipërm. **Fokus i veçantë do të drejtohet ndaj përpunimit të produkteve pyjore drusore dhe furnizimit me ujë**.

Rezultatet e pritshme

Ky prioritet tematik do të arrijë rezultatet e mëposhtme:

Ndërgjegjësimi dhe njohuritë mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit janë rritur;

Infrastruktura publike në rrezik nga përmbytjet, erozioni i dherave dhe zjarret është përmirësuar.

Aktivitetet e parashikuara dhe Grupet e Synuara

Aktivitetet e parashikuara dhe grupet e synuara janë grupuar në tabelën e mëposhtme.

Aktivitetet e parashikuara	Grupet e Synuara të Përfituesve
3.1.1.1 Promovimi dhe mbështetja e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit	Njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale Qendrat për zhvillim të rajoneve të planifikuara Shoqëritë e shërbimeve publike Parqet kombëtare OSHC-të, OJQ-të Dhomat e tregtisë Organizatat RDI Shoqatat e banorëve në zonat ndërkufitare, kryesisht në zonat rurale Shoqatat e fermerëve Institucionet e arsimit primar, dytësor dhe tretësor, dhe ato të hulumtimit Rrjetet e SME-ve
3.1.2.1 Promovimi i investimeve të vogla në infrastrukturë për rimëkëmbjen nga katastrofat dhe mbrojtjen e mjedisit	Njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale Qendrat për zhvillim të rajoneve të planifikuara Qendrat kombëtare dhe rajonale për menaxhimin dhe monitorimin e fatkeqësive Shoqëritë e shërbimeve publike Shoqatat e fermerëve OSHC-të, OJQ-të Dhomat e tregtisë Shoqatat e banorëve në zonat ndërkufitare, kryesisht në zonat rurale

Treguesit e Performancës së Zbatimit të Prioritetit Tematik

Rezultati 3.1.1 i Objektivit Specifik: Ndërgjegjësimi dhe njohuritë mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit janë rritur

Treguesi i Kontributitit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)*	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Nr. i fushatave ndërgjegjësuese mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve	Fushata të reja publike mbi çështjet e mjedisit në nivel projekti	0	5	12	Sistemi i monitorimit	Vjetor

dhe të mjedisit						
Nr. i sistemeve të menaxhimit të mbetjeve dhe zinxhirëve të vlerave të përmirësuar brenda zonës	Nr. i sistemeve të menaxhimit të mbetjeve dhe zinxhirëve të vlerave të modernizuar brenda zonës	0	3	6	Sistemi i monitorimit	Vjetor
Nr. i aksioneve të pastrimit	Nr. i nismave të pastrimit të zbatuara në nivel projekti	0	4	8	Sistemi i monitorimit	Vjetor

* Grumbulluese

Treguesi i Rezultatit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
% e popullsisë në zonën CBC e ndërgjegjësuar mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit në sektorët kyç	Norma e popullsisë së informuar mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe çështjet e mjedisit	PËR TU VENDOSUR*	1% (rreth 14,000)	3.5% (rreth 50,000)	Sistemi i monitorimit	Vjetor
% e të gjitha bizneseve dhe organizatave që marrin pjesë në veprimet e përbashkëta për menaxhimin e ujit dhe mbetjeve	Raporti ndërmjet atyre që marrin pjesë në veprimet e përbashkëta dhe të gjithë organeve ekzistuese në zonë	PËR TU VENDOSUR*	5%	10%	Sistemi i monitorimit	Vjetor

* Vlera bazë lidhet me performancën e përfituesve/grupeve të synuara para ndërhyrjes; Shifrat përkatëse për të matur vlerën bazë, duhet të sigurohen nga aplikanti në formularin e aplikimit për grante.

Treguesi i Ndikimit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Përdorimi i ujit nga familjet dhe bizneset	Përqindja e humbjeve të ujit e reduktuar	PËR TU VENDOSUR*	Rënie e përdorimit të ujit me 10%	Sistemi i monitorimit Zyra Shtetërore e Statistikave, dhe INSTAT	Vjetor
% e mbetjeve të grumbulluara për riciklim	Norma e mbetjeve të ricikluara në raport me sasinë e mbledhur	PËR TU VENDOSUR*	Rritja e mbetjeve të grumbulluara për riciklim me 15%	Sistemi i monitorimit	Vjetor
	Norma e numrit të vend-shkarkimeve të paligjshme të mbyllura në raport me numrin fillestar të vend-shkarkimeve ekzistuese	PËR TU VENDOSUR nga JTS me bashkitë, ministrinë e mjedisit	Ulja e numrit të vendshkarkimeve të paligjshme me 10%	Sistemi i monitorimit	Vjetor

* Vlera bazë lidhet me performancën e përfituesve/grupeve të synuara para ndërhyrjes; Shifrat përkatëse për të matur vlerën bazë, duhet të sigurohen nga aplikanti në formularin e aplikimit për grante.

Rezultati 3.1.2 i Objektivit Specifik: Infrastruktura publike në rrezik nga përmbytjet, erozioni i dherave dhe zjarret është përmirësuar

Treguesi i Kontributitit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)*	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Nr. i projekteve të mbështetur	Nr. total i projekteve të reja të mbështetur nën këtë objektiv	0	5	12	Sistemi i monitorimit	Vjetor
Nr. i objekteve të siguruara për mbrojtjen nga përmbytjet dhe zjarret	Nr. i objekteve të reja të siguruara për mbrojtjen nga përmbytjet dhe zjarri	0	0	2	Sistemi i monitorimit	Vjetor
Nr. i fushatave të ndërgjegjësimit	Nr. i fushatave të reja të ndërgjegjësimit	0	2	5	Sistemi i monitorimit	Vjetor
Numri i familjeve / fermave dhe organizatave të tjera që përfitojnë nga aktivitetet e reja	Numri i familjeve / fermave dhe organizatave të tjera që përfitojnë nga aktivitetet e reja	0	100	250	Sistemi i monitorimit	Vjetor

* Grumbulluese

Treguesi i Rezultatit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Gjatësia e rrugëve të mbrojtura	Nr. i km të rrugëve të ekspozuar ndaj fatkeqësive natyrore të mbrojtura në raport me nr. e km të rrugëve në nevojë për mbrojtje	0	3%	10% e rrugëve të ekspozuara ndaj rrezikut	Zyra Shtetërore e Statistikave, INSTAT, Sistemi i monitorimit	Vjetor
Madhësia e sipërfaqes bujqësore të mbrojtur	Norma e sipërfaqes së tokës bujqësore të mbrojtur në raport me sipërfaqen totale të tokës në nevojë për mbrojtje	0	2%	5% e tokës e ekspozuar ndaj rrezikut	Zyra Shtetërore e Statistikave, INSTAT, Sistemi i monitorimit	Vjetor
Madhësia e zonave pyjore të mbrojtura	Norma e sipërfaqes së zonës pyjore të mbrojtur në raport me sipërfaqen totale të zonës pyjore në nevojë për mbrojtje	0	2%	5% e pyjeve të ekspozuar ndaj rrezikut	Zyra Shtetërore e Statistikave, INSTAT, Sistemi i monitorimit	Vjetor

Treguesi i Ndikimit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Madhësia e zonës së Bashkëpunimit Ndërkufitar të mbuluar nga aktivitetet	Sipërfaqja e pranueshme e programit CBC është mbuluar nga aktivitetet e projektit	0	3%	Sistemi i monitorimit	Vjetor

Modalitetet e Zbatimit[8]

Aktivitetet do të zbatohen nëpërmjet financimit me grante, duke ndjekur modalitetet e PRAG për dhënien e granteve.

Zbatimi i prioritet tematik do të kërkojë përfshirjen aktive të grupeve të ndryshme të interesit në nivel lokal dhe rajonal. Pritet që me kalimin e kohës të ketë një ndikim më të ndjeshëm nga motivimi i autoriteteve lokale dhe shoqërive publike komunale në rajonin e Bashkëpunimit Ndërkufitar për të marrë një rol aktiv në zbatimin e programit: investimet e vogla në mjedis do të projektohen në kuadër të mandatit të tyre nëpërmjet procedurave transparente të prokurimit publik, dhe nuk do të kërkohet përgatitja e dokumentacionit të detajuar dhe të shtrenjtë të projektit të financuar nga fondet e programit.

Financimi i granteve mund të ofrohet në bazë të skenarëve të mëposhtëm alternativë:

1. Të dy aktivitetet mund të zbatohen paralelisht.

2. Aktiviteti 3.1.1.1 mund të zbatohet gjatë raundit të parë dhe të tretë të thirrjeve për projekt propozime, ndërsa aktiviteti 3.1.2.1 - në rrjedhën e raundit të dytë të thirrjeve për projekt propozime.

Asistenca Teknike

Objektivi specifik i asistencës teknike është të sigurojë zbatimin efektiv, efikas, transparent dhe në kohë të programit të bashkëpunimit ndërkufitar, si dhe të rrisë ndërgjegjësimin e komuniteteve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, dhe në popullsinë e zonës së programit në përgjithësi. Gjithashtu ai mbështet aktivitete ndërgjegjësimi në nivel kombëtar, me qëllim informimin e qytetarëve në të dy vendet përfitues të IPA II. Për më tepër, siç ka treguar përvoja në ciklin e programit 2007-2013, ky prioritet do të forcojë kapacitetin administrativ të autoriteteve dhe përfituesve që do të zbatojnë programin, me qëllim për të përmirësuar pronësinë dhe përshtatshmërinë e programit me rezultatet e projekteve.

Alokimi për asistencën teknike do të përdoret për të mbështetur punën e Strukturave Kombëtare Operative (OS) dhe të Komitetit të Përbashkët të Monitorimit (JMC), në sigurimin e fillimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit efikas të programeve, si dhe për një përdorim optimal të burimeve. Kjo do të arrihet nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të një Sekretariati të Përbashkët Teknik (JTS) me bazë në territorin e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe një Zyrë Antena në Republikën e Shqipërisë. JTS do të jetë në krye të menaxhimit të përditshëm të programit dhe do ti raportojë mbi ecurinë e tij OS-ve dhe JMC-së.

Rezultatet e synuar:

Mbështetja administrative për Strukturat Operative (OS) dhe Komitetin e Përbashkët të Monitorimit (JMC) të programit është rritur.

Ky prioritet do të sigurojë një zbatim normal të programit gjatë të gjitha fazave të tij. Ai përfshin disponueshmërinë e mjeteve financiare dhe vendosjen e personelit të kualifikuar përgjegjës për të ndihmuar Strukturat Operative dhe Komitetin e Përbashkët të Monitorimit, si dhe krijimin dhe zbatimin e mekanizmave dhe procedurave të menaxhimit, monitorimit dhe kontrollit. Nëse kërkohet, ai gjithashtu do të kontribuojë në përgatitjen e ciklit pasardhës financiar (2021-2027).

Treguesit e rezultatit:

Treguesi	Njësia	Baza	Synimi deri në 2022	Burimi
Përqindja mesatare e përfituesve të kënaqur me mbështetjen nga programi i zbatuar[9]	Përqindje	0	60 %	Anketë

[8] Këto janë të natyrës parashikuese, bazuar në supozimin që deri në tre CFP do të organizohen gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit. Modaliteti mund të ndryshojë gjatë zbatimit të programit.

[9] Kërkon një studim të rregullt dhe të thjeshtë duke përdorur një pyetësor standard me pyetje të mbyllura.

Kapaciteti teknik dhe administrativ për menaxhimin dhe zbatimin e programit është rritur.

Ky prioritet do të ofrojë mundësi për përmirësimin e kompetencave dhe aftësive të strukturave menaxhuese të programeve, si dhe të aplikuesve të mundshëm dhe përfituesve të granteve. Aktivitete specifike për ngritjen e kapaciteteve do të planifikohen dhe zbatohen në bazë të nevojave të identifikuara gjatë zbatimit të programit. Si pjesë e mësimeve të nxjerra nga cikli i programit 2007-2013, (i) do të pritet një pjesëmarrje në rritje e anëtarëve të KPM në detyrat e përcaktuara nën kuadrin ligjor të IPA II; (ii) kapaciteti i aplikuesve të mundshëm për zhvillimin e partneriteteve të qëndrueshme ndërkufitare do të rritet; dhe (iii) kapaciteti i përfituesve të granteve për të përmbushur detyrimet e kontratave të tyre në mënyrë të kënaqshme, të do të përforcohet.

Treguesit e rezultatit:

Treguesi	Njësia	Baza	Synimi deri në 2022	Burimi
Rritja mesatare e numrit të propozimeve të marra në kuadër të çdo thirrje të njëpasnjëshme[10]	Përqindje	123 *	+ 45%	AIR
Rritja mesatare e numrit të koncept ideve që do të kualifikohen për vlerësim të mëtejshëm	Përqindje	59	10 %	AIR

Vizibiliteti i programit dhe i rezultateve të tij, garantohet.

Programet CBC kanë qenë shumë të famshëm në zonat përfituese, përveç të tjerave, falë veprimeve të vizibilitetit të ndërmarra gjatë ciklit të programit 2007-2013. Duke parë numrin e aplikuesve në thirrjet pasuese, është vënë re se ka një interes në rritje për iniciativat e bashkëpunimit. Këto arritje duhet të ruhen dhe të përmirësohen edhe gjatë zbatimit të perspektivës financiare 2014-2020. Një shumëllojshmëri e kanaleve të komunikimit dhe mjeteve të publicitetit duhet të zhvillohet për të siguruar informacion të rregullt midis palëve të interesuara të programit dhe një audience më të gjerë.

Treguesit e rezultatit:

Treguesi	Njësia	Baza	Synimi deri në 2022	Burimi
Rritja e numrit të personave që marrin pjesë në aktivitetet promovuese	Numër	1398*	2000	AIR
Vizitat në faqen e internetit të programit	Numër	40*	700	AIR

* AIR 2013

Lloji i aktiviteteve:

Një listë jo shteruese e aktiviteteve të mundshme të mbuluara nga alokimi i asistencës teknike do të përfshijë:

Ngritja dhe funksionimi i Sekretariatit të Përbashkët Teknik dhe Antena-s së tij.

---

[10] Ju lutemi të vini re se në perspektivën financiare 2014-2020, thirrjet e mundshme të përshtatura/ strategjike për propozime janë parashikuar me fokus të qartë dhe / ose kërkesa të caktuara në lidhje me përfituesit e mundshëm. Gjithashtu, Thirrjet për Projekt Propozime mund të përdorin parimin e rotacionit për përzgjedhjen e prioriteteve tematike (TP) dhe objektivave të tyre specifike, dhe në këtë aspekt numri i propozimeve jo domosdoshmërisht mund të rritet. Për këto arsye, rritja e pritshme e numrit të aplikimeve të marra mund të llogaritet për çdo thirrje të njëpasnjëshme në mënyrë individuale, dhe do të ndikohet nga një faktor që mund të llogaritet në bazë të: 1) Buxheti i përgjithshëm në dispozicion, 2) Prioritetet tematike, objektivat specifike dhe rezultatet e përfshira në Thirrjen për Projekt Propozime, 3) Shumat minimale dhe maksimale të lejuara të granteve, 4) Numri i aplikimeve dhe granteve të lejuara për aplikues / bashkë-aplikues / entet e lidhur dhe 5) Çdo dispozitë tjetër e veçantë që ndikon në kritere të ndryshme të pranueshmërisë, të zbatueshme për një thirrje specifike për projekt propozime.

Organizimi i aktiviteteve, takimeve, trajnimeve, vizitave studimore apo vizitave të shkëmbimit, për të mësuar nga praktikat më të mira të nismave të tjera të zhvillimit territorial.

Pjesëmarrja e stafit të strukturave të menaxhimit në forumet e Ballkanit Perëndimor apo të BE-së.

Përgatitja e manualeve / doracakëve të brendshëm dhe / ose të jashtëm.

Asistencë për aplikuesit e mundshëm në partneritet dhe për zhvillimin e projektit (forume për kërkimin e partnerëve, etj.).

Këshilla për përfituesit e granteve mbi çështje lidhur me zbatimin e projektit.

Monitorimi i zbatimit të projektit dhe programit, duke përfshirë krijimin e një sistemi të monitorimit dhe raportimit përkatës.

Organizimi i aktiviteteve të vlerësimit, analizave, sondazheve dhe / ose studimeve.

Informim dhe publicitet, duke përfshirë përgatitjen, miratimin dhe rishikimin e rregullt të një plani vizibiliteti dhe komunikimi, shpërndarjen e informacionit (ditë informimi, mësimet e nxjerra, studimet e rasteve më të mira, artikuj dhe deklarata për shtyp), ngjarje promovuese dhe artikuj të shtypur, zhvillimi i mjeteve të komunikimit, mirëmbajtja, përditësimi dhe përmirësimi i faqes së internetit të programit, etj.

Mbështetje për punën e Task Forcës së Përbashkët të ngarkuar me përgatitjen e ciklit të programit 2021-2026.

Grupet e synuara dhe përfituesit përfundimtarë (listë jo shteruese)

-Strukturat e menaxhimit të programit
-Aplikuesit e mundshëm
-Përfituesit e granteve
-Përfituesit përfundimtarë të projektit
-Publiku i gjerë

Modalitetet e zbatimit

Plani i vizibilitetit dhe komunikimit duhet të prodhohet në përputhje me kërkesat e përgjithshme të IPA II dhe praktikat më të mira mbi transparencën dhe trajtimin e barabartë.

Përfituesit duhet të informohen në mënyrë korrekte dhe të plotë mbi rregulloret për publicitetin. Kujdes i veçantë i kushtohet rregullave të vizibilitetit edhe gjatë monitorimit të zbatimit të projektit.

Organet e përfshira në zbatimin e programit janë përgjegjëse për të siguruar që përfituesit përfundimtarë të marrin masat për informimin dhe publicitetin mbi aktivitetet e bashkë-financuara në kuadër të IPA II, në përputhje me udhëzimet e BE-së mbi vizibilitetin.

Tabela 2: Përmbledhje e strategjisë së programit

Prioriteti Tematik (TP)	Objektivat Specifikë	Rezultatet	Treguesit	Llojet e aktiviteteve (shembuj)

Prioriteti Tematik 1: Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore. (TP4)	Objektivi Specifik i këtij Prioriteti Tematik synon të zhvillojë potencialin e turizmit duke promovuar trashëgiminë dhe vlerat kulturore	1.1.1 Mundësitë e biznesit për ofruesit lokalë të shërbimeve dhe operatorët në fushën e turizmit janë rritur; 1.1.2 Bashkëpunimi i ndërsjellë, mirëkuptimi dhe respekti për trashëgiminë dhe vlerat kulturore janë zhvilluar më tej.	1.1.1 Nr. i turistëve që përdorin shërbimet e reja/ përmirësuar. Nr. i shërbimeve/ produkteve të reja/përmirësuara. Nr. i personave të trajnuar. Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit të turistëve (me fjetje). 1.1.2 Nr. i vizitorëve në vendet e trashëgimisë kulturore. Nr. i vendeve të trashëgimisë kulturore të përmirësuar. Nr. i aktiviteteve të organizuara. Nr. i librarive të reja të dixhitalizuara. % e palëve të interesuara të përfshirë në aktivitete.	1.1.1.1 Projektimi, zhvillimi dhe promovimi i produkteve dhe shërbimeve të përbashkëta turistike dhe i investimeve në shkallë të vogël në infrastrukturën publike të turizmit. 1.1.1.2 Trajnim për rritjen e aftësive në industrinë e mikpritjes. 1.1.2.1 Restaurimi / rezervimi, ruajtja, pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore dhe historike, dhe e mjedisit të lidhur me këto objekte. 1.1.2.2 Mbështetje për aktivitete të përbashkëta kulturore.
Prioriteti Tematik 2: Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve. (TP7)	Forcimi i kapaciteteve prodhuese të SME-ve dhe aksesit të tyre në tregje.	2.1.1 Ndërgjegjësimi dhe kapaciteti i SME-ve dhe bizneseve të reja për të hyrë në tregjet e reja dhe zinxhirët e vlerave janë rritur.	Vlera e eksportit të mallrave dhe shërbimeve (%). Qarkullimi i bizneseve GVA. Nr. i aktiviteteve të tregtisë së jashtme. Nr. i bizneseve që marrin pjesë në aktivitete të reja të tregtisë së jashtme. Nr. i SME-ve me certifikata të reja të konformitetit të fituara (ISO, HACCP, etj.). Nr. i tregjeve të reja dhe objekteve tregtare të zhvilluara nëpërmjet marrëveshjeve.	2.1.1.1 Asistencë për SME-të dhe bizneset e reja për ndërkombëtarizim dhe gjetjen e partnerëve të biznesit. 2.1.1.2 Investime në tregun e vogël ndërkufitar dhe në objekte tregtare.
Prioriteti Tematik 3: Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut. (TP2)	Rritja e ndërgjegjësimit për një ekonomi më të gjelbër, mjedis më të pastër dhe ndryshimet klimatike.	3.1.1 Ndërgjegjësimi dhe njohuritë mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit janë rritur; 3.1.2 Infrastruktura publike në rrezik nga përmbytjet, erozioni i dherave dhe zjarret është përmirësuar.	3.1.1 Përdorimi i ujit nga familjet dhe bizneset. % e mbetjeve të grumbulluara për riciklim. Nr. i fushatave ndërgjegjësuese mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe të mjedisit. Nr. i sistemeve të menaxhimit të mbetjeve dhe zinxhirëve të vlerave të përmirësuar brenda zonës. Nr. i aksioneve të pastrimit. % e popullsisë në zonën CBC e ndërgjegjësuar mbi përdorimin e	3.1.1.1 Promovimi dhe mbështetja e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit. 3.1.2.1 Promovimi i investimeve të vogla në infrastrukturë për rimëkëmbjen nga katastrofat dhe mbrojtjen e mjedisit.

			qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit në sektorët kyç. % e të gjitha bizneseve dhe organizatave që marrin pjesë në veprimet e përbashkëta për menaxhimin e ujit dhe mbetjeve. 3.1.2 Gjatësia e rrugëve të mbrojtura. Madhësia e sipërfaqes bujqësore të mbrojtur. Madhësia e zonave pyjore të mbrojtura. Nr. i projekteve të mbështetur. Nr. i objekteve të siguruara për mbrojtjen nga përmbytjet dhe zjarret. Nr. i fushatave të ndërgjegjësimit. Numri i familjeve / fermave dhe organizatave të tjera që përfitojnë nga aktivitetet e reja. Madhësia e zonës së Bashkëpunimit Ndërkufitar të mbuluar nga aktivitetet.	
Asistenca Teknike	Të sigurojë zbatimin efektiv, efikas, transparent dhe në kohë të programit të bashkëpunimit ndërkufitar, si dhe të rrisë ndërgjegjësimin e komuniteteve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, dhe në popullsinë e zonës së programit në përgjithësi. Gjithashtu ai mbështet aktivitete ndërgjegjësimi në nivel kombëtar, me qëllim informimin e qytetarëve në të dy vendet përfitues të IPA II. Ky prioritet do të forcojë kapacitetin administrativ të	Mbështetja administrative për Strukturat Operative dhe Komitetin e Përbashkët të Monitorimit të programit është rritur. Kapaciteti teknik dhe administrativ për menaxhimin dhe zbatimin e programit është rritur. Vizibiliteti i programit dhe i rezultateve të tij, garantohet.	Përqindja mesatare e përfituesve të kënaqur me mbështetjen nga programi i zbatuar. Rritja mesatare e numrit të propozimeve të marra në kuadër të çdo thirrje të njëpasnjëshme. Rritja mesatare e numrit të koncept ideve që do të kualifikohen për vlerësim të mëtejshëm. Rritja e numrit të personave që marrin pjesë në aktivitetet promovuese. Vizitat në faqen e internetit të programit.	Ngritja dhe funksionimi i Sekretariatit të Përbashkët Teknik dhe Antena-s së tij. Organizimi i aktiviteteve, takimeve, trajnimeve, vizitave studimore apo vizitave të shkëmbimit, për të mësuar nga praktikat më të mira të nismave të tjera të zhvillimit territorial. Pjesëmarrja e stafit të strukturave të menaxhimit në forumet e Ballkanit Perëndimor apo të BE-së. Përgatitja e manualeve / doracakëve të brendshëm dhe / ose të jashtëm. Asistencë për aplikuesit e mundshëm në partneritet dhe për zhvillimin e projektit (forume për kërkimin e partnerëve, etj.). Këshilla për përfituesit e granteve mbi çështje lidhur

	autoriteteve dhe përfituesve që do të zbatojnë programin, me qëllim për të përmirësuar pronësinë dhe përshtatshmërinë e programit me rezultatet e projekteve.			me zbatimin e projektit. Monitorimi i zbatimit të projektit dhe programit, duke përfshirë krijimin e një sistemi të monitorimit dhe raportimit përkatës. Organizimi i aktiviteteve të vlerësimit, analizave, sondazheve dhe / ose studimeve. Informim dhe publicitet, duke përfshirë përgatitjen, miratimin dhe rishikimin e rregullt të një plani vizibiliteti dhe komunikimi, shpërndarjen e informacionit (ditë informimi, mësimet e nxjerra, studimet e rasteve më të mira, artikuj dhe deklarata për shtyp), ngjarje promovuese dhe artikuj të shtypur, zhvillimi i mjeteve të komunikimit, mirëmbajtja, përditësimi dhe përmirësimi i faqes së internetit të programit, etj. Mbështetje për punën e Task Forcës së Përbashkët të ngarkuar me përgatitjen e ciklit të programit 2021-2026. Tjetër.

3.3 Çështjet horizontale dhe të ndërthurura

Çështjet horizontale dhe ndërsektoriale kanë të bëjnë me temat e ndërlidhura me modalitetet e zbatimit të prioriteteve tematike të përzgjedhura dhe me politikat e komunitetit të karakterit horizontal.

Programi pranon aksionet **njerëz-për-njerëz** dhe **rrjetet institucionale / të bashkëpunimit për LPP** si modalitete që do të zbatohen në të gjitha prioritetet e zgjedhura tematike.

Përveç kësaj, legjislacioni i BE-së kërkon që çështjet specifike horizontale dhe ndërsektoriale që janë pjesë e politikave të komunitetit, të trajtohen në mënyrën e duhur në të gjitha programet e financuara nga BE. Në këtë kontekst, strategjia ka të bëjë me prioritetet e Evropës 2020 në harmoni me rrethanat rajonale, duke trajtuar një vizion të ekonomisë sociale të tregut në Evropë, duke sjellë kështu nivele të rritura të punësimit, produktivitetit dhe kohezionit social. Kjo strategji është e bazuar në tri prioritetet e përbashkët përforcues: **Rritje e mençur, e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse** për të gjithë. Në këtë kontekst, **qëndrueshmëria sociale** është çështja që integrohet në këtë program të bashkëpunimit ndërkufitar, e cila synon të parandalojë çdo diskriminim në bazë të gjinisë, prejardhjes raciale apo etnike, fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual. Ndërsa **qëndrueshmëria e mjedisit** do të kërkojë kryesisht pajtueshmërinë me Direktivën e Habitateve 92 /43/KE, Direktivën për Zogjtë 79/409 / KE dhe direktivat në lidhje me rrjetin evropian të zonave të mbrojtura NATURA 2000. Në krye të kësaj,

çështjet mjedisore do marrin në konsideratë drejtpërdrejt aspekte që, ndër të tjera, lidhen me menaxhimin e mbetjeve, efikasitetin e energjisë dhe aftësinë ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike si pjesë e Prioritetit 3.

Çështjet horizontale dhe ndërsektoriale do të trajtohen në mënyrë të dyfishtë:

1. Nëpërmjet operacioneve dhe aktiviteteve të drejtpërdrejta, duke nxitur dhe mbështetur rritjen gjithëpërfshirëse dhe qëndrueshmërinë sociale dhe mjedisore;

2. Nga përfshirja e tyre si çështje të ndërlidhura që kanë ndikim të tërthortë dhe integrohen në operacionet dhe aktivitetet brenda çdo prioriteti tematik.

Rrjedhimisht, Strukturat Operative janë të nevojshme për të futur dispozita të veçanta në dokumentet që shtrojnë bazat për aktivitetet dhe operacionet, p.sh. skemat e granteve, termat e referencës etj., në mënyrë që të sigurohet që:

-Aktivitetet dhe operacionet të mos vendosin pengesa të lidhura me gjininë, pikëpamjet, orientimin seksual, racor apo origjinën etnike, veçanërisht në lidhje me punësimin dhe politikat e HR të ndjekura ndaj personave të cilët do të jenë të punësuar në kuadër të projekteve të zbatuara nën skemat e granteve ose përmes ndërhyrjeve të asistencës teknike;

-Përshtatshmëria për personat me aftësi të kufizuara të jetë një nga kriteret që duhet të respektohet për zhvillimin e infrastrukturës;

-Përfituesit e granteve të bashkëpunimit ndërkufitar të sigurojnë që përfituesit përfundimtarë të kenë mundësi të barabarta aksesi në të gjitha shërbimet, trajnimet, asetet ose pajisjet fikse ose jo-materiale të blera nëpërmjet aktiviteteve dhe operacioneve;

-Aktivitetet dhe operacionet gjithashtu duhet të hartohen në përputhje me parimet e një mjedisi të qëndrueshëm dhe promovimit të mbrojtjes së mjedisit, dhe të prodhojnë ndikim pozitiv ose të paktën neutral në mjedis. Që aktivitetet dhe operacionet të kenë ndikim pozitiv, duhet të hartohen me qëllim që, ose të marrin në konsideratë të paktën një nga pikat e mëposhtme:

-Përmirësimin e zinxhirit të menaxhimit të mbetjeve (për mbetjet e ngurta dhe/ose të lëngshme);

-Zvogëlimin e vëllimit të mbetjeve tashmë të krijuara, në fazën e planifikimit dhe projektimit të projektit individual;

-Përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore,

-Elasticitetin klimatik;

-Proceset pjesëmarrëse të planifikimit dhe konsultimit publik për proceset e planifikimit të zhvillimit hapësinor dhe të investimeve.

-Projektet të kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në krijimin e vendeve të punës (duke përfshirë dialogun social), nxitjen e punësimit dhe forcimin e kushteve të punës, si dhe të promovojnë sigurimin e barazisë.

Temat horizontale dhe të ndërlidhura të këtij programi të bashkëpunimit ndërkufitar duhet të harmonizohen edhe nëpërmjet prioritetit të Asistencës Teknike që synon forcimin e efikasitetit dhe efektivitetit të ndërhyrjeve të bashkë-financimit nga fondet e IPA II me cilësi të lartë dhe menaxhim të shëndoshë në nivel kombëtar, dhe me mbështetje gjithëpërfshirëse në nivel lokal.

Projektet e përgatitura në kuadër të qasjes së Zhvillimit të Bazuar në Zonë (ABD) për të lehtësuar rritjen e qëndrueshme në zonat gjeografike të përcaktuara në rajonet ndërkufitare të Ballkanit Perëndimor, në zona të veçanta rurale që karakterizohen nga probleme të veçanta komplekse zhvillimore, mund të konsiderohen për financim në kuadër të këtij programi të bashkëpunimit ndërkufitar. Puna përgatitore për qasjen ABD tashmë të zbatuar në rajonin ndërkufitar që mbulon ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë, do të merret në konsideratë.

Seksioni 4
Plani Financiar

Tabela 1 tregon sasinë vjetore të parashikuar të kontributit të Bashkimit Evropian për programin e bashkëpunimit ndërkufitar për periudhën 2014-2020. Tabela 2 ofron një shpërndarje të parashikuar për alokimet për secilin prioritet tematik si dhe një parashikim mbi shumën maksimale të bashkë-financimit të Bashkimit Evropian.

Tabela 1: Alokimet e parashikuara financiare në vit për programin e bashkëpunimit ndërkufitar 2014-2020

Viti	Programi IPA II CBC Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë – Republika e Shqipërisë							Totali (EUR)
	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2014-2020
Operacionet CBC (të gjitha prioritetet tematike)	1 190 000	1 700 000	1 700 000	1 190 000	1 700 000	1 700 000	1 530 000	10 710 000
Asistenca Teknike	510 000	0.00	0.00	510 000	0.00	0.00	170 000	1 190 000
Totali (EURO)	1 700 000	1 700 000	1 700 000	1 700 000	1 700 000	1 700 000	1 700 000	11 900 000

Tabela 2: Alokimet e parashikuara financiare për prioritet gjatë periudhës 2014-2020 dhe shkalla e kontributit të BE-së

PRIORITETET	Programi IPA II CBC Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë – Republika e Shqipërisë 2014-2020			
	Kontributi i BE-së	Bashkë-financimi i përfituesve	Financimi total	Shkalla e kontributit të BE-së
	(a)	(b)	(c) = (a)+(b)	(d) = (a)/(c)
Prioriteti Tematik 1: Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore	3 750 000.00	661 764.71	4 411 764.71	85%
Prioriteti Tematik 2: Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve	3 750 000.00	661 764.71	4 411 764.71	85%
Prioriteti Tematik 3: Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut	3 210 000.00	566 470.58	3 776 470.58	85%
Asistenca Teknike	1 190 000.00	0.00	1 190 000.00	100%
GRANTI TOTAL	11 900 000.00	1 890 000.00	13 790 000.00	

Kontributi i BE-së është llogaritur në raport me shpenzimet e pranueshme, të cilat bazohen në totalin e shpenzimeve të pranueshme, duke përfshirë shpenzimet publike dhe private. Shkalla e bashkë-financimit të BE në nivel të çdo prioriteti tematik nuk duhet të jetë më pak se 20% dhe jo më e lartë se 85% e shpenzimeve të pranueshme.

Bashkë-financimi i prioriteteve tematike do të sigurohet nga përfituesit e granteve. Përfituesit e grantit duhet të kontribuojnë me një minimum prej 15% të totalit të shpenzimeve të pranueshme.

Shuma e dedikuar për asistencën teknike do të kufizohet në 10% të shumës totale të caktuar për programin. Shkalla e bashkë-financimit të BE-së do të jetë 100%.

Fondet për prioritetet tematike do të jepen nëpërmjet Vendimeve të Komisionit Zbatues, duke mbuluar alokime një deri në tre vjeçare, sipas nevojës. Fondet për asistencën teknike do të jepen nëpërmjet një Vendimi të veçantë të Komisionit Zbatues.

Seksioni 5
Dispozitat Zbatuese

Në kuadër të këtij programi nuk janë parashikuar thirrje për projekte strategjike.

Ashtu siç është parashikuar nën prioritetin e Asistencës Teknike, aplikuesit kanë të drejtë të kenë mbështetje gjatë hartimit dhe zhvillimit të projektit.

Duke pasur parasysh që baza duhet të identifikohet përpara ndërhyrjes së programit, të gjithë aplikuesit duhet të ofrojnë informacionin e kërkuar për të llogaritur vlerën e treguesve bazë. Informacioni duhet të sigurohet për aplikuesin kryesor, të gjithë partnerët dhe bashkëpunëtorët.

Për shkak të burimeve të kufizuara financiare, nuk ka asnjë dispozitë për të synuar nën-tema ose aktivitete specifike për thirrje për propozime.

Modalitetet e propozuara të zbatimit janë të detajuara në përshkrimin e çdo prioriteti, të **bazuar në supozimin se gjatë periudhës së zbatimit të programit do të kryhen tre raunde të thirrjeve për projekt propozime** dhe në faktin që nuk është parashikuar asnjë projekt strategjik për zbatim. Tabela e mëposhtme përmbledh këto modalitete bazuar në dy skenarë të hartuar nën paragrafin e modaliteteve të zbatimit të seksionit 3.2. Megjithatë, këta skenarë kanë një natyrë supozuese dhe mund të ndryshojnë në bazë të mundësive të tjera që mund të shqyrtohen gjatë zbatimit të programit dhe me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe rezultateve të prokurimit.

Skenari 1

Ky skenar parashikon organizimin e tre raundeve të thirrjeve për propozime me ndarje të barabartë financiare për çdo prioritet tematik, me afërsisht 1/3 e buxhetit total të programit për prioritet. Të gjitha thirrjet do të synojë secilin prioritet dhe aktivitete të zgjedhura.

Të gjitha grupet e synuara do të kenë akses të barabartë në financimin e ofruar nga programi.

Raundi i Thirrjeve për projekt-propozime	Aktivitetet
I pari	1.1.1.2 1.1.2.2 2.1.1.1 3.1.1.1
I dyti	1.1.1.1 1.1.2.1 2.1.1.2 3.1.2.1
I treti	1.1.1.1 1.1.2.1 1.1.1.2 1.1.2.2 2.1.1.1 2.1.1.2 3.1.1.1

Skenari 2

Sipas këtij skenari çdo thirrje për projekt propozime do të synojë një prioritet të vetëm, përveç raundit të parë ku Aktiviteti 1.1.2.2 është përjashtuar. Ky aktivitet do të përfshihet në raundin e dytë dhe të tretë të thirrjeve për projekt propozime, në mënyrë të përsëritur.

Raundi i Thirrjeve për projekt-propozime	Aktivitetet

I pari	Prioriteti 1, përveç aktivitetit 1.1.2.2 që mund të qarkullojë gjatë gjithë periudhës së zbatimit
I dyti	Prioriteti 2 me aktivitetin 1.1.2.2
I treti	Prioriteti 3 me aktivitetin 1.1.2.2

Të gjithë projektet dhe aksionet do të përzgjidhen për mbështetje duke pasur parasysh çështjet horizontale dhe ndërsektoriale të parashikuara në pikën 3.3.

Projektet duhet të projektohen dhe paketohen në përputhje me parimin e partnerit kryesor.

LISTA E SHTOJCAVE

SHTOJCA 1
Analiza e Situatës dhe Analiza SWOT
Analiza e Situatës së Zonës së Programit

Rajoni kufitar midis Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë karakterizohet nga gjuhë të ndryshme të folura dhe larmi etnike, por kulturë, histori dhe vlera tradicionale të ngjashme. Karakteristikat e mëposhtme kryesore hapësinore dhe klimatike dominojnë zonën e programit:

Vargu Jugor i Alpeve Dinarike (Dinariket) me pyje dhe kullota të bollshme, natyrë të pasur dhe mjedis të kombinuar me fusha dhe ultësira, pengon aksesin në të gjithë rajonin: diferenca ndërmjet majës më të lartë (Golem Korabi 2.753 m mbi nivelin e detit) dhe zonave fushore të Pellagonisë (130 m mbi nivelin e detit) është më shumë se 2.600 m.

Liqeni i Ohrit, i Prespës dhe Liqeni artificial i Dibrës, së bashku me Parqet Kombëtare Galiçica dhe Shebenik-Jabllanicë dhe fushat, kanionet dhe livadhet e tyre, sigurojnë kushte të favorshme për faunën dhe florën dhe mundësitë e zhvillimit të turizmit. Pyjet mbulojnë rreth 44% të zonës së programit të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe 37% të zonës së programit të Republikës së Shqipërisë. Liqeni i Ohrit është deklaruar nga UNESCO si vend kulturor dhe natyror i trashëgimisë botërore dhe Liqeni i Prespës është një zonë Ramsar me rëndësi ndërkombëtare;

Dy korridoret kryesore të transportit mbarë-evropian nxjerrin në pah vendndodhjen e rëndësishme gjeostrategjike të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë në Evropën Juglindore. **Korridori VIII** (Durrës-Shkup-Sofje-Varna) dhe **Dega D e Korridorit X** (Igumenicë-Manastir-Prilep-Veles) ndikojnë fuqishëm në dinamikën e zonës së programit, ekonominë, njerëzit dhe mjedisin e saj.[11]

[11]Korridoret e përcaktuara sipas konkluzioneve të Konferencës së Kretës (1994) dhe Konferencës së Helsinkit (1997) mbi korridoret multimodal Pan-Evropian dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit të nënshkruar nga vendet e Ballkanit Perëndimor (2004)



Zona kufitare është e pasur me minerale, p.sh. krom, qymyr, hekur-nikel, bakër, gëlqere, kuarc, rërë dhe mermer;

Rajoni ndërkufitar karakterizohet nga kushte të ndryshme klimatike: nga trans –kontinentale në veri, në trans - mesdhetare në jug dhe në pjesët qendrore. Megjithatë, në zonat më malore të këtyre rajoneve dimri është i ftohtë dhe i lagësht, ndërsa vera është e nxehtë dhe e thatë. Temperaturat në zonat malore përgjatë kufirit variojnë prej -16 deri në +36 gradë (minimumi dhe maksimumi). Mesatarja vjetore e reshjeve në anën e Republikës së Shqipërisë (+1.400 mm) është më e lartë se sa në anën e kufirit të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë (600 mm).[12]

Aspektet Politike

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka qenë identifikuar si një kandidat potencial për anëtarësim në BE që në vitin 2003. Vendi ka aplikuar për anëtarësim në BE në mars të vitit 2004 dhe i është dhënë statusi i kandidatit në vitin 2005.

Në mënyrë të ngjashme me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Republika e Shqipërisë u identifikua si një kandidat potencial për anëtarësim në BE në vitin 2003. Në vitin 2009 Republika e Shqipërisë paraqiti kërkesën zyrtare të saj për anëtarësimin në BE. Në vitin 2010, Komisioni vlerësoi se përpara se negociatat e pranimit të mund të hapen formalisht, Republika e Shqipërisë duhet të punonte akoma për të arritur një shkallë të nevojshme të përputhshmërisë me kriteret e anëtarësimit dhe në veçanti për të përmbushur 12 prioritetet kyçe të identifikuara nga Opinioni. Më vonë në vitin 2012, Komisioni rekomandoi që Republikës së Shqipërisë t'i jepet statusi i kandidatit të BE-së, duke i lënë si detyrë plotësimin e masave kyçe në fushat e reformës gjyqësore dhe të administratës publike, si dhe rishikimin e rregullave të procedurave parlamentare.

Për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë kuadri udhëzues i referencës politike është informuar nga Plani Kombëtar për Miratimin e *Acquis*, i cili informon politikat kombëtare dhe veprimet e qeverisë. Objektivat kryesore strategjike të Programit të Punës së Qeverisë së ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë që kanë të bëjnë me periudhën 2011-2015 përfshijnë:

1. Përshpejtimi i rritjes ekonomike, punësimit dhe standardit të jetesës së qytetarëve, duke përfshirë cilësinë e jetesës;

2. Integrimi i ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë në BE dhe NATO;

3. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit dhe zbatimi efikas i ligjit duke ndërmarrë reforma të thella në gjyqësor dhe në administratën publike;

---

[12] Burimi: Banka Botërore

4. Mirëmbajtja e marrëdhënieve të mira ndër-etnike bazuar në parimet e tolerancës dhe respektit reciprok dhe zbatimi i Marrëveshjes Kuadër të Ohrit; dhe

5. Mbështetja e investimeve në arsim, shkencë dhe teknologji informacioni, si elementë kryesorë të një shoqërie të bazuar në dije.

Strategjia për Zhvillimin Rajonal 2009-2019 e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë identifikon bashkëpunim ndër-komunal dhe ndërkufitar, si një nga shtyllat dhe objektivat kryesore të zhvillimit të balancuar social-ekonomik rajonal. Rajonet kufitare, së bashku me zonat rurale dhe malore janë përcaktuar si zona me nevoja të veçanta zhvillimi, duke u bërë kështu një prioritet për ndërhyrje social-ekonomike.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim e Republikës së Shqipërisë 2014-2020 (NSDI) konsiderohet si kuadri i politikave gjithëpërfshirëse për vendin në kontekstin e integrimit në BE. Ajo përcakton katër shtyllat e politikës strategjike që përcaktojnë themelet për ndërhyrjet sektoriale dhe të bazuara në vend:

1. Forcimi i demokracisë dhe shtetit të së drejtës që trajton aspekte si: sistemi zgjedhor, drejtësia dhe punët e brendshme, të drejtat e njeriut dhe media, qeverisja efektive dhe politikat e jashtme dhe të mbrojtjes;

2. Krijimi i kushteve për zhvillim ekonomik konkurrues dhe të qëndrueshëm nëpërmjet përdorimit efikas të burimeve që mbulojnë: stabilitetin dhe qëndrueshmërinë makroekonomike, ekonominë konkurruese të tregut, përdorimin efikas të burimeve, zhvillimin e integruar rajonal dhe zhvillimin e qëndrueshëm;

3. Nxitja e përfshirjes sociale, mirëqenies dhe zhvillimit të tregut të punës, të cilat synojnë të promovojnë: politikat e punësimit dhe përfshirjes sociale, politikat sociale;

4. Zhvillimi i një shoqërie të bazuar në dituri, inovacion dhe teknologji dixhitale, që përfshin ndërhyrjet në fushat në vijim: arsimin e lartë, kërkimin dhe inovacionin, teknologjinë e informacionit dhe komunikimit.

Strategjia Ndërsektoriale e Zhvillimit Rajonal të Republikës së Shqipërisë dallon **zonat kufitare si subjekt të planifikimit të politikave ndërsektoriale** dhe i bën çështjet ndërkufitare pjesë të planifikimit të politikave të zhvillimit në nivel qarku.

Raportet e vitit 2012 nga Komisioni për Parlamentin dhe Këshillin Evropian mbi zbatimin e reformave në kuadër të anëtarësimit në BE për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë theksojnë se marrëdhëniet midis dy vendeve vazhdojnë të përmirësohen dhe ato tregojnë baza të shëndosha për shfrytëzimin e mundësive ekonomike në të dyja anët e kufirit.

Demografia

Dinamikat në demografi janë të ndryshme në të dy vendet. Ndërsa norma e popullsisë së përgjithshme të Republikës së Shqipërisë ka pësuar rritje të ndjeshme dhe është dyfishuar në 50 vitet e fundit, popullsia e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë është rritur me mesatarisht 29%.

Në fund të vitit 2012, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Republika e Shqipërisë kishin një popullsi prej përkatësisht 2,061,044 dhe 2,815,749 banorë. Zona e programit përfshin 770,802 banorë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (37.4% e popullsisë së përgjithshme të saj) dhe 656,873 banorë në Republikën e Shqipërisë (23.3% e popullsisë së përgjithshme të saj). Një ndarje më e detajuar e nivelit të popullsisë sipas NUTS-3 dhe dendësisë së popullsisë (persona / km^2) është dhënë më poshtë.

Zona e Programit	Numri i banorëve	Dendësia e popullsisë
Pellagonia	232,959	49.4
Pollogu	317,003	131.2
Jug-perëndimi	220,840	66.1
Gjithsej në zonën e ish-Republikës Jugosllave të	**770,802**	**73.6**

Maqedonisë		
Dibra	137,811	37.1
Elbasani	297,476	115.0
Korça	221,586	23.3
Gjithsej në zonën e Republikës së Shqipërisë	**656,873**	**69.2**

Burimi: Zyra e Statistikave e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, INSTAT

Rajoni i Pollogut me kryeqytetin e tij në Tetovë dhe Elbasani me qytetin kryesor të Elbasanit janë njësitë statistikore më të mëdha në zonën e programit në aspektin e popullsisë. Roli i shquar policentrik i qendrave të tyre kryesore urbane është reflektuar në dendësinë e popullsisë së dy rajoneve.

Femrat përbëjnë 49.9% të popullsisë në tre rajonet e pranueshme në territorin e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, e cila pasqyron strukturën e popullsisë sipas gjinisë në të gjithë vendin. Në zonën e programit në Republikën e Shqipërisë femrat përbëjnë 49.5% të popullsisë së saj, që është pak nën mesataren e vendit (49,9%).

Përsa i përket rritjes natyrore të popullsisë, zonat e programit në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë karakterizohen nga rritje pozitive natyrore në rajonin e Pollogut dhe atë jug-perëndimor, ndërsa të gjitha zonat përfituese në Republikën e Shqipërisë dhe në Pellagonia në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, po përjetojnë tendenca negative.

Megjithatë, vetëm normat e rritjes natyrore të bashkuara me bilancin e migrimit të kohëve të fundit ilustrojnë tendencat aktuale demografike. Brenda zonës së programit, vetëm rajonet e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë gëzojnë bilanc pozitiv të migrimit, ndërsa të gjithë rajonet në Republikën e Shqipërisë vuajnë nga tendencat negative të migrimit, të cilat kontribuojnë në shpopullimin e zonave të tyre. Bilanci negativ i migrimit në rajonet përkatëse të Republikës së Shqipërisë është shkaktuar nga zhvendosja e kontingjentit të punës të grupmoshës 25-40 vjeçare për të kërkuar për mundësi punësimi në rajone të tjera. Ndërsa largimi i meshkujve është më i përhapur në Dibër dhe Elbasan, Korça paraqet migrimin më të shpejtë të femrave drejt zonave të tjera.

Asnjëri nga të dy vendet nuk përjeton plakjen e popullsisë. Përkundrazi, mosha mesatare në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë mbetet e njëjtë për dy vitet e fundit (38 vjeç) dhe popullsia në Republikën e Shqipërisë bëhet më e re (me një mesatare prej 36 dhe 35 vjeç përkatësisht).[13] Brenda zonës së programit, mosha më e lartë mesatare e popullsisë është në Pellagoni (40 vjeç) dhe mbetet e qëndrueshme gjatë viteve të fundit, ndërsa rajoni më i ri është ai i Pollogut (35 vjeç), me tendenca të ngjashme me ato të vëzhguara në Republikën e Shqipërisë.

Popullsia e re (grupmosha 0-14 vjeç) përbën 17.1%, ndërsa popullsia e moshuar (65+ vjeç) përbën 11.9% të popullsisë së përgjithshme të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Në Republikën e Shqipërisë, shifrat përkatëse janë: 20.3% dhe 11.6%, dhe nuk ka mospërputhje të mëdha midis rajoneve të vendit. Përkundrazi, Pollogu dhe Pellagonia regjistrojë diferencën më të lartë në lidhje me pjesën e popullsisë së tyre të moshuar: përkatësisht 8.5% dhe 15.0%.[14]

Raporti i moshës së të punësuarve është një çështje shqetësuese në Republikën e Shqipërisë. Edhe pse indeksi pësoi një rënie të ngadaltë dhe arriti në 47 në vitin 2012 ndërsa për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë është përcaktuar në 41, rritja natyrore e bashkuar me rritjen e parashikuar të jetëgjatësisë mund të ndikojë negativisht në ekonomi. Në zonën e programit, Pellagonia është rajoni më i prekur nga plakja e popullsisë (shkalla e moshës së të punësuarve është 43) ndërsa në Republikën e Shqipërisë është Korça (mesatarisht 50%).[15]

Kohezioni Ekonomik

[13] Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave; llogaritja e bazuar në të dhënat e papërpunuara të INSTAT
[14] Burimi: *si më lart*
[15] Burimi: *si më lart*

Të dy vendet shfaqin nivel të ngjashëm të zhvillimit dhe janë klasifikuar si ekonomi me të ardhura mbi mesataren nga Banka Botërore. Megjithatë niveli i Brendshëm i të Ardhurave Bruto i tyre thjesht e kalon vijën ndarëse midis ekonomive të tyre dhe të vendeve me të ardhura të ulëta – të mesme.

Prodhimi i Brendshëm Bruto

Duke pasur parasysh faktin se analizat janë kryer mbi nivelin NUTS-3 dhe GDP-ja për frymë tregon pozitë të shquar të kryeqyteteve të të dy shteteve, si të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe të Republikës së Shqipërisë, në vendet e tjera pasuria është e shpërndarë në mënyrë të moderuar në të dy shtetet, me pabarazi më të larta të vërejtura në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, në krahasim me Republikën e Shqipërisë. Në vitin 2011, GDP për frymë arriti në 3,631 € në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe 3,214 € në Republikën e Shqipërisë. Tabela e mëposhtme ilustron pabarazitë ndërmjet rajoneve të zonës së programit dhe treguesit e performancës së dy vendeve.

Zona e Programit	GDP për frymë (EURO)	Indeksi (për vend = 100)
Pellagonia	3,702	102
Pollogu	1,719	47
Jug-perëndimi	2,638	73
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	**3,631**	**100**
Dibra	1,999	62
Elbasani	2,796	87
Korça	2,526	79
Republika e Shqipërisë	**3,214**	**100**

Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave, INSTAT

Rajoni i Pollogut është më i pazhvilluari në të gjithë zonën e programit dhe Dibra mbetet prapa në zonën e Republikës së Shqipërisë. Në të vërtetë, rajoni i Dibrës është më i varfri në aspektin e performancës ekonomike në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Të dy rajonet janë në kufi me njëri-tjetrin.


Në vitin 2012, GDP-ja e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë u tkurr me 0.2%, ndërsa Republika e Shqipërisë ka shënuar një rritje të ulët prej 0.7%.

Vlera e Shtuar Bruto sipas Sektorëve

GVA ilustron strukturën e ekonomisë së zonës së programit dhe kjo është e qartë nga të dhënat statistikore që tregojnë se struktura e ekonomisë së ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë është i ndryshëm nga struktura e ekonomisë së Republikës së Shqipërisë.

Republika e Shqipërisë mbështetet në tregjet me shumicë dhe pakicë që përbëjnë 31% të GVA-së së vendit, por ky sektor është i një rëndësie më të vogël në prefekturat e zonave të programit në Republikën e Shqipërisë. Këto janë rajone kryesisht bujqësore me prodhimin bujqësor të Dibrës dhe Korçës që kontribuojnë në 1/3 e GVA-së në këto rajone. Bujqësia në rajonet e zonës së programit në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë ka kontribut më të vogël në GVA-në rajonale, duke pasur si sektorë kryesorë për gjenerimin e vlerës së shtuar në ekonominë e vendit industrinë dhe shërbime të tjera. Miniera dhe industria e Pellagonisë është faktori më i rëndësishëm që kontribuon në pasurinë e këtij rajoni. Në të vërtetë, vlera e saj e shtuar industriale në shifra absolute pothuajse e barazon vlerën e shtuar bruto industriale të të gjitha rajoneve të tjera në zonën e programit të të dy vendeve.

Kontributi në GVA nga sektorë të ndryshëm është përshkruar në figurën më poshtë.



Burimi: llogaritje bazuar në Zyrën Shtetërore të Statistikave; INSTAT

Tregtia e jashtme

Të dhënat mbi tregtinë e jashtme ilustrojnë potencialin ekonomik të çdo territori dhe është e qartë se zona e programit karakterizohet nga nivele të ulëta të aktivitetit ekonomik dhe konkurrencës ndërkombëtare. Në mënyrë të qartë, Pellagonia në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Elbasani në Republikën e Shqipërisë luajnë rolin më të rëndësishëm në ndërkombëtarizimin e ekonomisë në zonën e programit (tabela më poshtë).

Zona e Programit	Aksionet në Eksport (%)	Aksionet në Import (%)
Pellagonia	6.4	3.9
Pollogu	2.7	2.9
Jug-perëndimi	1.9	1.8
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	**100**	**100**
Dibra	1.4	0.1
Elbasani	9.9	7.1
Korça	3.2	2.6
Republika e Shqipërisë	**100**	**100**

Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave (ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (Republika e Shqipërisë)

Minierat dhe Energjia

Zona kufitare ndërmjet dy vendeve është e pasur me minerale dhe burime natyrore. Ndërsa miniera e qymyrit është më e rëndësishmja për zonën kufitare të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë në basenet e Kërçovës dhe Pellagonisë, zona kufitare e Republikës së Shqipërisë, përveç qymyrit, shfrytëzon hekurin, bakrin dhe kromin. Brezi ndërmjet Bilishtit dhe Librazhdit ka depozita të konsiderueshme të hekurit dhe nikelit mineral. Prefekturat e Dibrës dhe Elbasanit janë të pasura me krom, me minierën e kromit në Bulqizën veriore që ka një rëndësi strategjike. Qymyri shfrytëzohet në Korçë, megjithatë depozitat e qymyrit në këtë zonë përbëjnë vetëm rreth 10% të të gjitha depozitave të qymyrit në Republikën e Shqipërisë.

Depozitat e qymyrit në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë janë linjit me vlerë relativisht të ulët në kalori dhe me përmbajtje të lartë të lagështirës dhe të hirit nga epokat gjeologjike të Pliocenit dhe Miocenit.

Minerale të tjera përfshijnë: titan-magnez, talk, granit, mermer, gurë gëlqerorë, dolomite dhe gurë të tjerë dekorativë karbonatikë.

Rajonet Pollog dhe ai jug-perëndimor në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë përmbajnë 9 termocentrale hidroelektrike, ndërsa në Pellagoni ndodhet një impiant i energjisë diellore. Zona kufitare e Republikës së Shqipërisë përmban 41 hidrocentrale, kryesisht në lumenjtë Drin dhe Devoll. Kapaciteti i përgjithshëm i prodhimit të energjisë elektrike të instaluar ilustron avantazhin e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, edhe pse është Republika e Shqipërisë ajo që prodhon energji elektrike të gjelbër në sajë të impianteve të saj hidroelektrike.

Rajonet në zonën e programit të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë prodhojnë 60% të energjisë elektrike të përgjithshme në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, ndërsa rajonet në Republikën e Shqipërisë përbëjnë 47% të kapacitetit të impianteve të energjisë së vendit.


Zona e Programit	Kapaciteti (MW)
Pellagonia	685
Pollogu	190
Jug-perëndimi	258
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	**1,889**
Dibra	39.7
Elbasani	18.9
Korça	32.0
Republika e Shqipërisë	**195.8**

Burimi: Zyra e Statistikave (ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë), Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (Republika e Shqipërisë), 2012

Sipërmarrja

Zona e programit karakterizohet nga veprimtari ekonomike nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Megjithatë rëndësia e tyre në ekonominë rajonale është më e ulët sesa në rajonet e tjera të të dy vendeve. Vetëm 32% e SME-ve të përgjithshme të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe 17% e SME-ve të përgjithshme të Republikës së Shqipërisë ndodhen në zonën e programit, dhe këto vlera konsiderohen shumë të ulëta në raport me numrin e popullsisë në rajonet kufitare.

Pabarazitë rajonale tashmë të theksuara ndikojnë edhe në disproporcionin e intensitetit të SME-ve në secilin rajon të pranueshëm. Nga e gjithë zona e programit, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë më të përhapura në Pellagoni në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Korçë në Republikën e Shqipërisë. Siç përshkruhet në grafikun e mëposhtëm, rrethet e tjera përmbajnë një numër më të ulët të SME-ve.



Burimi: Llogaritje bazuar në Zyrën Shtetërore të Statistikave; INSTAT

Ndërsa minierat dhe industritë e lidhura me to në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë janë në gjendje të tërheqin bizneset e vogla dhe të krijojnë mundësi për zinxhirin e vlerave, industritë e rënda në Republikën e Shqipërisë prodhojnë pak efekt përhapje dhe shumë pak mundësi ekonomike për bizneset e vogla.

Zakonisht, në zonat kufitare bizneset shfrytëzojnë mundësitë e tregtisë ndërkombëtare, por tregtia midis dy vendeve dhe të tretëve është e kufizuar nga pengesat administrative, kryesisht në Republikën e Shqipërisë. Ndërsa gëzojnë përparësi të lartë krahasuese të kostove të importit dhe eksportit të mallrave, SME-të në Republikën e Shqipërisë operojnë në një nga kuadret më të pafavorshme administrative në Evropë për ndërkombëtarizimin e biznesit. Aspektet kryesore të këtij problemi janë paraqitur në tabelën e mëposhtme (në bazë të të dhënave të SBA).

Faktori	Republika e Maqedonisë	Republika e Shqipërisë
Kostot e kërkuara për të importuar (USD)	1,380	710
Koha e kërkuar për të importuar (ditë)	11	18
Nr. i dokumenteve të kërkuar për të importuar	6	9
Kostot e kërkuara për të eksportuar (USD)	1,376	725
Koha e kërkuar për të eksportuar (ditë)	12	19
Nr. i dokumenteve të kërkuar për të eksportuar	6	7

Burimi: të dhënat e SBA, Ndërmarrja DG

Barra administrative dhe konkurrenca e varfër rezultojnë në deficit të konsiderueshëm të tregtisë së jashtme midis dy vendeve, në disfavor të Republikës së Shqipërisë.

Punësimi

Bazuar në gjetjet e LFS, në fillim të vitit 2012 dhe 2013, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Republika e Shqipërisë kishin përkatësisht 56.5% dhe 63.2% popullsi në moshë pune (grupmosha 15-64 vjeç) ekonomikisht aktive, me pabarazi të mëdha nëpër rajonet e të dy vendeve. Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë përqindja më e lartë (60.9%) ishte regjistruar në rajonin Juglindor, dhe më e ulëta në rajonin e Pollogut (44.3%). Edhe pse shifrat rajonale nuk janë në dispozicion për Republikën e Shqipërisë, vlerësohet se rajoni i Tiranës regjistron normat më të larta të aktivitetit, në krahasim me pjesën tjetër të vendit. Zonat e kufirit të Republikës së Shqipërisë përmbajnë norma të aktivitetit nën mesataren e vendit.

Shkalla e punësimit prej 44% në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë është më e ulët se ajo në Republikën e Shqipërisë (50.1%). Në zonën kufitare CBC Pellagonia ka normën më të lartë (46.9%) ndërsa Pollogu dhe jugperëndimi – përkatësisht 29.3% dhe 32.4%. Rajonet e bashkëpunimit ndërkufitar në Republikën e Shqipërisë kanë norma punësimi më të larta, ku të gjithë e kalojnë mesataren e vendit: Dibra 55%, Elbasani 55.7% dhe Korça 53.8%. Këto norma të larta të punësimit rezultojnë nga niveli minimal i jetesës dhe nga prodhimi bujqësor në shkallë të ulët, i cili siguron një formë të sigurimeve shoqërore për pjesën më të madhe të popullsisë rurale, dhe shërben si një amortizator kundër normave të larta të papunësisë së regjistruar.

Norma e punësimit	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	Republika e Shqipërisë
Meshkuj	52.4	56.6
Femra	35.3	43.7

Burimi: LFS nga Zyra Shtetërore e Statistikave, INSTAT

Nivelet e punësimit sipas gjinisë gjithashtu përshkruajnë pabarazi të mëdha midis dy vendeve. Për Republikën e Shqipërisë, si meshkujt ashtu edhe femrat janë më aktivë në tregun e punës dhe gjejnë më shpesh mundësi për të bërë të ardhura se sa homologët e tyre në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Megjithatë, këto pabarazi rezultojnë kryesisht nga pjesa e lartë e punësimit në sektorin e bujqësisë, ku punojnë 40% e meshkujve dhe 60% e femrave ekonomikisht aktivë.

Në bazë të sektorëve, pjesën më të madhe të kontributit në krijimin e punësimit në Republikën e Shqipërisë e ka bujqësia (duke përfshirë peshkimin dhe pyjet), e cila punëson rreth 48.7% të popullsisë ekonomikisht aktive, ndërsa në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë kë sektor përbën 17.3% të të gjithë të punësuarve. Prodhimi industrial, industria dhe ndërtimi është punëdhënësi më i madh në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe përbën 29.9% të të gjithë të punësuarve. Në Republikën e Shqipërisë ky sektor kontribuon vetëm në 16% të mundësive për punësim.

Nuk ka të dhëna specifike mbi punësimin sipas sektorëve në nivel rajonal, por vlerësohet se sektori i shërbimeve është kontribuuesi kryesor në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe sektori i bujqësisë në Republikën e Shqipërisë.

Turizmi

Natyra, trashëgimia kulturore dhe historike janë themelet kryesore të zhvillimit të turizmit në zonën kufitare. Potenciali turistik është i rëndësishëm në zonën kufitare, por ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë e ka më të zhvilluar industrinë e turizmit dhe i shfrytëzon mundësitë e zinxhirit të vlerave në shkallë shumë më të madhe se Republika e Shqipërisë. Kjo ilustrohet nga numri i qëndrimeve me fjetje në qendra akomoduese: ndërsa ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë ka regjistruar më shumë se 2,1 milionë në vitin 2012, Republika e Shqipërisë regjistroi vetëm 0.8 milion qëndrime turistike me fjetje. Turizmi familjar në Republikën e Shqipërisë përbën 55.6%, ndërsa në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë 62.2% të të gjithë industrisë së turizmit. Me më shumë se 26.8 mijë dhoma në qendrat akomoduese, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka kapacitet më të lartë strehimi se sa Republika e Shqipërisë (me vetëm 18.9 mijë dhoma).

Megjithatë, ka dallime strukturale dhe rajonale midis dy vendeve: ndërsa destinacionet turistike prioritare në Republikën e Shqipërisë janë në bregdetin Adriatik dhe Jon, infrastruktura e turizmit të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë përqendrohet në rajonin jugperëndimor. Në të vërtetë, trafiku i turizmit në jugperëndim është më i madhi i të gjitha rajoneve të vendit dhe përbën 45.1% të numrit të përgjithshëm të turistëve në vend, me zonat kryesore turistike rreth liqeneve të Ohrit dhe Prespës. Trafiku i turizmit në zonën e programit të Republikës së Shqipërisë është relativisht i parëndësishëm kur krahasohet me zonës ndërkufitare të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, edhe pse për shkak të mungesës së të dhënave specifike rajonale mbi këtë temë nuk mund të nxirren konkluzione të mëtejshëm.

Ekonomia Rurale

Lartësia e tokës në zonën e programit krijon kushte të favorshme për pylltarinë dhe janë pikërisht zona Jugperëndimore dhe Pellagonia në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe të gjitha rajonet CBC në Republikën e Shqipërisë, zonat ku mbulimi i pyjeve është mbi mesataren e të dy vendeve. Në të vërtetë, Republika e Shqipërisë përmban një ndër pjesët më të vogla të tokës së punueshme në të gjitha tokat bujqësore në Evropë. Lartësia e tokës ndikon negativisht në ekonominë rurale të komuniteteve të zonës kufitare dhe zvogëlon mundësitë bazike ekonomike dhe të të ardhurave që rrjedhin nga shfrytëzimi i tokës.

Megjithatë, ekonomia rurale dhe bujqësia është një sektor i rëndësishëm i ekonomisë në të dy vendet, edhe pse Republika e Shqipërisë mbështetet në prodhimin e ushqimit në shkallë shumë më të madhe se sa ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë. Tabela e mëposhtme jep faktet

thelbësore të potencialit ekonomik rural lidhur me tokën bujqësore (shifrat në '000 ha nëse nuk citohet ndryshe).

Shteti / Rajoni	Tokë e përgjithshme bujqësore	Tokë e punueshme dhe kopshte	Tokë e punueshme si % e tokës bujqësore	Madhësia mesatare e fermës (ha)
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	**1,268**	**510**	**40**	**1.60**
Pellagonia	263	112	43	2.90
Pollogu	169	43	25	4.10
Jugperëndimi	136	50	37	3.00
Republika e Shqipërisë	**2,875**	**696**	**24**	**1.20**
Dibra	249	41	16	0.72
Elbasani	327	73	22	1.26
Korça	371	91	25	1.27

Burimi: INSTAT, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (ish Republika Jugosllave e Maqedonisë) dhe: llogaritje të bazuara në të dhënat e Bankës Botërore për madhësisë së fermës në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, 2012

Në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë toka e punueshme përbën 40% të të gjithë tokës bujqësore, ndërsa në Republikën e Shqipërisë ky raport është 24%. Mesatarisht, në zonën e programit të të dy vendeve pjesa e tokës së punueshme në raport me madhësinë e përgjithshme të tokës bujqësore është nën mesataren e vendit, duke sjellë kushte të pafavorshme për ekonominë rurale. Në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë prodhimi bujqësor ka kushte më të favorshme natyrore për kulturat bujqësore dhe prodhimin blegtoral.

Ekonomia rurale e të dy vendeve është e fragmentuar. Në Republikën e Shqipërisë madhësia mesatare e fermës është 1.2 ha dhe vetëm rajoni i Dibrës është nën mesataren e vendit. Në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë madhësia mesatare e fermës është 1.6 ha, por zona e programit përmban fermat më të mëdha bujqësore në krahasim me çdo zonë tjetër të vendit.

Prodhimet bimore kryesore në zonën e programit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Prodhimet bujqësore janë radhitur në bazë të prodhimit të përgjithshëm për vendin dhe rajonin.

Shteti / Rajoni	Prodhimi kryesor bujqësor
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	**Gruri, perimet, patatet, misri, tërfili**
Pellagonia	Gruri, perimet, patatet, frutat, jonxha, duhani
Pollogu	Misri, patatet, perimet, jonxha, tërfili
Jugperëndimi	Patatet, gruri, misri, jonxha, perimet, frutat
Republika e Shqipërisë	**Gruri, misri, perimet, fasulet, patatet, tërshëra**
Dibra	Misri, gruri, perimet
Elbasani	Gruri, misri, perimet, tërshëra, fasulet, patatet, bagëtitë, frutat dhe rrushi
Korça	Gruri, misri, perimet, fasulet, elbi

Burimi: përpunimi në bazë të INSTAT, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (Republika e Shqipërisë) dhe Zyra shtetërore e statistikave (ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë), 2012

Ndërsa zona CBC e Republikës së Shqipërisë është e specializuar në drithëra, perime, fasule dhe prodhimin e tërshërës, ekonomia rurale e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë është më e larmishme dhe rajonet janë të specializuar në varietete të kulturave. Rajonet e Jugperëndimit dhe Elbasanit janë shembuj ku të ardhurat janë të larta dhe prodhimi është i larmishëm, ndërsa Korça dhe Pollogu kanë të ardhura më të ulëta në prodhimin bujqësor.

Ekonomia rurale në zonën e programit ndikohet negativisht nga erozioni i tokës. Lartësia e tokës, veçanërisht në zonat ku alternohen malet, kodrat dhe luginat me karakterin e rrëmbyeshëm të reshjeve, kontribuon në humbjet e përshpejtuara të tokave. Nuk ka të dhëna specifike rajonale mbi erozionin e tokës, por në nivel kombëtar Republika e Shqipërisë është vlerësuar të ketë një humbje prej më shumë se 16 t / ha në vit, ndërsa për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, kjo shifër është vlerësuar të kalojë 18 t / ha.[16]

Infrastruktura e Transportit

Të dhënat kryesore mbi infrastrukturën dhe transportin janë përshkruar në tabelën e mëposhtme.

Treguesi	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	Republika e Shqipërisë
Hekurudha (km)	696	399
Rrugë në total (km)	13,983	18,000
Lokomotiva	52	53
Transport hekurudhor për mallra ('000 t-km)	478,925	8,333
Makina të pasagjerëve	313,084	300,974
Mjete për transportin e mallrave	27,917	71,278
Autobuzë	2,636	6,698

Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave (ish Republika Jugosllave e Maqedonisë), INSTAT, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (Republika e Shqipërisë), 2012

Nuk ka të dhëna që ilustrojnë ndarjen rajonale të infrastrukturës së transportit, por për të dy vendet rruga e interesit të përbashkët të transportit është Korridori VIII Perëndim-Lindje dhe për zonën kufitare është një seksion i rrugës Elbasan-Kafasan-Shkup. Autostrada Tiranë-Elbasan e përfunduar kohët e fundit është një përmirësim i rëndësishëm në këtë rrugë ndërkombëtare, e cila përmirëson kushtet e sigurisë së transportit rrugor dhe aksesin në të.

Transporti rrugor duket si mënyra më e rëndësishme e transportit, pasi nuk ka asnjë hekurudhë që lidh të dy vendet - linja Shkup-Kërçovë nuk shtrihet më tej në drejtim të Ohrit dhe në kufi.

Kohezioni Social

Ky seksion përshkruan tiparet kryesore të kapacitetit të zonës së programit për të siguruar mirëqenien e popullit të saj duke minimizuar dallimet dhe duke shmangur margjinalizimin.

Papunësia

Sipas metodologjisë LFS, shkalla e papunësisë përfaqëson pabarazi të mëdha ndërmjet dy vendeve kufitare. Në mënyrë të qartë, papunësia është një çështje shumë shqetësuese dhe problematike në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, ndërsa në Republikën e Shqipërisë pjesa më e madhe e fuqisë punëtore thithet nga ekonomia e fragmentuar rurale.

Zona e Programit	Papunësia (%)
Pellagonia	25.3
Pollogu	34.2
Jugperëndimi	42.3
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	**31.0**

[16] Burimi: Qendra e përbashkët kërkimore, Komisioni Evropian

Dibra	8.7
Elbasani	6.0
Korça	10.4
Republika e Shqipërisë	**13.4**

Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave, INSTAT, LFS 2012

Të ardhurat

Pagesa mesatare neto për të punësuarit në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë arrin në 335 € dhe në Republikën e Shqipërisë deri në 356 €. Pra, njerëzit në Republikën e Shqipërisë fitojnë 7% më shumë se sa ata që jetojnë në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Pagat neto ndryshojnë në rajone të ndryshme në të dy vendet, por në zonat përfituese të programit nuk ka pabarazi të konsiderueshme në nivelin e të ardhurave neto.

Zona e Programit	Paga neto, Për vend=100
Pellagonia	91.7
Pollogu	95.6
Jugperëndimi	90.8
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	**100**
Dibra	97.0
Elbasani	95.7
Korça	100.3
Republika e Shqipërisë	**100**

Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave, llogaritje në bazë të të dhënave të INSTAT

Teknologjia e Informacionit

Zona e programit karakterizohet nga pabarazi të larta në aksesin dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit, e cila është një nga forcat kryesore lëvizëse të zhvillimit ekonomik bashkëkohor. Pabarazitë lidhen me diferencat ndërmjet dy vendeve dhe midis rajoneve të pranueshëm të Republikës së Shqipërisë.

Zona e Programit	Përdorimi i Kompjuterave	Përdorimi i Internetit
Pellagonia	61.0	55.0
Pollogu	64.0	64.0
Jugperëndimi	64.0	57.0
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	**64.0**	**58.0**
Dibra	15.5	6.5
Elbasani	16.8	8.3
Korça	14.5	11.0
Republika e Shqipërisë	**20.2**	**14.1**

Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave, INSTAT, LSMS 2012

Të dhënat e mësipërme ilustrojnë një ndarje dixhitale ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë, ku familjet dhe bizneset shqiptare janë padyshim të ekspozuar ndaj përjashtimit dixhital. Kjo dukuri përbën një shqetësim kritik, pasi nuk rezulton nga paaftësia apo mosha e njerëzve. Për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë normat krahasimore janë të larta, por prapë mbeten më të ulëta se në të gjithë shtetet anëtare të BE-së, me afërsisht 30% nën mesataren.

Arsimi

Në të dy vendet shkalla e arsimimit është konsideruar e lartë: 96% për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe 97% për Republikën e Shqipërisë. Nuk ka devijime të mëdha rajonale nga mesatarja kombëtare apo pabarazi ndërmjet rajoneve që përbëjnë zonën e programit.

Edukimi dhe Shkollimi

Shkollimi dhe arsimimi janë strukturat dhe instrumentet qendrore për të zhvilluar dhe për të formësuar kapitalin njerëzor, i cili ka një rol themelor në ndërtimin e një ekonomie të qëndrueshme të bazuar në dije, konkurrencës, kohezionit social dhe qëndrueshmërisë.

Ndërsa aksesi në arsimin fillor është relativisht i ekuilibruar dhe shkollat nuk janë të mbipopulluara, arsimi i mesëm është disi më i sforcuar, veçanërisht në Republikën e Shqipërisë, me qarkun e Dibrës të ekspozuar kryesisht ndaj infrastrukturës së pamjaftueshme të shkollave. Në këtë rajon, numri mesatar i nxënësve për mësues është dukshëm më i lartë se mesatarja për vendin (shih tabelën më poshtë).

Zona e programit	Nr. i nxënësve për mësues (arsimi fillor)	Nr. i nxënësve për mësues (arsimi i mesëm)	Nr. i studentëve të diplomuar në 1,000 banorë
Pellagonia	11	14	118
Pollogu	12	13	71
Jugperëndimi	10	13	92
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	**12**	**13**	**103**
Dibra	15	21	39
Elbasani	14	16	63
Korça	13	15	77
Republika e Shqipërisë	**16**	**16**	**94**

Burimi: llogaritja e bazuar në të dhënat e papërpunuara nga Zyra Shtetërore e Statistikave dhe INSTAT, 2011

Shekulli i 21[të] karakterizohet nga emigrimi i personave me arsim të lartë, e cila është një dukuri e përhapur me rritjen e rolit të qyteteve dhe qendrave urbane, duke thelluar ndarjen urbane-rurale. Ky fenomen ndikon seriozisht në zonën e programit, me përjashtim të rajonit të Pellagonisë. Në vendet e tjera problemi është i përhapur (më shumë në Republikën e Shqipërisë), me kulmin negativ në Dibër, ku përqindja e njerëzve me arsim universitar është më e ulëta në mbarë territorin e programit CBC.

Furnizimi me ujë dhe Menaxhimi i mbetjeve

Në zonën e programit, rreth 97% e familjeve nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë janë të lidhura me sistemet individuale ose publike të furnizimit me ujë dhe 95% - me sistemin e kanalizimeve të ujërave të zeza. Përkatësisht, në Republikën e Shqipërisë, këto shifra janë: 95% dhe 87%.

Nuk ka statistika mbi vëllimin e trajtimit të ujërave të zeza, por vlerësohet se të paktën deri në 10% të mbetjeve të lëngshme trajtohen. Përveç shfrytëzimit të pakontrolluar të plehrave kimike në bujqësi, mungesa e trajtimit të ujërave të zeza është arsyeja kryesore për eutrofikimin e përshpejtuar të pjesës më të madhe të ekosistemeve ujore në zonën e programit (liqene dhe lumenj).

Përsa i përket mbetjeve të ngurta, 70% e mbetjeve të gjeneruara në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë është mbledhur, por për Republikën e Shqipërisë kjo pjesë është vlerësuar në nivele të konsiderueshme më të ulëta.

Tabela e mëposhtme përshkruan statistikat mbi mbetjet e ngurta të grumbulluara në zonën e programit.

Zona e programit	Ton ('000)	Ndarja (%), për vend=100
Pellagonia	72	13.0
Pollogu	59	10.6
Jugperëndimi	49	8.8
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	**555**	**100**
Dibra	33.1	2.9
Elbasani	81.1	7.1
Korça	62.1	5.4
Republika e Shqipërisë	**1,137**	**100**

Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave (ish Republika Jugosllave e Maqedonisë), Ministria e Mjedisit (Republika e Shqipërisë), 2012

Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, kapaciteti i vend-grumbullimeve të mbetjeve të ngurta është i shpërndarë në mënyrë të arsyeshme nëpër rajone dhe korrespondon në mënyrë të kënaqshme me vëllimin e mbetjeve të gjeneruara. Ndërsa për Republikën e Shqipërisë nuk disponohen të dhëna lidhur me këtë aspekt.

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta është një çështje shqetësuese për shkak të raportit të ulët të mbetjeve të krijuara dhe atyre të mbledhura. Përveç kësaj, ndarja gjatë depozitimit të mbetjeve është pothuajse jo-ekzistuese, e cila rrit koston e menaxhimit të mbetjeve dhe ndikon në mjedis.

Infrastruktura e kujdesit shëndetësor

Infrastruktura e kujdesit shëndetësor përmban pabarazi domethënëse përgjatë kufirit. Mesatarisht, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë ofron mundësi më të mira të trajtimit të specializuar mjekësor dhe Pellagonia ka infrastrukturën më konkurruese të kujdesit shëndetësor në të gjithë zonën e programit. Edhe pse territori CBC në anën e Republikës së Shqipërisë mund të ofrojë më shumë shtretër në spitale se mesatarja për të gjithë vendin, Shqipëria ka hyrë në marrëveshje strategjike me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, sipas së cilës qytetarët e Republikës së Shqipërisë me sëmundje kronike mund të përdorin spitalet dhe klinikat në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë për një trajtim më të specializuar. Kjo ndodh për shkak të pranisë së kufizuar të pajisjeve moderne apo aksesit të vështirë fizik të infrastrukturës shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, kryesisht në zonat më të largëta.

Zona e programit	Nr. i Spitaleve	Nr. i shtretërve të spitaleve	Nr. i shtretërve të spitaleve për 1,000 banorë
Pellagonia	3	1,419	6,1
Pollogu	7	646	2
Jugperëndimi	5	815	2
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	**73**	**9,076**	**4,4**
Dibra	3	508	3,7
Elbasani	6	1,020	3,4
Korça	4	752	3,4
Republika e Shqipërisë	**44**	**8,410**	**3**

Burimi: Ministria e Shëndetësisë (ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Republika e Shqipërisë)

Analiza SWOT

Kjo analizë SWOT ndjek logjikën e prioriteteve tematike të asistencës IPA II dhe përshkruan pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe kërcënimet duke marrë parasysh karakterin apo efektin e tyre strategjik (cilësia e nevojës ose e mundësisë). Kjo analizë SWOT mbulon vetëm ato

tema që janë konsideruar për përfshirjen në ndërhyrjen strategjike dhe shton analizën e grupit të problemeve të përshkruar në seksionin 2.2 të dokumentit të programit.[17]

SWOT është hartuar në bazë të pyetësorëve individualë të plotësuar nga palët e interesuara të programit, reagimet nga Strategjitë ekzistuese të Zhvillimit Rajonal në rajonet e NUTS-3 në zonën kufitare, dhe konkluzionet e ekspertëve mbi profilin social-ekonomik të rajonit.

Analiza më poshtë ndjek rendin sipas rëndësisë së prioriteteve tematike të zgjedhura për Programin IPA II CBC 2014-2020.

Turizmi dhe trashëgimia kulturore dhe natyrore (TP4)

Aktualisht, niveli i pabarabartë i zhvillimit të infrastrukturës turistike në rajonin ndërkufitar e bën rajonin e përgjithshëm jo tërheqës për një ofertë gjithëpërfshirëse turistike, veçanërisht në anën e Republikës së Shqipërisë. Kështu, format alternative të turizmit mund të përdoren si bazë për ndërtimin e një imazhi të zonës së programit si një destinacion tërheqës turistik.

Trashëgimia e pasur kulturore nuk është e ruajtur dhe paraqitur mirë. Kështu, iniciativat për rritjen e bashkëpunimin ndërmjet njerëzve dhe institucioneve nga rajoni CBC duhet të intensifikohen në të ardhmen.

Pikat e forta	Pikat e dobëta
(Efekt) Ofertë e pasur turistike bazuar në shfrytëzimin e burimeve natyrore, trashëgiminë kulturore, monumentet fetare, ujërat termale, sportin dhe argëtimin	**(Dobësi strategjike)** Nuk ka nivel të balancuar të infrastrukturës së turizmit (akomodim, sporte, terrene) dhe mungesa e strategjisë për ofertë të qëndrueshme turistike të rajonit CBC
(Pikë e fortë strategjike) Eksperienca në pritjen e mysafirëve vendas dhe ndërkombëtarë	**(Efekt)** Mungesa e njohjes ndërkombëtare të të gjithë rajonit CBC si destinacion atraktiv turistik
(Pikë e fortë strategjike) Një pjesë e territorit CBC rrit njohjen e tij si destinacion turistik i rëndësishëm për turizmin familjar	**(Efekt)** Mirëmbajtja e papërshtatshme e monumenteve historike dhe kulturore
Mundësitë	**Kërcënimet**
(Efekt) Ofertë turistike e integruar, e bazuar në kulturë, sport, kohë të lirë, aventurë, turizmin spa (të llixhave)	**(Efekt)** Mungesa e strategjisë së integruar të zhvillimit të turizmit dhe masave të përkushtuara për rajonin CBC
(Mundësi strategjike) Shkëmbim më efikas dhe i integruar i përvojave ndërmjet dy vendeve dhe operatorëve	**(Kërcënim strategjik)** Investime të pa balancuara në infrastrukturën e turizmit
(Mundësi strategjike) Plani i përbashkët për hartëzimin, mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e monumenteve kulturore dhe historike	**(Efekt)** Imazhi i papërshtatshëm i rajonit CBC
(Mundësi strategjike) Aktivitete të përbashkëta kulturore	

Konkurrenca, biznesi, tregtia dhe investimet (TP7)

SME-të, sipërmarrja dhe ekonomia rurale paraqiten si një nga forcat kryesore lëvizëse të zhvillimit ekonomik në zonën e programit. Ato janë të ndjeshme ndaj ndryshimeve të politikës dhe të tregut, kryesisht për shkak të konkurrencës së kufizuar dhe orientimit të tregut të tyre. Kështu, industritë e lehta, sektorët e qëndrueshëm të bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit janë konsideruar si një potencial për rritje më të qëndrueshme ekonomike të rajonit CBC në tërësi.

Pikat e forta	Pikat e dobëta
(Pikë e fortë strategjike) Baza ekzistuese e SME-ve	**(Dobësi strategjike)** SME-të janë të karakterit mikro

[17]Në korrik 2013 Strukturat Operacionale arritën në përfundimin se lista e TP-ve duhet të ngushtohet para hyrjes në fazën e konsultimeve më të gjera të programimit për shkak të burimeve të kufizuara financiare të programit. Më pas, TP-të janë renditur sipas rëndësisë së tyre dhe janë përfshirë në ndërhyrjen për vitet 2014-2020.

në rajonin e përgjithshëm me aktivitete të shumëllojshme	dhe jashtëzakonisht të ndjeshme ndaj ndryshimeve politike, fiskale apo të tregut
(Pikë e fortë strategjike) Prodhimi i larmishëm bujqësor dhe ekonomia rurale në të gjithë rajonin	**(Dobësi strategjike)** Mungesa e specializimit, vlerës së shtuar, hulumtimit dhe orientimit të plotë të tregut
(Efekt) Bizneset e mesme të qëndrueshme dhe konkurruese, veçanërisht në rajonet e Pollogut, Elbasanit dhe Pellagonisë	**(Efekt)** Konkurrenca e kufizuar e produkteve në nivel rajonal dhe kombëtar, nivelet e ulëta të GVA
	(Dobësi strategjike) Bujqësia e karakterizuar nga fragmentim i madh, produktivitet i kufizuar dhe mungesë e orientimit në treg
	(Dobësi strategjike) Burimet natyrore në dispozicion të bujqësisë konkurruese dhe praktikave të prodhimit të ushqimit, të pashfrytëzuara
	(Kërcënim strategjik) Ofertë e kufizuar e produkteve gjysmë-të gatshme me sasi të qëndrueshme
Mundësitë	**Kërcënimet**
(Efekt) Zhvillimi ekonomik i bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve të disponueshme natyrore dhe zinxhirët e vlerave	**(Efekt)** Mospërputhje të mëdha në nivelin e zhvillimit dhe aktivitetet ekonomike midis rajoneve të ndryshme në zonën e bashkëpunimit ndërkufitar
(Mundësi strategjike) Specializimi i SME-ve dhe fuqizimi i tyre përmes shtimit të vlerës së produkteve të tyre	**(Efekt)** Aktivitete të pamjaftueshme të eksportit
(Mundësi strategjike) Identifikimi i produkteve që mund të njihen në nivel ndërkombëtar	**(Efekt)** Mikro-sipërmarrjet jo rezistuese ndaj ndryshimeve të tregut
(Mundësi strategjike) Prodhimi bujqësor dhe përpunimi i ushqimit organik, ose të paktën i qëndrueshëm organik	**(Kërcënim strategjik)** Prodhimi bujqësor i gjerë me tërheqje të kufizuar të tregut
(Mundësi strategjike) Bashkëpunim dhe tregti më të zhvilluara midis shoqërive në rajonin e Bashkëpunimit Ndërkufitar	**(Kërcënim strategjik)** Erozioni i lartë i tokës për shkak të lartësisë së tokës
(Mundësi strategjike) Zhvillimi i infrastrukturës së biznesit dhe rrjeteve të biznesit (inkubatorët, qendrat mbështetëse të biznesit, shoqatat, etj.)	

Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut (TP2)

Pavarësisht minierave intensive në territorin e kufizuar, rajoni i bashkëpunimit ndërkufitar është perceptuar si "zonë e gjelbër" e përshtatshme për zhvillimin ekonomik të bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, për shkak të pyjeve të bollshme, lumenjve dhe liqeneve. Megjithatë, rajoni nuk ka asnjë sistem për monitorimin e mjedisit apo për parandalimin e rrezikut. Për më tepër, mungesa e infrastrukturës mjedisore minimale të kërkuar (trajtimi i mbetjeve ujore, grumbullimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta, etj.) mund të çojë në ndotjen e mëtejshme të pakontrolluar në rajon dhe në rënien e tërheqjes nga aktivitetet e biznesit të bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Pikat e forta	Pikat e dobëta
(Pikë e fortë strategjike) Prania e burimeve të shumëllojshme natyrore (uji, pyjet, flora dhe fauna, klima)	**(Dobësi strategjike)** Mungesa e planeve për mbrojtjen e mjedisit, monitorimin dhe sistemet e parandalimit të rrezikut për çdo lloj të ndotjes në rajon dhe parandalimin e erozionit të tokës
(Efekt) "Zonë e pastër", pa ndotje të mëdha industriale	**(Dobësi strategjike)** Mungesa e kontrollit të shfrytëzimit të burimeve natyrore (minierat, pyjet)
(Pikë e fortë strategjike) Prania e zonave të ndryshme klimatike (malore, kontinentale dhe mesdhetare) mundëson prodhimin më të	**(Efekt)** Ndërgjegjësimi i ulët i popullsisë për mbrojtjen e mjedisit

specializuar të bujqësisë dhe zhvillimin e turizmit alternativ	
Mundësitë	**Kërcënimet**
(Efekt) Zhvillimi i strategjisë së përbashkët për mbrojtjen e mjedisit të rajonit CBC, monitorimin, njohjen e hershme dhe parandalimit e rrezikut	**(Efekt)** Rajonet e vogla me një kërcënim për ndotje që mund të rrezikojë zhvillimin e aktiviteteve të tjera ekonomike / turistike
(Mundësi strategjike) Zhvillimi i programeve të përbashkëta për trajtimin e mbetjeve	**(Kërcënim strategjik)** Mungesa e stimujve dhe investimeve në mbrojtjen e mjedisit dhe / ose teknologjive më miqësore
(Mundësi strategjike) Hartimi dhe zhvillimi i projekteve, studimeve të fizibilitetit për mbrojtjen e ujërave ndërkombëtare dhe ujërave nëntokësore	**(Kërcënim strategjik)** Ujërat ndërkombëtare me rrezik të lartë të ndotjes

SHTOJCA 1

PROGRAMI I VEPRIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR NDËRMJET ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR VITET 2018-2020

1. Identifikimi

Përfituesit	**Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë** **Republika e Shqipërisë**
CRIS/ABAC, Referencat e angazhimit Kontributi i Bashkimit Buxheti	**2018/041-370 EURO 1,700,000 22.020401** **2019/041-371 EURO 1,700,000 22.020401** **2020/041-372 EURO 1,700,000 22.020401**
Mënyra e menaxhimit Strukturat përgjegjëse	**Menaxhim i drejtpërdrejtë nga Komisioni Evropian** **Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë: Ministria e Vetëqeverisjes Vendore** **Në Republikën e Shqipërisë: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**
Data përfundimtare për mbylljen e Marrëveshjes/ve të Financimit me vendet përfituese (trepalëshe) të IPA II	**Për angazhimin buxhetor të vitit 2018:** **Në rastin më të vonë deri më 31 dhjetor 2019** **Për angazhimin buxhetor të vitit 2019:** **Në rastin më të vonë deri më 31 dhjetor 2020** **Për angazhimin buxhetor të vitit 2020:** **Në rastin më të vonë deri më 31 dhjetor 2021**
Data përfundimtare për mbylljen e kontratave të prokurimit dhe granteve	**3 vjet pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit (nga nënshkrimi i palës së fundit)** **me përjashtim të rasteve të renditura në nenin 114 (2) të Rregullores Financiare**
Data përfundimtare për zbatimin operacional	**6 vjet pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit (nga nënshkrimi i palës së fundit).**
Data përfundimtare për zbatimin e Marrëveshjes financiare **(data nga e cila ky program duhet të tërhiqet nga detyrimi dhe të mbyllet), pas pranimit të llogarive**	**12 vjet pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit (nga nënshkrimi i palës së fundit).**
Njësia e Programimit	**DG NEAR Njësia D3, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova**
Njësia Zbatuese/Delegacioni i BE-së	**Delegacioni i Bashkimit Evropian për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë**

2. Përshkrim i Programit të Veprimit

2.1 PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR 2014-2020 DHE PROGRAMI I VEPRIMIT TË BNK-SË 2018-2020

Programi i BNK-së 2014-2020 i ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë - Republika e Shqipërisë (Vendimi Zbatues i Komisionit C(2014) 9674, i datës 11 dhjetor 2014). Programi i miratuar 2014-2020 përbën strategjinë e bashkëpunimit BNK për rajonin kufitar, duke përcaktuar, ndër të tjera, listën e zonave gjeografike të pranueshme, kontekstin e zonës, prioritetet e programit dhe ndarjen e buxhetit për periudhën 7 vjeçare.

2014-2020 Programet BNK shërbejnë gjithashtu si referencë për miratimin e programeve të veprimit të BNK-së. Programi i veprimit 2018-2020 i BNK-së synon sigurimin e ndihmës për bashkëpunim ndërkufitar në fushat tematike të parashikuara në programin 2014-2020 (siç tregohet në seksionin 2.2).

Më 6 shkurt 2018, Komisioni Evropian miratoi Komunikatën[18] me temë "Një perspektivë e besueshme e zgjerimit për angazhim të zgjeruar të BE-së me Ballkanin Perëndimor". Kjo komunikatë synon të avancojë më tej reformën në Ballkanin Perëndimor dhe të sigurojë një angazhim të dukshëm për zgjerimin e BE-së për të mbështetur më mirë përgatitjet e tyre në rrugën evropiane. Komunikata përcakton orientimet e reja strategjike, veçanërisht në lidhje me zbatimin e gjashtë iniciativave kryesore. Në veçanti, bashkëpunimi ndërkufitar është një mjet kyç për nxitjen e pajtimit dhe trajtimin e trashëgimisë së të kaluarës në Ballkanin Perëndimor, në përputhje me iniciativën kyçe 6 (mbështetje për pajtimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë) dhe për zhvillimin e qëndrueshëm lokal, në përputhje me iniciativën kyçe 3 (mbështetje e zhvillimit socio-ekonomik).

Lista e zonave gjeografike të pranueshme

në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë

-Zona e Pelagonias: bashkitë e Bitolas, Demir Hisarit, Dolnenit, Krivogastanit, Krusevos, Mogilas, Novacit, Prilepit, dhe Resenit;Zona e Pologut: bashkitë e Bogovinjes, Brvenicas, Gostivarit, Jegunovces, Mavrovës dhe Rostusas, Tearces, Tetovës, Vrapcistes dhe Zelinës;Zona Jugperëndimore: bashkitë e Centar Zupas, Debarit, Debarcas, Kicevos, Makedonski Brod, Ohrit, Plasnicas, Strugës dhe Vevcanit.

Në Republikën e Shqipërisë:

-Zona e Dibrës: rrethet e Bulqizës, Burrelit dhe Dibrës;Zona e Elbasanit: rrethet e Cërrikut, Elbasanit, Gramshit, Librazhdit dhe Peqinit;Zona e Korçës: rrethet e Devollit, Korçës, Kolonjës dhe Pogradecit.

Bashkëpunimi ndërkufitar (BNK), konteksti i zonave përfituese

Analiza e situatës së bërë për përgatitjen e programit tregoi disa sfida dhe mundësi kryesore për tu trajtuar dhe mbështetur përmes bashkëpunimit ndërkufitar. Në veçanti Programi identifikoi prioritetet e mëposhtme:

1. Inkurajimi i turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore;

2.Rritjen e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve;

3.Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutja, parandalimi dhe menaxhimi i riskut.

Prioriteti numër 1 bazohet në mundësitë e identifikuara strategjike në lidhje me rëndësinë në rritje të turizmit si një mundësi ekonomike ndërkohë që nxitet shkëmbimi kulturor dhe, promovimi i trashëgimisë natyrore do të ruajë dialogun mes njerëzve dhe dialogun e shoqërisë civile me institucionet.

Prioriteti numër 2 nxitet nga nevoja dhe mundësitë dhe kërkon të zgjidhë nivelin e ulët të punësimit në zonën e Programit.

Prioriteti numër 3 synon tu përgjigjet nevojave specifike të një prej sektorëve të politikave më të neglizhuara; të mjedisit dhe ndryshimit klimatik. Në kontekstin e BNK-së, kjo do të zgjidhë çështjen e nxitjes së ekonomisë së pastër dhe të gjelbër, përdorimin më të përgjegjshëm dhe të

[18] Në 6 Shkurt 2018, Komisioni Evropian miratoi Komunikatwn e "Një perspektivë e besueshme e zgjerimit për angazhim të zgjeruar të BE-së me Ballkanin Perëndimor"

qëndrueshëm të burimeve natyrore, elasticitetin e klimës në infrastrukturën e një shkalle të vogël mbështetëse (kundër përmbytjeve dhe zjarreve) dhe erozionit të tokës në zonën kufitare malore.

Përmbledhje e përvojave të kaluara dhe atyre në vazhdim të BNK-së, duke përfshirë mësimet e nxjerra

Në zhvillimin e këtij programi janë marrë parasysh rekomandimet kryesore nga vlerësimet e përkohshme dhe auditimet e programeve të BNK-së në periudhën 2007-2013. Kështu, programet e BNK 2014-2020 janë më të fokusuara për sa i përket numrit të prioriteteve tematike të trajtuara dhe shtrirjes gjeografike, e cila do të ndihmojë për të arritur rezultate më të mira dhe ndikim më të lartë. Përveç kësaj, zbatimi i programeve të BNK-së është thjeshtuar kryesisht duke pasur një autoritet të vetëm kontraktues dhe një alokim të vetëm financiar për programin.

Mësimet kryesore të nxjerra u identifikuan edhe nga vlerësimi përfundimtar i Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA), Programet BNK 2007-2013, e realizuar midis viteve 2016 dhe 2017. Mësimet e nxjerra dhe rekomandimet u diskutuan me palët e interesuara të BNK-së në Ballkanin Perëndimor dhe masat për ndjekje u identifikuan për një afat të shkurtër dhe të mesëm, si për programet BNK 2014-2020 në vijim, ashtu edhe për programet e ardhshme BNK 2021-2027. Rekomandimet kryesore në lidhje me të gjitha programet BNK në nivelin e Ballkanit Perëndimor përfshijnë:

- Objektivin kryesor për të promovuar marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë duhet të reflektohet qartë në projektet e BNK-së.

-Thirrjet për propozime duhet të përqendrohen më shumë në pak çështje prioritare që kanë interes të lartë ndërkufitar.

-Logjika e ndërhyrjes së programeve dhe sistemet e raportimit dhe monitorimit duhet të përmirësohen pasi nuk janë të strukturuara për të vendosur një bazë të qartë për matjen e rezultateve në nivelin rajonal.

-Ekziston nevoja për vazhdimin e aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve për Strukturat Operuese dhe Sekretaritet e Përbashkëta Teknike/Antenat.

-Ekziston nevoja për përmirësimin e sinergjive me politikat dhe donatorët e tjerë, kapitalizimin dhe shkëmbimin e përvojave me instrumentet e tjera të BNK-së (si p.sh. INTERREG (Programi i Bashkëpunimit Ndër-rajonal) dhe Instrumenti Evropian për fshinjësinë (ENI) Programet BNK.

2.2 PËRSHKRIMI DHE ZBATIMI I VEPRIMEVE

Veprimi 1	Operacionet e Bashkëpunimit Ndërkufitar	4,930,000 EURO

Ndihma e parashikuar për Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë do të ndjekë kushtet dhe procedurat e përcaktuara nga masat kufizuese të miratuara në bazë të nenit 215 TFEU[19]

1. Përshkrimi i veprimit, objektivat, rezultatet e pritshme

Përshkrimi i veprimit: Operacionet e Bashkëpunimit Ndërkufitar në rajonin kufitar në fushën e mjedisit; përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutjen, parandalimin dhe menaxhimin e riskut; turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore; konkurrencës; zhvillimit të biznesit dhe NVM-ve, tregtisë dhe investimeve.

Objektivat: Zhvillimi socio-ekonomik dhe forcimi i marrëdhënieve të fqinjësisë në zonën ndërkufitare përmes implementimit të operacioneve të bashkëpunimit ndërkufitar me qëllim:

a) mbrojtjen e mjedisit dhe nxitjen e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutjen, parandalimin dhe menaxhimin e riskut, ndër të tjera, përmes: veprimeve të përbashkëta për mbrojtjen e mjedisit; nxitjes së përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, efiçencës së burimeve, burimeve të energjisë së rinovueshme dhe ndryshimin drejt një ekonomie të sigurt dhe të qëndrueshme me shkallë ndotjeje sa më të ulët; promovimit të investimeve për shmangien e

[19] https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/8442/consolidated-list-sanctions_en

rreziqeve specifike, duke siguruar elasticitet në raste katastrofash dhe zhvillimin e sistemeve të menaxhimit të fatkeqësive, si dhe gatishmërinë në rastet emergjente;

b) inkurajimin e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore;

c) rritjen e konkurrencës; rritjen e mjedisit të biznesit dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme; rritjen e tregtisë dhe investimeve, ndër të tjera, përmes, promovimit dhe mbështetjes së sipërmarrjes, në veçanti ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme; zhvillimin e tregjeve ndërkufitare dhe ndërkombëtarizimin;

Rezultatet e pritshme:

a) Nxitja e ndërgjegjësimit dhe njohurive mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit;

b) Vijimi i bashkëpunimit të ndërsjellë, mirëkuptimit dhe respektimit të trashëgimisë kulturore dhe vlerave;

c) Rritje të mundësive të biznesit për ofruesit e shërbimeve lokale dhe të operatorëve në fushën e turizmit;

d) Rritja e ndërgjegjësimit dhe kapacitetit të NVM-ve dhe fillestarëve për të trokitur në tregje të reja dhe rritja e zinxhirit të vlerave.

Objektivat dhe rezultatet e pritshme do të arrihen gjatë periudhës së zbatimit të këtij programi, nga viti 2014 deri në vitin 2020. Programi i Veprimit BNK 2018-2020 do të kontribuojë në arritjen e objektivave të përgjithshme dhe rezultatet e pritshme të përcaktuara në programin BNK 2014-2020. Për detaje të mëtejshme shihni seksionin 3.2 të programit BNK 2014-2020 (Aneksi 2 i Komisionit zbatues - Vendimi C (2014) 9352 të 10 dhjetor 2014).

2. Supozime dhe kushte

Si një kusht i nevojshëm për menaxhimin efektiv të programit, vendet pjesëmarrëse do të krijojnë një Komitet të Përbashkët Monitorimi dhe të sigurojnë zyrat dhe personelin e përshtatshëm për Sekretariatin e Përbashkët Teknik (që do të krijohet me një Vendim Financimi të veçantë) dhe antenës, në rast se kjo e fundit do të ngrihet.

Dështimi për të përmbushur kërkesat e përcaktuara më sipër mund të çojë në tërheqjen e fondeve të këtij programi dhe/ose ri-alokimin e fondeve në të ardhmen.

Deri më tani, përfituesit janë pajtuar me supozimet dhe kushtet e mësipërme, duke përfshirë krijimin e Sekretariatit të Përbashkët Teknik në Strugë dhe Zyrën e Antenës në Elbasan. Këto struktura financohen plotësisht nga Masa Mbështetëse për Asistencë Teknike për programet e bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet përfituesve të IPA II, në kuadër të Instrumentit për Asistencëm e Para-Aderimit (IPA II) për vitin 2014[20].

Mbështetja e mëtejshme financiare do të programohet nga Komisioni Evropian për vazhdimin e ofrimit të mbështetjes për Sekretariatin e Përbashkët Teknik dhe Zyrën e Antenës nga viti 2019 e në vazhdim. Prandaj do të vendosen marrëveshje të reja me përfituesit që duhet të sigurojnë që kushtet e këtij paragrafi të respektohen më tej.

3. Elementet thelbësore të veprimit

Grant – Thirrje për propozime: 4,930,000 EURO

a) Kriterei thelbësor i pranimit:

Aktivitetet e pranueshme janë përcaktuar në nenin 3.2 të programit BNK 2014-2020, të Shtojcës 2, të Vendimit të Komisionit C (2014) 9674, të datës 11 dhjetor 2014. Lista e mëposhtme është një përmbledhje që tregon veprimet/operacionet kryesore të pranueshme:

-Projektimi, zhvillimi dhe promovimi i produkteve të përbashkëta turistike dhe shërbimeve, si dhe investimet e vogla në infrastrukturën publike të turizmit.

-Trajnimet për nxitjen e aftësive në industrinë e mikpritjes/turizmit.

-Restaurimi/rezervimi, ruajtja, pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore dhe historike si dhe mjedisit rrethues.

-Mbështetja për aktivitete të përbashkëta kulturore.

---

[20] C(2014) 37629

-Ndihma për NVM-të dhe fillestarët në gjetjen e partnerëve të biznesit dhe internacionalizimin e tyre.

-Investimet në tregun e vogël ndërkufitar dhe lehtësirat në tregti.

-Nxitja dhe mbështetja e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit.

-Nxitja e investimeve në infrastrukturën e vogël për elasticitet në rast fatkeqësish dhe mbrojtjen e mjedisit.

Përfituesit duhet të jenë persona juridikë dhe të vendosur në një vend përfitues të IPA II, pjesëmarrës në programin e BNK-së.

Përfitues potencialë mund të jenë autoritetet vendore, njësitë ligjore të menaxhuara nga qeveritë vendore, shoqata të komunave, agjencitë e zhvillimit, organizatat e mbështetjes së bizneseve vendore, faktorët ekonomikë si, NVM-të, organizatat kulturore dhe të turizmit, OJQ-të, organet publike dhe private në mbështetje të fuqisë punëtore, institucionet e trajnimit profesional dhe teknik, organet dhe organizatat për mbrojtjen e natyrës, organet publike përgjegjëse për menaxhimin e ujit, shërbimet e zjarrit/emergjencës, shkollat, kolegjet, universitetet dhe institucionet kërkimore, duke përfshirë institucionet e trajnimit teknik dhe profesional, dhomat e tregtisë, shoqatat e banorëve të vendeve të BNK-së, organizatat e fermerëve, ndërmarrjet publike.

b) Kriteri kryesor i përzgjedhjes është kapaciteti financiar dhe operacional i aplikantit.

c) Kriteret kryesore për dhënien e ndihmës janë rëndësia, efektiviteti dhe fizibiliteti, qëndrueshmëria dhe efektiviteti i kostos së veprimit.

d) Shkalla maksimale e bashkë-financimit nga BE-ja për grante në bazë të thirrjeve është 85% e kostos së veprimit.

e) Shuma treguese e thirrjes/ve: 4,930,000 EURO

Strukturat përgjegjëse mund të vendosin të publikojnë më shumë se një thirrje për propozime. Çdo thirrje për propozime duhet të ketë të njëjtat objektiva, rezultate, kërkesa thelbësore mbi papranueshmërinë, kritere përzgjedhjeje dhe dhënieje, siç përshkruhet më sipër. Secila kontratë granti do të financohet nga një urdhër buxhetor.

f) Datë treguese për publikimin e thirrjes/ve për propozime: Q2 2020 për urdhrin buxhetor të viteve 2018-2020.

3. Buxheti

2018				2019				2020				
	Kontributi i Bashkimit*	**Bashkëfinancimi i Përfituesit/ve të grantit****	**Totali i shpenzimeve**		**Kontributi i Bashkimit**	**Bashkëfinancimi i Përfituesit/ve të grantit**	**Totali i shpenzimeve**		**Kontributi i Bashkimit**	**Bashkëfinancimi i Përfituesit/ve të grantit**	**Totali i shpenzimeve**	**Vendimi i Financimit Total**
Operacionet e BNK-së	1.700.000	300.000	2.000.000	Operacionet e BNK-së	1.700.000	300.000	2.000.000	Operacionet e BNK-së	1.530.000	270.000	1.800.000	4.930.000
në %	85	15	100		85	15	100		85	15	100	
TOTALI 2018	1.700.000	300.000	2.000.000	TOTALI 2019	1.700.000	300.000	2.000.000	TOTALI 2020	1.530.000	270.000	1.800.000	5.800.000

* Kontributi i Bashkimit është llogaritur në raport me shpenzimet e lejuara, të cilat bazohen në totalin e shpenzimeve të pranueshme, duke përfshirë shpenzimet publike dhe private. Shkalla e bashkë-financimit të Bashkimit për çdo prioritet nuk duhet të jetë më pak se 20% dhe jo më e lartë se 85% e shpenzimeve të lejueshme.

**Bashkë-financimi i prioriteteve do të sigurohet nga përfituesit e granteve. Përfituesit e grantit duhet të kontribuojnë me një minimum prej 15% të kostos totale të lejueshme të projekt

4. Zbatimi

4.1 Mënyra e zbatimit dhe Rregullat e përgjithshme për procedurat e prokurimit dhe dhënies së grantit

Menaxhimi i drejtpërdrejtë:

Ky program do të zbatohet me menaxhim të drejtpërdrejtë nga Komisioni/nga delegacionet e Bashkimit në përputhje me nenin 62 (1) (a) të Rregullores Financiare.

5. Marrëveshjet e Monitorimit të Performancës

Si pjesë e kornizës së tij të matjes së performancës, Komisioni do të monitorojë dhe vlerësojë progresin drejt arritjes së objektivave specifike të përcaktuara në Rregulloren e IPA II në bazë të treguesve të paracaktuar, të qartë, të matshëm e transparente. Progres raportet e përmendura në nenin 4 të Rregullores së IPA II do të merren si pikë referimi në vlerësimin e rezultateve të ndihmës IPA II.

Komisioni do të mbledhë nga të gjitha burimet të dhëna mbi performancën (procesin, treguesit e prodhimit dhe rezultateve), të dhëna që do të mblidhen dhe të analizohen në aspektin e matjes së progresit kundrejt objektivave dhe synimeve të përcaktuara për secilin nga veprimet e këtij programi, si dhe në Dokumentin Strategjik Indikativ.

Koordinatorët Kombëtarë të IPA-s (KKIPA-t) do të mbledhin informacion mbi performancën e veprimeve dhe programeve (procesin, treguesit e prodhimit dhe rezultateve) dhe të koordinojë grumbullimin dhe prodhimin e treguesve që vijnë nga burimet kombëtare.

Progresi i përgjithshëm do të monitorohet nëpërmjet mënyrave të mëposhtme: a) Sistem Monitorimi i Orientuar nga Rezultatet (MOR); b) Monitorimi i vetë përfituesve të IPA II; c) Vetë-monitorimi i kryer nga delegacionet e BE-së; d) Monitorimi i përbashkët i Drejtorisë së Përgjithshme të Negociatave të Fqinjësisë dhe Zgjerimit (NEAR) dhe Përfituesit të IPA II, ku pajtueshmëria, koherenca, efektiviteti, efikasiteti dhe koordinimi në zbatimin e ndihmës financiare do të monitorohet rregullisht nga një komision Monitorimi i IPA II, i mbështetur nga Komisioni i Përbashkët i Monitorimit, i cili do të sigurojë një proces monitorimi në nivel programi.

II a. Treguesit e performancës në sektorin [*p.sh. transporti*] që mbulon menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë:

Treguesit[3] për program

Marrëveshja e Financimit /Programi referues[4]	**Treguesi për sektor [*Transporti*]**	**Burimi**	**Linja bazë**	**Objektivi (2017)**	**Objektivi (2020)**	**Vlera (2014[5])**
2014 Programi i vendit	*Reduktimi i kohës mesatare të udhëtimit për udhëtarët ndërmjet qendrave kryesore urbane nga lloji i transportit*					
2014-20xx Programi shumëvjeçar	*Kosto të reduktuara transporti për njësi produkti*					

II b. Përmbledhje në nivel veprimi për sektorin [*p.sh. transportin*]

[3] Ky duhet të jetë kryesisht rezultati, si dhe treguesit përkatës të zgjedhur të produktit

[4] Ai duhet të jetë në përputhje me mënyrën e programimit (vjetore, shumëvjeçare me ose pa detyra të ndara), si dhe me raportin e NAO-s

[5] Numri i kolonave duhet të përshtatet për të gjitha vitet, nga viti 2014 deri në vitin e periudhës së raportimit. Vlerat duhet të jenë kumulative.

Marrëveshja e Financimit /Programi referues	**Veprimi**	**Gjendja / Progresi për një veprim të caktuar (p.sh. po përgatiten Termat e Referencës, tenderi është shpallur, kontraktuar, po zbatohet, është përfunduar)**	**Arritjet kryesore dhe vlerësimi i tyre**	**Probleme të rëndësishme të hasura në zbatimin e detyrave të besuara dhe masat e marra / të planifikuara për kapërcimin e tyre**	**Zhvillimet që ndikojnë në zbatimin në të ardhmen**	**Rekomandime për veprime të mëtejshme korrigjuese**
[2014 Programi i vendit]	*Elektrifikimi i linjës hekurudhore nga xxx në kufi me xxx*	*p.sh. Kontratë shërbimi për përgatitjen e Termave të Referencës për punimet që kontrata është nënshkruar dhe po zbatohet, tender për kontratën e punëve që do të fillojnë tremujorin e dytë të vitit 2015*		*p.sh. Kontrata e shërbimit për përgatitjen e Termave të Referencës për punime që kontrata është vonuar, meqë procedura e negocimit dështoi dhe u nevojit të ribëhej*	*p.sh. ndryshimi i ligjit të vendit, si dhe qasja dhe zbatimi i paketës së katërt të hekurudhave*	

Nën menaxhim të tërthortë duhet të sigurohen dhe Shtojcat e mëposhtme:

Shtojca 1

Përmbledhje mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit (duke përfshirë ndryshimet në strukturën institucionale) (maksimumi një faqe).

Aktivitetet mbi transparencën, vizibilitetin, informacionin dhe komunikimin, në përputhje me FWA-në (maksimumi një faqe)

Shtojca 2

Historitë e suksesshme (Kujdes! Ky seksion mund të përdoret për raportin vjetor të asistencës financiare të përgatitur nga Komisioni Evropian)

Shtojca 3

Plani vjetor i prokurimit

Si për menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe atë të tërthortë, duhet të paraqitet shtojca e mëposhtme:

Shtojca 4

Udhërrëfyes i Qasjes Sektoriale - arritjeve (duke theksuar nëse janë përmbushur apo jo objektivat e planifikuara)

SHTOJCA II – KUSHTET E PËRGJITHSHME

Përmbajtja

SHTOJCA II – KUSHTET E PËRGJITHSHME
Pjesa e parë: Dispozita të përgjithshme
Neni 1 - Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati kontraktues
Neni 2 - Përfituesit e IPA II dhe detyrat e tyre të përbashkëta
Neni 3 - Kërkesat e raportimit
Neni 4 – Vizibiliteti dhe Komunikimi
Neni 5 – Të drejtat e pronësisë intelektuale
Neni 6 - Pranueshmëria e shpenzimeve
Pjesa e dytë: Dispozitat e zbatueshme të menaxhimit të tërthortë
nga përfituesi i IPA II
Neni 7 – Parime të përgjithshme
Neni 8 - Procedurat e dhënies së prokurimit dhe granteve
Neni 9 – Kontrollet paraprake mbi procedurat e granteve dhe prokurimeve dhe kontrollet paraprake të kontratave dhe granteve që do të kryhen nga komisioni
Neni 10 - Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe kostot e njohura
Neni 11 - Dispozita për pagesat e kryera nga Komisioni për përfituesit IPA II që është Autoriteti Kontraktues
Neni 12 - Ndërprerja e pagesave
Neni 13 - Mbulimi i fondeve

Pjesa e tretë: Dispozitat përfundimtare
Neni 14 - Konsultimi mes përfituesve të IPA II dhe Komisionit
Neni 15 - Amendimi i kësaj marrëveshjeje financimi
Neni 16 - Pezullimi i kësaj marrëveshjeje të financimi
Neni 17 - Përfundimi i kësaj marrëveshjeje financiare
Neni 18 – Masat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Pjesa e parë
Dispozita të përgjithshme

Neni 1
Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati kontraktues

1. Periudha e ekzekutimit është periudha gjatë së cilës Marrëveshja e financimit është zbatuar dhe përfshin periudhën operative të zbatimit, si dhe një fazë të mbylljes. Kohëzgjatja e periudhës së ekzekutimit është përcaktuar në nenin 2 (1) të Kushteve të Veçanta, dhe do të fillojë me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Periudha e zbatimit operacional është periudha në të cilën kanë përfunduar të gjitha aktivitetet operative të mbuluara nga prokurimi dhe kontratat e grantit të Programit të Veprimit. Kohëzgjatja e kësaj periudhe është përcaktuar në nenin 2 (2) për Kushtet e Veçanta dhe do të fillojë me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi;

3. Periudha operacionale e zbatimit dhe ekzekutimit duhet të respektohet nga Autoriteti Kontraktues në përmbyllje dhe zbatim të prokurimit dhe kontratave të granteve, në kuadër të kësaj marrëveshjeje financiare.

4. Kostot që lidhen me operacionet e Programit të Veprimit do të jenë të pranueshme për financimin e BE-së vetëm nëse janë shkaktuar gjatë periudhës së zbatimit operativ.

5. Kontratat e grantit dhe të prokurimit do të përfundojnë e shumta brenda tre vjetëve nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes Financiare, përveç:

a) në ndryshimet në kontratat tashmë të lidhura;

b) kur kontratat individuale të prokurimit përfundojnë pas një ndërprerjeje të parakohshme të kontratës ekzistuese të prokurimit;

c) kontratave që lidhen me auditimin dhe vlerësimin, të cilat mund të jenë të nënshkruara pas zbatimit operacional;

d) k u r ndryshimi i entitetit është i ngarkuar me detyra të besuara.

6. Kur një kontratë granti ose prokurimi, nuk ka sjellë asnjë pagesë brenda dy viteve të nënshkrimit të saj, do të ndërpritet automatikisht dhe fondet e saj do të bllokohen.

Neni 2
Përfituesit e IPA II dhe detyrat e tyre të përbashkëta

1. Siç parashikohet në nenin 76 (3) të kuadrit të marrëveshjeve përkatëse, përfituesit e IPA II do të bashkëpunojnë ngushtë dhe duhet të përmbushin bashkërisht në veçanti funksionet e mëposhtme dhe të marrin përsipër përgjegjësitë e mëposhtme:

a) përgatisin programet e bashkëpunimit ndërkufitar në përputhje me nenin 68 të Marrëveshjeve Kuadër përkatëse ose rishikimet e tyre;

b) sigurojnë pjesëmarrjen në Komitetin e Përbashkët të Monitorimit (KPM), mbledhje dhe takime të tjera dypalëshe;

c) emërojnë përfaqësuesin e tyre në KPM;

d) krijojnë Sekretariatin e Përbashkët Teknik (SPT) dhe sigurojnë që ka personel të mjaftueshëm;

e) përgatisin dhe zbatojnë vendimet strategjike te KPM;

f) mbështesin punën e KPM-së dhe sigurojnë informacionin e kërkuar për të kryer detyrat e veta, në veçanti të dhënat që lidhen me ecurinë e programit operativ në arritjen e objektivave specifike dhe synimeve për prioritet tematike, si ngritja e programit të bashkëpunimit ndërkufitar;

g) krijojnë një sistem për të mbledhur informacion të besueshëm mbi zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar;

h) hartojnë raportet vjetore dhe finale te zbatimit siç janë përmendur në nenin 80 të Marrëveshjes Kuadër përkatëse në përputhje me nenin 3;

i) të përgatisin dhe të zbatojnë një plan koherent për komunikim dhe vizibilitet;

j) të hartojnë një plan vjetor të punës për Sekretariatin e Përbashkët Teknik, të miratuar nga KPM.

Neni 3

Kërkesat e raportimit

1. Për qëllimet e kërkesave të raportimit të përcaktuara në nenin 80 (1) të marrëveshjeve përkatëse Kuadër, strukturat operuese do të përdorin modelin e parashikuar në Shtojcën III të kësaj marrëveshjeje financimi.

2. Për qëllim të kërkesave të përgjithshme të raportimit në Komision, të përcaktuar në nenin 58 të Marrëveshjes Kuadër dhe kërkesat specifike të raportimit nën menaxhimin e tërthortë, të përcaktuar në nenin 59 (1) të Marrëveshjes Kuadër përkatëse në raportin vjetor për zbatimin e ndihmës IPA II, NIPAC do të përdorë modelin e dhënë në Shtojcën IIIA të kësaj marrëveshjeje financimi.

3. Për qëllim të kërkesave specifike të raportimit sipas menaxhimit të tërthortë të përcaktuar në pikën (a) të nenit 59 (2) të Marrëveshjes Kuadër mbi raportin vjetor financiar apo deklaratat, NAO si përfitues i IPA II që është Autoriteti Kontraktues do të përdorë modelin e parashikuar në Shtojcën IV të kësaj marrëveshjeje financimi.

4. Për qëllim të nenit 59 (4) të Marrëveshjes Kuadër, NIPAC (KKIPA) si përfitues i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do t'i paraqesë Komisionit një raport përfundimtar mbi zbatimin e ndihmës së IPA II të Programit të Veprimit, jo më vonë se katër muaj pas disbursimit (pagesës) të fundit për kontraktuesit e saj ose përfituesit e granteve.

5. Për qëllim të nenit 59 (6) të Marrëveshjes Kuadër NOA (ZKA) si përfitues i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do të sigurojë deri më datë 15 janar të vitit financiar vijues, në format elektronik, një kopje të të dhënave të mbajtura në sistemin e kontabilitetit, themeluar sipas nenit 10 (5). Kjo duhet të mbështetet nga një raport i nënshkruar i paaudituar përmbledhës financiar, në përputhje me pikën (c) të Shtojcën IV.

Neni 4

Vizibiliteti dhe Komunikimi

1. Siç parashikohet në dispozitat e nenit 24 (1), 76 (3) (k), dhe nenit 78 (8) (f) të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, përfituesit e IPA II duhet të përgatisin një plan koherent të aktiviteteve të vizibilitetit dhe të komunikimit, të cilat do t'i paraqiten Komisionit për një marrëveshje, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Këto aktivitete të vizibilitetit dhe komunikimit duhet të jenë në përputhje me Manualin e Komunikimeve dhe Vizibilitetit për veprimet e jashtme të BE-së, të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni, në fuqi në kohën e aktiviteteve.

Neni 5

Të drejtat e pronësisë intelektuale

1. Kontratat e financuara sipas kësaj marrëveshjeje financiare duhet të garantojnë që përfituesit e IPA II të fitojnë të gjitha të drejtat e nevojshme të pronësisë intelektuale në lidhje me teknologjinë e informacionit, studimet, skicat, planet, publicitetin dhe çdo material tjetër të bërë për qëllime të planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit.

2. Përfituesi IPA II që është Autoriteti kontraktues, do të garantojë që Komisioni, ose dikush apo personi i autorizuar nga Komisioni, dhe përfituesit e të tjerë të IPA II, do të kenë qasje dhe të drejtën për të përdorur një material të tillë. Komisioni do ta përdorë një material të tillë vetëm për qëllimet e veta.

Neni 6

Pranueshmëria e shpenzimeve

1. Shpenzimet e mëposhtme nuk do të jenë të pranueshme për financim sipas kësaj marrëveshjeje financiare:

a) borxhet dhe pagesat e shërbimit të borxhit (interesi);

b) dispozitat për humbje ose detyrime të mundshme në të ardhmen;

c) Kostoja e deklaruar nga përfituesi dhe financuar nga një veprim apo program pune, që merr një grant nga Unioni;

d) humbjet e këmbimit të monedhës;

e) kreditë për palët e treta;

f) gjobat, sanksionet financiare dhe shpenzimet e procesit gjyqësor.

2. Blerja e tokës që nuk është e ndërtuar dhe e tokës me ndërtim në shumën deri në 10% të totalit të shpenzimeve të lejueshme për aktivitetin në fjalë, do të jetë e e pranueshme për financim sipas ndihmës për bashkëpunim ndërkufitar IPA II, nëse ajo është e justifikuar nga natyra e veprimit dhe të dhënat në Shtojcën I.

Pjesa e dytë: Dispozitat e zbatueshme të menaxhimit të tërthortë nga Përfituesi IPA II

Neni 7

Parime të përgjithshme

1. Qëllimi i pjesës së dytë është të vendosë rregullat për zbatimin e Programit të Veprimit nën menaxhimin të tërthortë dhe në veçanti rregullat që lidhen me detyrat që i janë besuar zbatimit të buxhetit, siç përshkruhet në Shtojcën I dhe për të përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e përfituesit të IPA II që është Autoriteti Kontraktues dhe Komisioni në kryerjen e këtyre detyrave.

2. Siç parashikohet në pikën (b) të nenit 76 (3) të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, përfituesit e IPA II, bashkërisht, duhet të përgatisin një marrëveshje dypalëshe dhe të sigurojnë zbatimin e saj.

3. Përfituesi i IPA II që nuk është Autoritet Kontraktues do të bashkëpunojë me përfituesin e IPA II që është Autoritet Kontraktues, për të siguruar se detyrat në vijim janë plotësuar:

a) të kryejnë ndjekjen operative dhe menaxhimin e operacioneve, siç parashikohet në pikën (b) të nenit 76 (4) të Marrëveshjes Kuadër;

b) të kryejnë verifikime në përputhje me nenin 76 (5) të Marrëveshjes Kuadër;

c) të mbrojnë interesin financiar të Unionit, siç parashikohet në nenin 51 të Marrëveshjes Kuadër.

Neni 8

Procedurat e dhënies së prokurimit dhe granteve

1. Detyrat e përmendura në nenin 7 (3) duhet të kryhen nga përfituesi i IPA II që është Autoritet Kontraktues, në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për dhënien e prokurimit dhe kontratave të granteve, në veprimet e jashtme, në fuqi në kohën e fillimit të procedurës në fjalë (PRAG), si dhe në përputhje me standardet e kërkuara të Vizibilitetit dhe Komunikimit, të përmendura në nenin 4 (2).

2. Në përputhje me nenin 18 (2) të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni do të pajisë përfituesin e IPA-II që është Autoritet Kontraktues, me udhëzime të mëtejshme, për përshtatjen e procedurave dhe dokumenteve standard, të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për dhënien e kontratave të prokurimit dhe granteve në veprimet e jashtme, në rastin specifik të bashkëpunimit ndërkufitar.

3. Përfituesi IPA II që është Autoritet Kontraktues do të kryejë procedurat e prokurimit dhe dhënies së grantit, të lidhë kontratat që pasojnë dhe të sigurojë që të gjitha dokumentet përkatëse për gjurmët e auditimit janë në gjuhën e kësaj marrëveshjeje financimi.

4. Përfituesit e IPA II do të bashkëpunojnë plotësisht në vendosjen e komisioneve të vlerësimit, siç parashikohet në pikën (a) të nenit 76 (4) të Marrëveshjes përkatëse Kuadër.

5. Përfituesi i IPA II, që është Autoritet Kontraktues, do të mbajë të gjitha dokumentet ndihmëse financiare dhe kontraktuale përkatëse, nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financiare ose nga një datë më e hershme, në rast se procedurat e prokurimit, thirrjet për propozime ose procedurat e dhënies së granteve të drejtpërdrejta kanë nisur para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje të Financimit:

a) Për procedurat e prokurimit në veçanti:

a) Njoftim i mëparshëm me dëshminë e publikimit të njoftimit të prokurimit dhe të çdo korrigjimi;

b) Caktimi i panelit të zgjedhur;

c) Raporti i listës së të përzgjedhurve (përfshirë anekset) dhe aplikimet;

d) Dëshmi e publikimit të njoftimit të listës së përzgjedhurve

e) Letra e kandidatëve që nuk janë përzgjedhur;

f) Ftesë për tender ose ekuivalentin e saj;

g) Dosja e tenderit, duke përfshirë anekset, sqarimet, procesverbalet e mbledhjeve, dëshmitë e publikimit;

h) Caktimi i komisionit të vlerësimit;

i) Raporti për hapjen e tenderave, duke përfshirë anekset;

j) Raporti i vlerësimit / negocimit, duke përfshirë anekset dhe ofertat e pranuara;[21]

k) Letra e lajmërimit;

l) Shkresë për dorëzimin e kontratës;

m) Letrat për kandidatët pasuksesshëm;

n) Çmimi /njoftimi i anulimit, duke përfshirë edhe dëshminë e publikimit;

o) Kontratat e nënshkruara, ndryshimet, dispozitat shtesë, raportet e zbatimit, dhe korrespondenca përkatëse.

b) Për thirrjet për propozime dhe dhënien e drejtpërdrejtë të granteve në veçanti:

a) Emërimi i komisionit të vlerësimit;

b) Raporti i hapjes dhe raporti administrativ, duke përfshirë shtojcat dhe aplikimet e marra[22];

c) Letrat për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm, pas vlerësimit të koncept idesë;

d) Raporti i vlerësimit të hartimit të shënimit;

---

[21] Eliminimi i ofertave të pa-suksesshme pesë vjet pas mbylljes së procedurës së prokurimit.

e) Raporti i vlerësimit të aplikimit të plotë, ose raporti i negocimit me shtojcat përkatëse;

f) Kontrolli i pranueshmërisë dhe dokumentet e tjera shoqëruese;

g) Letrat për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm me listën e aprovuar rezervë, pas vlerësimit të plotë të aplikimit;

h) Shkresa për dorëzimin e kontratës së grantit;

i) Dhënia / njoftimi i anulimit, me dëshmi të publikimit;

j) Kontratat e nënshkruara, ndryshimet, dispozitat shtesë dhe korrespondencat përkatëse.

Përveç kësaj, dokumentet financiare dhe kontraktuale përmendur në paragrafin 5 (a) dhe (b) të këtij neni, do të plotësohet nga të gjitha dokumentet e tjera shoqëruese përkatëse siç kërkohen nga procedurat e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe të gjithë dokumentacionin përkatës në lidhje me pagesat, rikuperimin dhe shpenzimet operative, për shembull raportet e projektit dhe raportet e kontrolleve të vendeve, pranimi i furnizimeve dhe punëve, sigurimet dhe garancitë, raportet e inxhinierëve të mbikëqyrjes. Të gjitha dokumentet përkatëse financiare dhe kontraktuale do të mbahen për të njëjtën kohëzgjatje, në përputhje me nenin 49 të Marrëveshjes Kuadër.

Neni 8a

Detyrimi për të informuar, sanksionet administrative dhe mosveprimi

1. Gjatë zbatimit të procedurave dhe dokumenteve standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për dhënien e kontratave të prokurimit dhe grantit, përfituesi i IPA II do të sigurojë që asnjë kontratë e prokurimit ose grantit të financuar nga BE nuk i jepet një operatori ekonomik ose aplikanti për grante, nëse operatori ekonomik ose kërkuesi i grantit, nëse ai personalisht ose një person me kompetenca të përfaqësimit, vendimmarrjes ose kontrollit mbi të, ndodhet në një nga situatat e përjashtimit të parashikuara në procedurat përkatëse dhe dokumentet standarde të Komisionit.

2. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues do të informojë Komisionin, kur një kandidat, ofertues ose aplikant ndodhet në një situatë përjashtimi nga pjesëmarrja në procedurat e dhënies së prokurimit dhe grantit, ka kryer parregullsi dhe mashtrime ose është konstatuar në shkelje të rëndë të detyrimeve të tij kontraktuale.

3. Përfituesi IPA II që është Autoritet Kontraktues, do të marrë parasysh informacionin përfshirë në Sistemin e Zbulimit të Parakohshëm dhe të Përjashtimit (EDES), gjatë dhënies së kontratave të prokurimit dhe granteve. Aksesi në informacione mund të sigurohet përmes pikës(ve) së ndërlidhjes ose nëpërmjet konsultimeve me mënyrat e mëposhtme: (Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Buxhetin, nëpunësi i kontabilitetit të Komisionit, BRE2-13/505, B-1049 Bruksel, Belgjikë dhe me email: BUDG-C01-EXCL-DB@ec.europa.eu bashkë me adresën e Komisionit, të identifikuar në nenin 3 të Kushteve të veçanta).

4. Kur përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, është në dijeni për një situatë përjashtimi në zbatimin e detyrave të përshkruara në Shtojcën I, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do ti vendosë një operatori ekonomik ose aplikuesi granti përjashtim nga prokurimet e saj të ardhshme ose procedurat e dhënies së granteve. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, gjithashtu mund të vendosë një penalitet financiar proporcional me vlerën e kontratës në fjalë. Përjashtimet dhe/ose penalitetet financiare do të vendosen pas një procedure për gjetjen dhe paraqitje e provave që siguron të drejtën e mbrojtjes së personit në fjalë. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, njofton Komisionin në përputhje me paragrafin 1 të këtij Neni.

5. Në lidhje me paragrafin 4 të këtij neni, përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, merr përsipër mosveprimin, nëse nuk vendos përjashtim dhe/ose një penalitet financiar ndaj operatorit ekonomik ose kërkuesit të grantit.

6. Në rastin e mosveprimit, përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, duhet të njoftojë Komisionin për të shpjeguar arsyet për mosveprimin e tij. Komisioni rezervon të drejtën për të përjashtuar një operator ekonomik ose një aplikues granti nga procedurat e ardhshme të financimit të BE-së dhe/ose të vendosë një penalitet financiar ndaj operatorit ekonomik ose kërkuesit të grantit ndërmjet 2% dhe 10% të vlerës totale të kontratës në fjalë.

Neni 9

Kontrollet paraprake mbi procedurat e granteve dhe prokurimeve dhe kontrollet paraprake të kontratave dhe granteve që do të kryhen nga Komisioni

1. Komisioni mund të ushtrojë kontrolle paraprake (ex ante) për tenderimin e kontratave, hapjen e thirrjeve për propozime dhe dhënien e kontratave dhe granteve për fazat e mëposhtme të prokurimit ose dhënies së granteve:

a) për miratimin e njoftimeve të kontratës për prokurim, programet e punës për thirrjet për propozime dhe çdo korrigjim të tij;

b) për miratimin e dosjeve të tenderit dhe udhëzimeve për aplikantët për grante;

c) për miratimin e përbërjes së komisioneve të vlerësimit;

d) për miratimin e raporteve të vlerësimit dhe vendimet e dhënies së kontratës[23];

e) për miratimin e dosjeve të kontratës dhe shtesën e kontratës.

2. Lidhur me kontrollin paraprak, komisioni duhet të vendosë:

a) të kryejë kontrolle paraprake për të gjitha dosjet ose

b) të kryejë kontrolle paraprake në përzgjedhjen e këtyre dosjeve ose

c) të heqë dorë plotësisht nga kontrollet paraprake.

3. Nëse Komisioni vendos për të kryer kontrolle paraprake në përputhje me paragrafin 2, shkronjat (a) ose (b) të këtij neni, ai duhet të informojë përfituesin e IPA II që është Autoriteti Kontraktues i dosjeve të përzgjedhura, në lidhje me kontrollet paraprake. Ky përfitues i IPA II do të japë të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për Komisionin, pasi të informohet se një dosje është përzgjedhur për kontroll paraprak maksimumi në kohën e dorëzimit të njoftimit të kontratës ose programit të punës për publikim.

4. Komisioni mund të vendosë për të kryer kontrolle të mëpasshme (ex-post), duke përfshirë auditimet dhe kontrollet në vend, në çdo kohë, për ndonjë kontratë ose grantet e dhëna nga përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues që rrjedhin nga kjo marrëveshje financimi. Ky përfitues i IPA II do të të vërë në dispozicion të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për Komisionin, pasi të informohet se kjo dosje është përzgjedhur për kontroll të mëpasshëm (ex post). Komisioni mund të autorizojë një person ose njësi ekonomike për të kryer kontrolle ex post në emër të tij.

Neni 10

Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe kostoja e njohur

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi, Fondi Kombëtar dhe struktura operative e përfituesit të IPA II që është Autoriteti Kontraktues për Programin e Veprimit, duhet të hapë të paktën një llogari bankare në Euro. Bilanci i përgjithshëm bankar për Programin e Veprimit do të jetë shuma e bilanceve në të gjitha llogaritë bankare të Programit të Veprimit, të mbajtura nga Fondi Kombëtar dhe të gjitha strukturat pjesëmarrëse që operojnë tek përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues.

2. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do të përgatisë dhe dorëzojë në Komision planet e parashikimit të disbursimit për kohëzgjatjen e periudhës së zbatimit të Programit të Veprimit. Këto parashikime duhet të përditësohen për raportin vjetor financiar të

[23] Për kontratat e shërbimit këto hapa përfshijnë kontrollet paraprake në lidhje me miratimin e listës së përzgjedhur.

përmendur në nenin 3 (2) dhe për çdo kërkesë për fonde. Parashikimet do të bazohen në një analizë të dokumentuar dhe të detajuar (duke përfshirë edhe kontraktimin e planifikuar dhe orarin e pagesave sipas kontratës për dymbëdhjetë muajt në vijim), të cilat do të jenë në dispozicion të Komisionit në bazë të kërkesës.

3. Plani fillestar i parashikimit të disbursimit duhet të përmbajë përmbledhjen e parashikimit vjetorë të disbursimit për të gjithë periudhën e zbatimit dhe parashikimet mujore të disbursimit për dymbëdhjetë muajt e parë të Programit të Veprimit. Planet e mëvonshme duhet të përmbajnë përmbledhjen vjetore të parashikimeve të disbursimit për bilancin e periudhës së zbatimit të Programit të Veprimit dhe parashikimet mujore të disbursimit për katërmbëdhjetë muajt në vijim.

4. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, është i detyruar të krijojë dhe mirëmbajë një sistem të kontabilitetit në përputhje me pikën 2 (3) (b) të Shtojcës A të Marrëveshjes Kuadër, i cili do të mbajë të paktën informacionin për kontratat që menaxhohen nën Programin e Veprimit të treguar në Shtojcën V.

5. Kostoja e njohur në sistemin e kontabilitetit e mbajtur nën seksionin 4 të këtij neni, duhet të jetë kryer, paguar dhe pranuar dhe të korrespondojë me kostot aktuale të provuara nga dokumentet mbështetëse dhe të përdoret kur është e përshtatshme, për të nisur para-financimin e paguar nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues sipas kontratave lokale.

6. Kostoja e njohur në sistemin e kontabilitetit do të shfrytëzohet nga Komisioni për njohjen e përkohshme të kostos së saj, gjatë zbatimit të Programit të Veprimit (duke përfshirë autorizimin e para-financimit që i paguhet përfituesit të IPA II, i cili është Autoriteti Kontraktues) për procesin e miratimit për pagesat, autorizimin përfundimtar të procedurës së llogarive në fund të Programit të Veprimit, praktikat vjetore të ndërprera dhe çdo zbatim tjetër të menaxhimit dhe të shqyrtimeve të performancës.

7. Përfituesi i IPA-II që është Autoriteti Kontraktues, do t'i sigurojë Komisionit raportet në vijim:

a) Raportin Përmbledhës - siç është përcaktuar në nenin 3 (5);

b) Raportet vjetore siç janë përcaktuar në paragrafët (2) deri (4) të nenit 3;

c) Kërkesa për raportet e fondeve, siç përmenden në nenin 11.

Neni 11

Dispozita për pagesat e kryera nga Komisioni për përfituesit IPA II që është Autoriteti Kontraktues

1. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, duhet të paraqesë parashikimin e tij fillestar të disbursimit (pagesës) për Programin e Veprimit, të përgatitur në përputhje me nenin 10 (2), me kërkesën e parë për pagesë të para-financuar. Pagesa e parë e para-financimit do të bëhet për 100% të pagesës së parashikuar për vitin e parë të planit të parashikuar për disbursim.

2. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do të paraqesë kërkesa të vazhdueshme të pagesës së para-financimit kur bilanci i përgjithshëm bankar për Programin e Veprimit përfshihet nën pagesën e parashikuar për pesë muajt në vazhdim të Programit të Veprimit.

3. Çdo kërkesë për para-financim shtesë do të mbështetet nga dokumentet e mëposhtme:

a) Një deklaratë përmbledhëse të të gjitha pagesave të kryera për Programin e Veprimit;

b) Balancat bankare për Programin e Veprimit në datën e përcaktuar të kërkesës;

c) Një parashikim të pagesave për Programin e Veprimit për katërmbëdhjetë muajt në vazhdim në datën e përcaktuar të kërkesës nw pwrputhje me Shtojcwn IV pika(d).

4. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, mund të kërkojë për çdo para-financim pasues, shumën e totalit të disbursimeve të parashikimit për katërmbëdhjetë muaj, pas datës së përcaktuar të kërkesës, pa balancat e referuara në nenin 3 (b) të këtij neni në datën e përcaktuar të kërkesës për fondet e rritura nga ndonjë shumë e financuar nga përfituesi IPA II sipas paragrafit 5 të këtij neni dhe që nuk është rimbursuar ende.

Komisioni gëzon të drejtën për të reduktuar çdo pagesë pasuese të para-financimit, nëse tepricat totale bankare të mbajtura nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues në bazë të këtij programi dhe në të gjitha programet e tjera të IPA I apo IPA II që menaxhohen nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, tejkalon parashikimin e disbursimit për katërmbëdhjetë muajt e ardhshëm.

5. Në rastet kur pagesa është reduktuar sipas paragrafit 4 të këtij neni, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, duhet ta financojë programin nga burimet e veta, deri në shumën e reduktimit. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti kontraktues, më pas mund të kërkojë rimbursimin e këtij financimi, si pjesë e kërkesës së ardhshme për fonde të përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni.

6. Komisioni ka të drejtë për të rikuperuar balancat e tepërta bankare, të cilat kanë mbetur të papërdorura për më shumë se dymbëdhjetë muaj. Para se të ushtrojë këtë të drejtë, Komisioni e fton përfituesin e IPA II që është Autoriteti Kontraktues, për të dhënë arsyet e vonesës në disbursimin e fondeve dhe të demonstrojë nevojën për to në vazhdim gjatë dy muajve të ardhshëm.

7. Interesi i gjeneruar nga llogaritë bankare të përdorura për këtë Program nuk njihet nga Komisioni.

8. Sipas Nenit 33 (4) të Marrëveshjes Kuadër, kur ndërprerja e afatit për kërkesën për pagesë tejkalon dy muaj, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë një vendim nga Komisioni, nëse ndërprerja e afatit duhet vazhdojë.

9. Pasqyra financiare përfundimtare e përmendur në nenin 37 (2) të Marrëveshjes Kuadër do të dorëzohet nga ZKA jo më vonë se 16 muaj pas përfundimit të periudhës së zbatimit operacional.

Neni 12

Ndërprerja e pagesave

1. Pa cenuar pezullimin ose përfundimin e kësaj Marrëveshjeje financimi sipas përkatësisht neneve 16 dhe 17 dhe përveç nenit 39 të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni mund të ndërpresë pagesat pjesërisht ose plotësisht, në qoftë se:

a) Komisioni ka vendosur ose paraqet shqetësime serioze, pasi përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues ka bërë gabime të konsiderueshme, ka parregullsi apo mashtrime që vënë në dyshim ligjshmërinë ose rregullsinë e transaksioneve në fjalë, në implementimin e Programit të Veprimit, ose nuk ka përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj marrëveshjeje financiare;

b) Komisioni ka vendosur ose paraqet shqetësime serioze, nëse përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues ka kryer gabime sistemike ose të përsëritura, ose ka parregullsi, mashtrime apo shkelje të detyrimeve në këtë ose në të tjera marrëveshje financimi, me kusht që ato gabime, parregullsi, mashtrime, ose shkelje të detyrimeve të kenë ndikim material në zbatimin e kësaj marrëveshjeje financiare apo vënë në dyshim besueshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të përfituesit të IPA II ose ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve bazë;

Neni 13

Kthimi i fondeve

1. Përveç rasteve të përmendura në nenin 41 të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni mund të rimarrë fondet nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, siç parashikohet në rregulloren financiare, veçanërisht në rast se:

a) Komisioni vendos se objektivat e Programit të Veprimit të përcaktuara në Shtojcën I nuk janë arritur;

b) shpenzimet janë të papërshtatshme;

c) shpenzimet janë shkaktuar si rezultat i gabimeve, parregullsive, mashtrimeve apo shkeljeve të detyrimeve në zbatimin e Programit të Veprimit, në veçanti në procedurën e prokurimit dhe dhënies së granteve.

2. Në përputhje me ligjin kombëtar, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues do të rimarrë kontributin e Unionit që i paguhet përfituesit të IPA II, i cili është Autoriteti Kontraktues nga marrësit të cilët ndodhen në një prej situatave të përcaktuara në paragrafin 1 pika b) ose c) të këtij neni ose të referuara në nenin 41 të Marrëveshjes Kuadër. Fakti se përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues nuk ka sukses në kthimin e të gjithë ose një pjese të fondeve nuk do ta pengojë Komisionin për rikuperimin e fondeve nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues.

3. Përfituesi i IPA II që nuk është Autoriteti Kontraktues, do të bëjë përpjekje maksimale për të mbështetur përfituesin e IPA-II që është Autoriteti Kontraktues, në rimëkëmbjen e saj, kur përfituesi vendoset në territorin e tij. Marrëveshja për rikuperimin do të parashikohet në një marrëveshje dypalëshe që do të lidhet në përputhje me nenin 69 të Marrëveshjeve Kuadër përkatëse.

4. Shumat e paguara padrejtësisht apo të mbuluara nga përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, shumat e garancive financiare, performancës dhe para-financimit, të paraqitura në bazë të prokurimit dhe dhënies së procedurave të granteve, shumat nga gjobat e vendosura nga përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues për kandidatët, ofertuesit, aplikantët, kontraktuesit ose përfituesit e granteve, të paguara për përfituesit e IPA II që është Autoriteti Kontraktues, ose do të ri-përdoren për Programin e Veprimit, ose do t'i kthehen Komisionit.

Pjesa e tretë: Dispozitat përfundimtare

Neni 14
Konsultime ndërmjet përfituesve të IPA II dhe Komisionit

1. Përfituesit e IPA II dhe Komisioni do të konsultohen me njëri tjetrin para se të krijojnë mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin ose interpretimin e mëtejshëm të kësaj Marrëveshjeje Financimi, në përputhje me nenin 18 të këtyre Kushteve të Përgjithshme.

2. Kur Komisioni vihet në dijeni për problemet në kryerjen e procedurave që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshje Financimi, ai duhet të krijojë të gjitha kontaktet e nevojshme me përfituesit e IPA II për të korrigjuar situatën dhe ndërmarrë hapat e nevojshëm.

3. Konsultimi mund të çojë në një ndryshim, në pezullimin ose përfundimin e kësaj marrëveshjeje financimi.

4. Komisioni do të informojë rregullisht përfituesit e IPA II për zbatimin e aktiviteteve të përshkruara në Shtojcën I, të cilat nuk përfshihen në Pjesën e Dytë të këtyre Kushteve të Përgjithshme.

Neni 15
Ndryshimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Çdo ndryshim i kësaj marrëveshjeje financiare duhet të bëhet me shkrim, duke përfshirë dhe shkëmbimin e shkresave.

2. Nëse përfituesit e IPA II, kërkojnë një amendament, kërkesa duhet t'i paraqitet bashkërisht Komisionit të paktën gjashtë muaj para se ndryshimi që kërkohet të hyjë në fuqi.

3. Komisioni mund të amendojë *Dokumentet Model* në Shtojcën III, IIIA, IV dhe V, pa nevojën e një amendamenti të kësaj marrëveshjeje financiare. Përfituesit e IPA II do të informohen me shkrim për çdo amendament të tillë dhe për hyrjen e tij në fuqi.

Neni 16

Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje financiare mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) Nëse ndonjë përfitues IPA II shkel një detyrim sipas kësaj marrëveshjeje financiare.

b) Nëse përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues shkel ndonjë detyrim të përcaktuar në bazë të procedurave dhe dokumenteve standarde të përmendura në nenin 18 (2) të Marrëveshjes përkatëse Kuadër, pa cenuar dispozitat në nenin 8 (2).

c) Nëse përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, nuk i plotëson kërkesat për zbatimin e detyrave të besuara të buxhetit.

d) Nëse përfituesit e IPA II nuk i përmbushin bashkërisht funksionet dhe përgjegjësitë e përmendura në Nenin 2 (1) dhe kur është e mundur edhe menaxhimin e tërthortë sipas Nenit 7(3).

e) Nëse ndonjë përfitues i IPA II vendos të pezullojë ose ndërpresë procesin e pranimit të anëtarësimit në BE.

f) Nëse ndonjë përfitues i IPA II shkel një detyrim në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, parimet demokratike dhe sundimin e ligjit, si dhe në raste të rënda të korrupsionit ose nëse përfituesi IPA II është fajtor për sjellje të rëndë profesionale të provuar me ndonjë mënyrë të justifikuar. Shkelje e rëndë profesionale nënkupton një nga sa më poshtë:

- shkelje e ligjeve ose rregulloreve në fuqi ose e standardeve etike të profesionit të cilit i përket një person ose subjekt, ose

- çdo sjellje e gabuar e një personi ose subjekti që ka ndikim në kredibilitetin e tij profesional, kur sjellja e tillë nënkupton qëllimin e gabuar ose neglizhencën e rëndë.

g) Në rastet e forcës madhore, siç përcaktohet më poshtë. "Forcë Madhore" do të thotë çdo situatë e paparashikueshme dhe e jashtëzakonshme ose ngjarje përtej kontrollit të palëve, e cila pengon secilën prej tyre në përmbushjen e ndonjë prej detyrimeve të tyre, gjë që nuk i atribuohet gabimit ose neglizhencës nga ana e tyre (ose pjesës së kontraktuesve të tyre, agjentëve ose të punësuarve) dhe vërteton pakapërcyeshmërinë e situatës, pavarësisht se janë bërë përpjekjet e duhura. Defektet në pajisje ose materiale, ose vonesat e tyre të mundshme, mosmarrëveshjet e punës, grevat ose vështirësitë financiare nuk mund të përdoren si forcë madhore. Një palë nuk duhet të konsiderohet si shkelëse e detyrimeve të saj, nëse është penguar nga përmbushja e tyre për shkak të një force madhore për të cilën pala tjetër është informuar siç duhet. Një palë që përballet me një forcë madhore duhet ta informojë palën tjetër pa vonesë, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikueshme të problemit, dhe të marrë çdo masë për të minimizuar dëmet e mundshme.

Asnjëra prej palëve nuk do të konsiderohet përgjegjëse për shkelje të detyrimeve të veta sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare, nëse është penguar nga përmbushja e tyre nga forca madhore, me kusht që ajo palë të marrë masa për të minimizuar dëmtimet e mundshme.

2. Komisioni mund ta pezullojë këtë Marrëveshje Financimi pa njoftim paraprak.

3. Komisioni mund të marrë masat e duhura parandaluese para se të bëhet pezullimi.

4. Kur pezullimi është njoftuar, duhet të tregohen pasojat e prokurimit dhe kontratave të granteve në vazhdim dhe marrëveshjet e delegacionit për këto kontrata, si dhe marrëveshjet që duhen nënshkruar për këto kontrata.

5. Pezullimi i kësaj marrëveshjeje financimi nuk e cenon ndërprerjen e kësaj marrëveshjeje financimi nga Komisioni, në përputhje me nenin 17.

6. Palët do të rifillojnë zbatimin e Marrëveshjes Financiare sapo kushtet ta lejojnë, me miratimin paraprak me shkrim të Komisionit. Kjo nuk cenon asnjë amendim të kësaj marrëveshjeje financiare që mund të jenë të nevojshme për të përshtatur Programin e Veprimit me kushtet e reja zbatuese, duke përfshirë, nëse është e mundur, zgjatjen e periudhës së zbatimit ose përfundimin e kësaj marrëveshjeje financiare në përputhje me nenin 17.

Neni 17
Përfundimi i kësaj marrëveshjeje financimi

1. Nëse çështjet të cilat çuan në pezullimin e Marrëveshjes së Financimit nuk janë zgjidhur brenda një periudhe maksimale 180 ditore, secila palë mund ta përfundojë Marrëveshjen Financiare me njoftim 30 ditë para.
2. Kur ndërprerja është njoftuar, duhet të tregohen pasoja e prokurimeve dhe kontratave të granteve në vazhdim dhe kontratat ose grantet e tilla që duhen nënshkruar.
3. Përfundimi i kësaj marrëveshjeje financiare nuk do të përjashtojë mundësinë e Komisionit që të kryejë korrigjime financiare në përputhje me nenet 43 dhe 44 të Marrëveshjes Kuadër.

Neni 18
Rregullimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me Marrëveshjen e Financimit që nuk mund të zgjidhet brenda një periudhe gjashtëmujore nga konsultimet midis palëve, të parashikuar në nenin 14, mund të zgjidhet nga arbitrazhi me kërkesën e njërës prej palëve.
2. Secila palë do të caktojë një gjyqtar brenda 30 ditëve nga data e kërkesës për arbitrazh. Nëse kjo nuk arrihet, secila palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit (Hagë) të caktojë një gjyqtar të dytë. Të dy gjyqtarët, nga ana e tyre, caktojnë një gjyqtar të tretë brenda 30 ditëve. Nëse kjo nuk arrihet, secila palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit të caktojë gjyqtarin e tretë.
3. Përveç kur arbitrat vendosin ndryshe, do të zbatohen procedurat e parashikuara në Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit, rregullat opsionale për Arbitrazhin që përfshijnë organizatat ndërkombëtare dhe shtetet. Vendimet e arbitrave merren me shumicë brenda një periudhe tremujore.
4. Secila palë do të jetë e detyruar të marrë masat e nevojshme për zbatimin e vendimit të gjyqtarëve.



MODEL

Raporti Vjetor i Zbatimit: <Viti>

Bashkëpunimi Ndër-kufitar ndërmjet përfituesve të vendeve IPA II

(Neni 80 i Marrëveshjes Kuadër)

Tabela e Përmbajtjes

Fjalori i Akronimeve
Identifikimi
Pasqyrë e zbatimit të programit ndërkufitar
Analiza e progresit dhe arritjeve
Progresi i bërë në zbatimin e programit ndërkufitar
Analiza sasiore
Analiza cilësore

Informacion i detajuar mbi ekzekutimin financiar të programit ndërkufitar
Informacion mbi hapat e ndërmarrë nga struktura operuese dhe/ose nga komiteti përbashkët i monitorimit për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit
Monitorimi dhe vlerësimi
Problemet e hasura dhe veprimet korigjuese
Vizibiliteti dhe publiciteti
Përdorimi i asistencës teknike
Ndryshimet në kontekstin e zbatimit të programit ndërkufitar
Ndërveprimet me sektorët e tjerë, politikat apo instrumentet
Historitë e suksesit

Fjalori i akronimeve
<…>

I. Identifikimi

PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR	Titulli i Programit: Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar <vendi A> – < vendi B>
	<Përfitimet/alokimet për vitin 20XX-20XX: <shuma, duke përfshirë Kontratën e Shërbimit të Asistencës Teknike (K.SH.A.T.) >
RAPORTI VJETOR MBI ZBATIMIN	Viti i Raportimit <nga 1 janari 20XX deri më 31 dhjetor 20XX >
	Përgatitur nga: <struktura operuese, vendi X> < struktura operuese, vendi Y>
	Data e shqyrtimit të raportit vjetor nga Komiteti i Përbashkët Monitorues: <data dhe lloji i procedurës së miratimit, p.sh. mbledhje apo me shkrim>
	Zona e lejueshme e Programit: <.....>

Baza ligjore: Neni 80 i Marrëveshjes Kuadër IPA II

2. Përmbledhje e zbatimit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar
2.1 Arritjet dhe analiza e progresit

<Përmbledhje e zbatimit të programit gjatë periudhës së mbuluar, të tilla si:

1. Progresi me thirrjet për propozime:
- Numri i thirrjeve të planifikuara për tu shpallur deri në fund të periudhës së programimit dhe kalendari i tyre;
- Situata e thirrjeve për propozime (numri i thirrjeve për propozime të hapura dhe në cilën datë, numri i thirrjeve për propozime të mbyllura dhe në cilën datë, kohëzgjatja e procesit të vlerësimit - kohëzgjatja totale dhe për secilin hap etj);

- Analiza e procesit të vlerësimit (numri i aplikimeve të marra sipas llojit të përfituesit dhe vendit, numri i aplikimeve të refuzuara në secilën fazë të procesit të vlerësimit, arsyet më të zakonshme të refuzimit, lista e aplikimeve të refuzuara (shihni modelin e tabelës më poshtë);
- Lista e kontratave të nënshkruara (shihni modelin e tabelës më poshtë)
- Eventet e organizuara për ngritjen e kapaciteteve për aplikantët e ardhshëm dhe për përfituesit e granteve (numri i eventeve, numri i pjesëmarrësve sipas llojit të eventit për secilin vend, numri i kërkesave për informacion nga përfituesit e granteve të adresuara, etj).
- Numri i takimeve të mbajtura dhe rezultateve të stafit të sekretariatit të përbashkët teknik dhe strukturave operuese; numri i takimeve të komitetit të përbashkët të monitorimit dhe rezultatet; numri i takimeve të strukturave operuese dhe rezultatet.>.

2. Progresi me projektet strategjike;

< N.q.s. është e zbatueshme, duke përfshirë gjithashtu informacion mbi rishikimin e programit 2014 -2020 ose mbi programimin e 2021- 2027.>

< Modeli i tabelës për kontratat BNK të nënshkruara dhe në zbatim gjatë periudhës raportuese:

Tabela nr. : XX> Lista e aplikimeve ndërkufitare të marra – të miratuara/ të refuzuara

Numri i thirrjes për propozime	Prioriteti tematik	Titulli	Emri, lloji dhe vendi i origjinës i koordinatorit dhe partnerëve të përfshirë	Shuma e kërkuar e grantit të BE-së	Kontrolli administrativ (PO/JO)	Vlerësimi teknik (PO/JO)	E miratuar (PO/JO)	Arsyet e refuzimit

Tabela nr. : XX> Lista e kontratave të nënshkruara ndërkufitare dhe nën zbatim

Prioriteti tematik: <...>						
Titulli dhe numri i kontratave	Emri, lloji dhe vendi i origjinës së koordinatorit dhe partnerëve të përfshirë	Informacioni shkurtër i projektit	Data e fillimit dhe mbarimit	Kostoja totale e lejueshme dhe vlera e grantit të BE-së	Arritjet kryesore deri më sot	Komente >

2.2 Progresi i realizuar gjatë zbatimit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar

<Prezantim shumë i shkurtër i prioriteteve tematike dhe objektivave specifike të Programit BNK, së bashku me një përmbledhje të progresit të bërë në zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar dhe në veçanti të arritjeve lidhur me objektivat specifike për çdo prioritet tematik (si edhe për prioritetin e AT-së), duke përfshirë elemente cilësore dhe sasiore, të cilat do të tregojnë progresin e realizuar lidhur me objektivat>.

2.2.1 Analiza sasiore

<Informacion mbi progresin e realizuar gjatë zbatimit të programit, duke pasqyruar dhe të dhëna sasiore, kur është e mundur, si dhe duke përdorur objektivat dhe indikatorët e përfshirë në program dhe në projekte.

Analiza e arritjeve të matura nga produktet, rezultatet dhe ndikimi, si dhe treguesit fizikë dhe financiarë. Treguesit do të ndahen sipas gjinisë, kur është e mundur.

Nëse shifrat (të dhënat) nuk janë ende të disponueshme, duhet siguruar informacion se kur do të jenë të disponueshme dhe kur do të përfshihen në raportin vjetor të zbatimit. Përveç kësaj, informacioni mund të paraqitet grafikisht.

<Modeli i tabelës së indikatorëve (rezultate, produkte dhe ndikimi), me një shembull për secilin prioritet të programit, objektivi specifik dhe rezultati:

Tabela nr.:XX Të dhënat e grumbulluara në nivel programi, bazuar në informacionin e mbledhur prej projekteve

Prioriteti tematik <…> **Objektivi specifik <…>** **Rezultati <…>**											
Emri dhe tipi[24]	Përkufizimi	Baza		Arritjet				Synimi		Burimi i të dhënave	Mbledhja e të dhënave dhe shpeshtësia
		Vlera	Viti	Vlera	Viti	Vlera	Viti	Vlera	Viti		
% e studentëve të punësuar	% e të rinjve/rejave që kanë mbaruar arsimin e nivelit të dytë dhe punësohen brenda një viti pas përfundimit të shkollimit	50%	2017	60%	2019	65%	2021	70%	2023	Shërbimi i statistikave të punësimit publik	Përfituesit e granteve Raport tremujor

2.2.2 Analiza cilësore

<Analizë cilësore e progresit (përparimet konceptuale dhe përsosja e ndërhyrjeve) të realizuar gjatë zbatimit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar, duke përfshirë analizën e ndikimit të programit në zonën e tij, me një diferencim të qëllimit gjeografik (shpërndarja harmonike/përqendrimi) dhe diferencim tëi zonave (rurale/urbane).

Shpjegoni sesi programi ka kontribuar ose do të kontribuojë në përmirësimin e marrëdhënies ndërkufitare si dhe sesi mund ta masim apo demonstrojmë atë.

Shpjegoni sesi strukturat operuese dhe strukturat e ndërmjetme të ngritura gjurmojnë këta elementë të përmirësimit që ndodhin gjatë zbatimittë programit, për shembull, për ngritjen dhe funskionalitetin e sistemit të mbledhjes së të dhënave (për qëllime statistikore dhe administrative).

Për analiza cilësore, strukturat e programit duhet të bëjnë përpjekje për të siguruar informacion mbi pikëpamjet, mendimet ose vëzhgimet e publikut. Këto të dhëna mblidhen kryesisht nga vlerësimet, vizitat studimore, intervistat, takimet, grupet e fokusuara, anketave etj. Në përfundim, shtjelloni se si çështjet e ndërlidhura (veçanërisht ato që janë të rëndësishme për politikën e kohezionit: mundësi të barabarta, zhvillim të qëndrueshëm dhe luftë kundër diskriminimit) zhvillohen gjatë hartimit të thirrjeve për propozime dhe zbatimit të kontratave të granteve. >

2.3 Informacione të hollësishme rreth ekzekutimit financiar të programit të bashkëpunimit ndërkufitar

– Informacion i detajuar mbi kontraktimin dhe nën menaxhimin e tërthortë, disbursimin e alokimeve vjetore për secilin prioritet tematik dhe tip grant kontrate, duke përfshirë dhe partnerët e projekteve (bashkë-përfituesit)

– Analiza e faktorëve të mëposhtëm:

□ *Statusi financiar*

[24] Çdo indikator duhet të identifikohet si tregues ndikimi, rezultati ose produkti

□ *Informacion mbi bashkë-financimin*
□ *Faktorët që kanë penguar dhe / ose vonuar zbatimin financiar*
□ *Faktorët që kanë pasur ndikim pozitiv në zbatimin financiar*

Tabelë model mbi ekzekutimin financiar të kontratave të BNK-së gjatë zbatimit të periudhës raportuese:

<Tabela Nr. XX>

	Prioriteti tematik:<...>					
Numri i kontratës	Emri, tipi dhe vendi i origjinës i koordinatorëve dhe partnerëve	Dita e fillimit/mbarimit	Vlera e parashikuar e kostove të lejuara dhe vlera e grantit të BE-së	Vlera e akumuluar e pagesave	Përqindja e pagesave të ekzekutuara [25]	Komente

2.4 Informacion mbi hapat e ndërmarrë nga strukturat operuese dhe/ose Komiteti i Përbashkët Monitorues për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit:

2.4.1 Monitorimi dhe vlerësimi

<Masat monitoruese të ndërmarra nga struktura operuese ose nga Komiteti i Përbashkët i Monitorimit, duke përfshirë marrëveshjet e mbledhjes së të dhënave, rishikimet e raporteve të grant kontratave, gjetjet dhe zbatimin e rekomandimeve të vizitave monitoruese.

Në programet të cilat kanë menaxhim të tërthortë, përgatitja, ekzekutimi, gjetjet, rekomandimet dhe zbatimi i rekomandimeve të ndërmarra nga struktura operuese ku ndodhet Autoriteti kontraktues (Neni 57 MK). Në programet e zbatuara nën menaxhim të tërthortë, rekomandimet dhe zbatimi i rekomandimeve të ndërmarra prej Komisionit.>

2.4.2 Problemet e hasura dhe veprimet korrigjuese

<Përmbledhje e problemeve të rëndësishme të hasura gjatë zbatimit të programit, si dhe i masave rregulluese të ndërmarra.

Rekomandimet për veprime (të tjera) rregulluese.>

2.5 Vizibiliteti dhe promovimi

<Masat e ndërmarra për të garantuar vizibilitetin dhe publicitetin e programit (plani i vizibilitetit, shihni Nenin 78 të MK), duke përfshirë materiale promovuese, reklama në mas media, shembuj nga praktikat më të mira që theksojnë aktivitetet më të rëndësishme të seminareve, konferencave, tryezave të përbashkëta, forume, ditës së Bashkëpunimit Evropian dhe panaireve të projekteve, mbajtjes së një baze të dhënash me aplikantët e ardhshëm, faqes së internetit të programit etj.>

2.6 Shfrytëzimi i Asistencës Teknike

<Sqarime të detajuara mbi përdorimin e fondeve të asistencës teknike dhe çdo problemi serioz të hasur gjatë zbatimit të buxhetit të AT-së. Si përfundim, një analizë e rezultateve dhe indikatorëve të ndikimit të kësaj kontrate të asistencës teknike duhet të prezantohet në të njëjtën mënyrë si seksioni 2.2.1 më lart.>

2.7 Ndryshimet në kuadër të zbatimit të programit ndërkufitar (nëse ka)

<Nëse është e zbatueshme, përshkrimi i çdo elementi, i cili edhe pse nuk rrjedh drejtpërdrejt nga asistenca e programit, ka ndikim të drejtpërdrejtë në zbatimin e tij (p.sh. ndryshimet legjislative, ndryshimet e rëndësishme në socio-ekonomi etj). >

2.8 Sinergjia me politikat ose instrumentet e tjera të sektorit

[25] (Vlerë kumulative e pagesave/vlera e grantit të BE-së) x 100

<Një përmbledhje e koordinimit dhe koherencës aktuale të programit me shtetet e tjera anëtare të BE-së dhe me programet ose iniciativat kombëtare. Koordinim dhe koherenca e programit me politikat e Komunitetit. Komplementariteti me instrumentet e tjera financiare të asistencës ndërkombëtare.>

2.9 Histori suksesi

<Shpjegoni në lidhje me rezultatet e arritura me një ose mundësisht dy shembuj të grant kontratave, periudha e zbatimit të të cilave ka mbaruar gjatë periudhës raportuese dhe e cila mund të konsiderohet si histori suksesi:

- Dimensioni real i BNK-së (ju lutem tregoni se cili përkufizim i BNK-së është përdorur për të vlerësuar projekt-propozimet, siç tregohet në udhëzimet përkatëse për aplikuesit: a) "Zbatimi i përbashkët i aktiviteteve nga partnerët që rezultojnë në intensifikimin e lidhjeve ndërkufitare dhe partneriteteve të qëndrueshme ndërkufitare dhe heqjen e pengesave ndërkufitare për zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik "ose b) " zbatimin e përbashkët të aktiviteteve nga partnerët që rezultojnë në intensifikimin e lidhjeve ndërkufitare dhe partneriteteve të qëndrueshme ndërkufitare ose heqjen e pengesave ndërkufitare për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë socio-ekonomike).
- Ndikimi real i BNK-së: fqinjësi më e mirë dhe përfitim për njerëzit nga të dyja anët në një mënyrë që një 'projekt kombëtar' nuk do të kishte arritur.
- Inovacioni: sipas fushës, partnerëve të përfshirë dhe aktiviteteve e metodave të zbatuara.
- Efikasiteti: rezultatet e arritura në kohë dhe në përputhje me buxhetin e planifikuar.
- Përhapja e duhur: vizibiliteti, replikueshmëria, shumëfishimi dhe efekti i shpërndarjes.
- Perspektiva të mira të qëndrueshmërisë: përfitimet e mundshme pas kohëzgjatjes së projektit dhe partneritet afatgjatë. >

<Historitë mund të kenë strukturën e mëposhtme:
Fjali e gjetur që përmbledh suksesin e projektit
Titulli i projektit
Prioriteti tematik
Vendodhja: Bashkitë sipas vendit
Tipi i partnerëve të projektit
Vlera e buxhetit (duke përshirë grantin e BE-së)
Problematikat
Objektivat e arritura (duke përfshirë deklaratat e partnerëve)
Rezultatet kryesore
Aktivitetet kryesore
Afatet kohore
Faqe interneti
Detajet e kontakteve të partnerëve BNK>

Periudha e mbuluar nga raporti:
01/01/20XX-31/12/20XX
Raport i lëshuar më XX/XX/20XX

Raport vjetor mbi zbatimin e ndihmës IPA II nën menaxhim të tërthortë nga Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, i paraqitur nga Koordinatori Kombëtar i IPA-s

I. Përmbledhje ekzekutive

1. Referencë e objektivave të Dokumenteve Strategjikë të Vendit dhe një pasqyrë e shkurtër e sfidave të sektorëve
2. Përfshirja në programim
3. Marrëdhëniet me Komisionin Evropian.
4. Problemet që hasen në përmbushjen e kushteve të nevojshme për zbatimin dhe në sigurimin e qëndrueshmërisë, në lidhje me masat e marra/të planifikuara, rekomandimet për veprime të mëtejshme.
5. Çështje të rëndësishme që rrjedhin nga pjesëmarrja e përfituesit të IPA II në komitetin monitorues të IPA-s dhe në komisionet sektoriale të monitorimit (duke përfshirë Komitetin e Përbashkët të Monitorimit për BNK-në), nëse ka.
6. Përfshirja në veprimet shumë-vendëshe dhe çdo çështje që lidhet me to.
7. Aktivitete monitorimi dhe vlerësimi, mësimet kryesore që janë nxjerrë dhe ndjekja e rekomandimeve.
8. Aktivitetet mbi komunikimin dhe vizibilitetin.
9. Koordinimi i donatorëve

Në rastet e menaxhimit të tërthortë, përmbledhja ekzekutive duhet të përmbajë gjithashtu:

10. Zbatimin e gjithanshëm të asistencës së IPA-s nën menaxhim të tërthortë (maksimumi një faqe).
11. Problemet kryesore horizontale të hasura në zbatimin e asistencës së IPA-s dhe masat përkatëse të marra/planifikuara (maksimumi gjysmë faqe).
12. Rekomandimet për veprime të mëtejshme (maksimumi gjysmë faqe).
13. Auditimet - gjetjet kryesore, rekomandimet dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra

II. Informacion sipas Sektorëve

Titulli i sektorit [26]: [Transporti]

Pjesa përshkruese: përmbledhje mbi sektorin, duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:

1. Përfshirja në programim
2. Përmbledhje e rezultateve gjatë lëvizjes drejt një qasjeje të sektorit me të drejta të plota (d.m.th. objektivat e arritura sipas treguesve të sektorit në dokumentin e planifikimit të Sektorit).
3. Koordinimi me instrumente të tjera dhe /ose donatorë / IFI-të brenda sektorit
4. Ndikimi i veprimeve të IPA II brenda sektorit mbi zhvillimin e kapaciteteve përkatëse kombëtare administrative në atë sektor, në planifikimin strategjik dhe buxhetimin.

Nën menaxhim të tërthortë duhet të përfshihet dhe informacioni i mëposhtëm:

5. Struktura/t operative dhe ndryshimet që lidhen me to, nëse ka: [Ministria e Transportit]
6. Informacion mbi zbatimin e programeve në atë sektor
7. Arritjet kryesore në atë sektor
8. Çdo problem i rëndësishëm që haset gjatë zbatimit të detyrave të besuara p.sh. vonesat në kontraktim dhe masat të marr /planifikuara në vijim.
9. Rekomandime për veprime të mëtejshme

[26] Sipas sektorëve në Dokumentet tregues të Strategjisë.

10. Aktivitetit monitoruese dhe vlerësuese të kryera, auditimet - gjetjet kryesore dhe mësimet e nxjerra, rekomandimet, ndjekja dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra.

Titulli i sektorit: Bashkëpunimi Ndërkufitar[27]

1. Përfshirja në programim, sipas rastit
2. Progresi i bërë në zbatimin e Programit Ndërkufitar dhe në veçanti në arritjen e objektivave specifike sipas prioriteteve tematike (duke përfshirë edhe elemente sasiore dhe cilësore që tregojnë progres në lidhje me objektivat)
3. Një përmbledhje e problemeve të hasura në zbatimin e programit të BNK-së dhe çdo veprim korrigjues i ndërmarrë, si dhe rekomandime për veprime të mëtejshme korrigjuese.
4. Monitorimi, duke përfshirë edhe marrëveshjet e grumbullimit të të dhënave dhe kur është e zbatueshme, edhe aktivitetet e vlerësimit.
5. Aktivitetet mbi komunikimin dhe vizibilitetin.
6. Koordinimi me vendin partner.

Nën menaxhim të tërthortë, duhet të përfshihet edhe informacioni i mëposhtëm:

1. Struktura operative ekzistuese dhe ndryshimet që lidhen me të, nëse ka.
2. Çdo problem i rëndësishëm që haset në zbatimin e detyrave të besuara, p.sh. vonesat në kontraktim dhe masat pasuese të ndërmarra /të planifikuara.
3. Rekomandime për veprime të mëtejshme
4. Auditimet e kryera - gjetjet kryesore dhe rekomandimet, si dhe masat korrigjuese të ndërmarra.

II a. Treguesit e performancës në sektorin [p.sh. transporti] që mbulon menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë:

Treguesit[28] **për program**

Marrëveshja e Financimit /Programi referues[29]	**Treguesi për sektor [Transporti]**	**Burimi**	**Linja bazë**	**Objektivi (2017)**	**Objektivi (2020)**	**Vlera (2014** [30]**)**
2014 Programi i vendit	Reduktimi i kohës mesatare të udhëtimit për udhëtarët ndërmjet qendrave kryesore urbane nga lloji i transportit					
2014-20xx Programi shumëvjeçar	Kosto të reduktuara transporti për njësi produkti					

II b. Përmbledhje në nivel veprimi për sektorin [p.sh. transportin]

[27] Për Bashkëpunimin Ndërkufitar kërkohet raportim specifik.
[28] Ky duhet të jetë kryesisht rezultati, si dhe treguesit përkatës të zgjedhur të produktit
[29] Ai duhet të jetë në përputhje me mënyrën e programimit (vjetore, shumëvjeçare me ose pa detyra të ndara), si dhe me raportin e NAO-s
[30] Numri i kolonave duhet të përshtatet për të gjitha vitet, nga viti 2014 deri në vitin e periudhës së raportimit. Vlerat duhet të jenë kumulative.

Marrëveshja e Financimit /Programi referues	**Veprimi**	**Gjendja / Progresi për një veprim të caktuar (p.sh. po përgatiten Termat e Referencës, tenderi është shpallur, kontraktuar, po zbatohet, është përfunduar)**	**Arritjet kryesore dhe vlerësimi i tyre**	**Probleme të rëndësishme të hasura në zbatimin e detyrave të besuara dhe masat e marra / të planifikuara për kapërcimin e tyre**	**Zhvillimet që ndikojnë në zbatimin në të ardhmen**	**Rekomandime për veprime të mëtejshme korrigjuese**
[2014 Programi i vendit]	*Elektrifikimi i linjës hekurudhore nga xxx në kufi me xxx*	*p.sh. Kontratë shërbimi për përgatitjen e Termave të Referencës për punimet që kontrata është nënshkruar dhe po zbatohet, tender për kontratën e punëve që do të fillojnë tremujorin e dytë të vitit 2015*		*p.sh. Kontrata e shërbimit për përgatitjen e Termave të Referencës për punime që kontrata është vonuar, meqë procedura e negocimit dështoi dhe u nevojit të ribëhej*	*p.sh. ndryshimi i ligjit të vendit, si dhe qasja dhe zbatimi i paketës së katërt të hekurudhave*	

Nën menaxhim të tërthortë duhet të sigurohen dhe Shtojcat e mëposhtme:

Shtojca 1
Përmbledhje mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit (duke përfshirë ndryshimet në strukturën institucionale) (maksimumi një faqe).

Aktivitetet mbi transparencën, vizibilitetin, informacionin dhe komunikimin, në përputhje me FWA-në (maksimumi një faqe)

Shtojca 2
Historitë e suksesshme (Kujdes! Ky seksion mund të përdoret për raportin vjetor të asistencës financiare të përgatitur nga Komisioni Evropian)

Shtojca 3
Plani vjetor i prokurimit

Si për menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe atë të tërthortë, duhet të paraqitet shtojca e mëposhtme:

Shtojca 4
Udhërrëfyes i Qasjes Sektoriale - arritjeve (duke theksuar nëse janë përmbushur apo jo objektivat e planifikuara)